

ISSN 2308-2208



LOGOS

REVISTË SHKENCORE

4

TIRANË, 2017



LOGOS

- REVISTË SHKENCORE -

| 2017 | Nr. 4 |



BOTIMET "NGJALLJA"

Kolegji Universitar “**LOGOS**”

Kryeredaktor:

Prof. Asc. TEFTA ROTA

Redaksia:

Prof. MERSIN MERSINLLARI

Prof. ILIA NINKA

Prof. Asc. BEATRIÇE POLO

PhD. BLEDAR ILIA

PhD. GUXIM KOLA

PhD. LEONORA ZOTO

Dr. RIDVANA MEDIU

MSc. DORINA MINXURI, sekretare e redaksisë

Përgatiti për botim:

Dorina Minxuri

Redaktore letrare:

MSc. Aida Zoto

Adresa e kontaktit: redaksia@shlplogos.edu.al

ISSN 2308-2208

TREGUESI I LËNDËS

• Dominimi i Mentalitetit mbi Sistemin Juridik në Shqipëri	5
<i>PhD. Bledar Ilia</i>	
• Globalizmi dhe kapitalizmi i Trump	13
<i>MSc. Elvis Xhori, PhD. Guxim Kola</i>	
• Të mësuarit thellues përmes Pedagogjisë Transformuese	25
<i>MSc. Aida Zoto</i>	
• Vizioni Tragjikomik i Filip Rothit në “Njolla Njerëzore”	48
<i>MSc. Erion Shehu</i>	
• Aplikimi i rregullave të Westgard-it në laboratorët mjekësorë	62
<i>MSc. Ariol Rama, Bruna Dungu</i>	
• Përcaktimi i antigjenit specifik të prostatës (TPSA) në serum me Metodën e Imunofluoreshencës në Matriks Nitroceluloze.	70
<i>Dr. Stilian Buzo</i>	
• Nocioni i lirisë tek Milli dhe tek Kroçe	77
<i>MSc. Dorian Sevo</i>	
• Motivimi i adoleshentëve për kryerjen e operacioneve plastike	85
<i>MSc. Enxhi Marku</i>	

DOMINIMI I MENTALITETIT MBI SISTEMIN JURIDIK NË SHQIPËRI

PhD. Bledar Ilia*

PËRMBLEDHJE

Mosfunksionimi i demokracisë shqiptare tashmë është mjaft i qartë për të gjithë shoqërinë. Ekzistojnë tentativa të cilat përpiqen të sensibilizojnë opinionin publik se ky handicap, i dedikohet moszbatimit korrekt të ligjit dhe normave kushtetuese sikurse edhe korrupsionit të njerëzve të cilët janë të punësuar në administratën publike.

Shkaqet e vërteta në fakt i përkasin sistemit dhe jo personave të cilët nuk ka rëndësi sesa lart janë të pozicionuar në hierarkinë e pushtetit. Problemi është më shumë teknik dhe shpeshherë i referohet filozofisë.

Problemet e kushtetutës dhe normave të saj janë shumë herë më të mëdha sesa duken dhe trumbetohen pasi ato përballen me sfidat në të cilat duhet të kalojë një shtet post-totalitar.

Fjalë kyçe: *Demokraci, Kushtetute, reformë, mentalitet, identitet, pushtet, filozofi, impuls politik etj.*

* Lektor universitar, Kolegji Universitar “Logos”, Tiranë, Shqipëri.

Demokracia shqiptare dhe sistemi gjyqësor duket se po përballet me probleme të ndryshme. Për të qartësuar gjërat duket se ndryshimi i kushtetutës është një domosdoshmëri.

Në qoftë se do t'i hedhim një sy kushtetutës të Shqipërisë, do të shohim se përveç problemeve të hartimit të ligjit, ekzistojnë edhe probleme ekstra juridike. Revolucion i post-komunist nuk është bazuar aspak në një ideologji të re. Opinioni publik është sensibilizuar dhe mendon se po përjeton një ideologji liberale njëlloj si ideologjitë të cilat dominojnë në vendet e Bashkimit Evropian. Mesa duket, këtu ata janë të gabuar.

Në vend që të ecim përpara ne po bëjmë hapa mbrapa. Politikanët shqiptarë janë përpjekur që të imitojnë vendet evropiane dhe bastionet e tyre por nuk kanë arritur që t'i zbatojnë ato në Shqipëri.

Në vitin 1991, elektorati shqiptar nuk ishte i përgatitur për ideologji të tjera përveç atyre të promovuara nga partia komuniste dhe marksiste, të cilat nuk kishin asnjë lidhje me Marksizmin.

Struktura territoriale ishte më shumë e rëndësishme sesa ideologjia. Në këtë mënyrë u krijua një informacion revolucionar i cili do të pasonte strukturën e shtetit dhe të partisë komuniste.

Sistemi perëndimor i partive është i strukturuar rreth katër shtresave sociale themelore të cilat kanë sjellë një polarizim të opinionëve esenciale dhe shpeshherë radikale dhe së fundmi këto opinione u shndërruan në ideologji. Këto katër shtresa janë frutat e një revolucioni social, i cili ka tronditur themelet e shoqërisë.

Është fjala për katër grupet e mëposhtme:

a) proletarë/pronarë; b) shtet/kishë; c) urban/rural; d) qendër/periferi.

A. Mosfunksionimi i raportit proletar/pronar

Grupimi i parë *-proletarë dhe pronarë-* ose ndryshe sikurse emërtohet grupimi i atyre personave të cilët e fitojnë ekzistencën e tyre nëpërmjet shitjes të krahut të punës dhe ata të cilët janë posedues të mjeteve të prodhimit.

Partitë të cilat qëndrojnë përkrah proletariatit quhen, fillimisht, socialiste kurse ato të cilat mbrojnë interesat e pronarëve quhen parti liberale. Shfaqja e socializmit, i cili në thelb, mohon demokracinë perëndimore dhe partitë të

cilat adoptojnë ideologji të klasifikuara komuniste. Ky grupim në Shqipëri nuk është funksional edhe sot.

Deri në vitin 1991, të gjithë, ishim padyshim klasa punëtore dhe të gjithë ata të cilët ishin larguar jashtë shtetit në kohën e komunizmit, nuk arritën të krijonin asnjë terren politik. Kjo për vetë faktin se ata shiheshin si reaksionarë e të pasur dhe pretendohesh se nuk kishin vuajtur në kohën e komunizmit si të tjerët duke ngrënë “bukë misri”. Është e qartë që në këto kushte nuk mund të flasim për parti të djathta. Pas 25 vitesh nga rënia e komunizmit ky grupim ende nuk është funksional edhe pse një klasë pronarësh ekziston. Në radhë të parë mosfunksionimi vjen nga kultivimi i mentalitetit që pasuritë e mëdha, bëhen vetëm duke vjedhur dhe çdo formë udhëheqje e kësaj natyre mund të emërtohet oligarki.

Si konkluzion, ende në Shqipëri, nuk mund të ekzistojë ky grupim për aq kohë sa pronarët shihen si grupime hajdutësh.

Për këtë arsye kemi parti të cilat ideologjikisht mbështeten tek proletariati dhe parti të cilat ideologjikisht mbështeten tek pronarët, por nuk kemi arritur që të ndërtojmë mentalitetin e duhur për ekzistencën e këtyre partive.

Edukimi në këtë pikë mungon! Faji është i arsimit publik i cili imiton studimin e ekonomisë politike ose të politikës ekonomike, të filozofisë pa folur më parë për drejtësinë, e cila mungon totalisht nga kurrikulat e shkollës së mesme. Si rrjedhojë, partitë politike as nuk arrijnë që të edukojnë me këto vlera elektoratin e tyre edhe pse kjo duhet të jenë një nga funksionet kryesore të tyre. Impulsi i dërguar drejt sistemit kushtetues në këtë mënyrë, për strukturimin e sistemit politik, është jofunksional. Pra, fajin nuk e ka Kushtetuta por arsimimi.

B. Mosfunksionimi i raportit shtet/kishë

Grupimi i dytë -*shtet dhe kishë*-, në përfundim, ka një rëndësi të madhe për vetë faktin se siguron polarizimin e elektoratit dhe i jep një impuls esencial sistemit kushtetues. Nuk është fjala për besimin e disave ndaj faktit se disa parti janë të krishtera ose jo, është fjala për pranimin e rolit politik të kishës ose mohimit të saj.

Partitë Demokristiane kanë tendencën që të pranojnë se kisha luan një rol politik në një kohë kur partitë laike, janë të mendimit se roli i kishës duhet të jetë i ndryshëm nga ai politik.

Partitë laike nuk janë anti-kristiane por vetëm se ato janë kundër rolit të klerikëve në politikë, për më tepër që klerikët e kanë luajtur këtë rol për shumë kohë në Evropën Perëndimore.

Edhe këtu partitë politike shqiptare kanë hyrë në një lojë të papërgjegjshme. Disa prej tyre janë deklaruar parti demokristiane. Grupimi të cilin ato përfaqësojnë as që nuk ekziston në Shqipëri. Kisha, në vendin tonë, nuk ka pasur asnjë rol politik ashtu sikurse e ka kisha katolike në Perëndim. Pra, nuk ekziston asnjë rrymë politike klerikale dhe asnjë rrymë politike anti-klerikale.

C. Mosfunksionimi i raportit urban/rural

Grupimi i tretë *-urban dhe rural-*, është raporti midis kulturës urbane progresive dhe kulturës rurale tradicionale.

Në Shqipëri ky polarizim ka funksionuar deri në fillimin e luftë së dytë botërore. Në ditët e sotme një nga partitë e cila përfaqëson interesat rurale është Partia Agrare Ambientaliste. Është e vërtetë se shumica e popullsisë në vendin tonë është rurale, por ne ndërtuam fshatra të cilët nuk kanë asnjë element urban.

Sot në kryeqytet kemi lagje të tëra të cilat banohen nga fshatarë të vendosur nëpër pallate dhe të cilët pas njëfarë kohe do të rikthehen në fshat. Madje në ditët e sotme, një nga ofendimet më të mëdha që mund t'i bësh një shqiptari është ta quash atë "fshatar". Pra, në Shqipëri është ofenduese që të jesh fshatar dhe të mbështetesh politikisht mbi fshatarë ose sikurse quhet pjesa e prapambetur.

Kjo është një nga arsytet që të gjitha partitë të cilat operojnë me raportin fshat-qytet janë vetëm për arsye elektorale dhe nuk gjejnë aspak terren në vendin tonë.

D. Mosfunksionimi i raportit qendër/periferi

Grupimi i katërt *-qendër dhe periferi-*, është një grupim i cili duhet të funksionojë në vendin tonë. Në fakt ky grupim lidhet me vertikalizimin e

pushtetit nga qendra në komunitetet lokale. Gjithë diskutimi duhet të përqendrohet në q.s. ne duhet të zgjedhim një shtet unitar dhe të centralizuar apo një shtet federal.

Në Shqipëri as që nuk konceptohet që të flitet për diçka të tillë. Të gjitha partitë shqiptare janë centriste. Sistemi normativ në vetvete ka pasur gjithmonë një frikë nga federalizmi.

Edhe vetë Kushtetuta e përcakton se ndarjet janë gjithmonë administrative. Të gjitha partitë në këtë këndvështrim fryjnë muskujt e tyre nacionalistë për t'i fituar gjithmonë ata që quhen nacionalistë. Pra, do të konstatojmë se asnjë grupim përëmdimor nuk gjen vend në Shqipëri.

Me qëllim që sistemi kushtetues të funksionojë në mënyrë korrekte, duhet të gjejmë tema të tjera themelore të cilat të jenë në gjendje që të krijojnë një polarizim institucional të elektoratit përreth partive politike.

Arsimimi dhe Pluralizmi

Demokracia është e lidhur ngushtë me pluralizmin. Sa pluraliste është shoqëria jonë, ne e kuptojmë.

Sot është prezente një parti me më shumë fraksione sesa një sistem partizan partish. Sindikatat janë pothuajse fantazma. Shoqatat e grave janë të lidhura ngushtë me partitë politike dhe të rinjtë marrin pjesë rreth 1% në jetën politike. Dihet që protestat janë shumë herë më efektive kur janë spontane.

Detyra jonë si pedagogë është ajo që ne të fillojmë të japim mësim në mënyrë pluraliste. Nuk duhet t'i mësojmë studentët që të memorizojnë literaturën por t'iu krijojmë mundësinë atyre që të zgjedhin atë literaturë e cila konsiderohet më e mirë për ta.

Vetëm në këtë mënyrë ne do të jemi në gjendje që t'i përgatisim këta njerëz me vlera të larta demokratike.

Arsimimi dhe Propaganda

Shpeshherë Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese përdoret nga partitë politike si një vektor i propagandës. Në shtetin diktatorial ata e përdornin edhe arsimin për propagandë.

Sistemi i arsimit duhet të jetë një sistem konstant dhe me reforma jo të shpeshta, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër përveç se e dëmtojnë atë.

Arsimimi dhe Vlerat

Sipas mendimit tim, me qëllim që të edukojmë politikisht qytetarët, ne duhet të risjellim në procesin mësimor vlerat. Të pakësojmë sasinë e informacionit dhe t'iu mësojmë metodologjinë e njohurive dhe të veprimit.

Vetëm në këtë mënyrë qytetarët do të edukohen që të ushtrojnë rolin e tyre në demokraci.

Konkluzione

Në Shqipëri, shpeshherë, pohojmë se nuk kemi njerëzit e duhur në pushtet. Natyrshëm lind pyetja se i kujt është faji?

Është faji i sistemit apo është faji i njerëzve?

Unë mendoj se sistemi i drejtësisë si bazë ligjore është i duhuri, por impulset sociale dhe politike janë të gabuara dhe nuk po ushqejnë siç duhet këtë sistem.

Kemi një inflacion ligjesh saqë edhe vetë agjencitë shtetërore, po aplikojnë gabimisht ligjin. Demokracia është një shoqëri debati, konflikti, dialogu dhe negociimi.

Njerëzit duhen edukuar për të kuptuar se kur duhet të mbarojë konflikti dhe ku duhet të fillojë negociimi. Ne nuk duhet të instalojmë një demokraci autoritare.

Kohët e fundit procesi i Vettingut shihet si një shpresë e madhe e këtij vendi por përsëri kërkohet shumë kujdes pasi të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces nga fillimi deri në fund janë në shënjestrën e tij dhe ende shumë njerëz nuk e kanë marrë në konsideratë atë duke filluar të cenojnë këtë proces kaq jetik.

BIBLIOGRAFIA

1. Dănișor, D. C. 2001. *Drept Constitutional si institutii politice*, Craiova.
2. Dănișor, D. C. 2002., *L'Utopie constitutionnalisee*, Craiova.
3. Dănișor, D. C. 2013. *Democratia deconstitutionalizata*, Universul Juridic.
4. Dănișor, D. C. 2014. *Libertatea in capcana*, Universul Juridic.
5. Rotry, R. 1998. *Repenser la democratie*, Edition du Rocher.

SUMMARY

Malfunction of Albanian democracy is already quite clear to everyone. There are attempts that are trying to sensitize the public opinion that this handicap is due to incorrect implementation of the law and constitutional norms as well as the corruption of the people who are employed in public administration.

The real causes actually belong to the system and not to the people who has not matter how far are positioned in the hierarchy exercise power. The problem is more technical and often it refers to philosophy.

The problems of the constitution and its rates are more difficult as they face the challenges which must pass a post-totalitarian state.

Key Words: *Democracy, constitution, reform, mentality, identity, power, philosophy, political momentum, etc.*

GLOBALIZMI DHE KAPITALIZMI I TRUMP

MSc. Elvis Xhori^{1,2}; PhD. Guxim Kola¹

Hyrje

Zgjedhja e Donald Trump si Presidenti i 45-të i Shteteve të Bashkuara, është parë gjerësisht si fillimi i fundit të rendit kapitalist të pas viteve 1945, i cili u bë globalisht dominues pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Por, a është e mundur që Trumpism-i të jetë aktualisht fundi i një fillimi? A mundet liria e Trump të shënojë fundin e konfuzionit të post-krizës, ku modeli ekonomik i ndërtuar në vitin 2008 të njihet më në fund si shkatërrim i pakthyesëm dhe të fillojë një fazë të re e kapitalizmit global ku gradualisht evoluon një qasje e re e menaxhimit ekonomik? N.q.s. historia do të ishte treguese, kolapsi i afërt i sistemit financiar global i vitit 2008, me gjasa, është reflektuar - prej një periudhe 5 vjeçare ose më shumë - në sfidat e institucioneve politike ekzistuese dhe në ideologjitë ekonomike mbizotëruese.

Në vlerësimin tim, rendi i ngjarjeve që pasuan krizën e sistemit të mëparshëm të kapitalizmit global, do të ishte: a) Imperializmi liberal ndoqi Revolucionin e 1840-ës; b) Keynesianizmi ndoqi Depresionin e Madh të 1930-ës; dhe c) Tregu fundamentalist Regan-Thecher ndoqi Inflacionin e Madh të 1970-ës.

A mund te kuptohet Trumpism-i si një përgjigje e vonuar e për krizën e 2008-ës e cila paralajmëron shfaqjen e një regjimi të ri kapitalist?

1. Kolegji Universitar "Logos".

2. elvisxhori@gmail.com

Kjo pyetje duhet të ndahet në tri pjesë:

1. A mund të funksionojnë politikat ekonomike të Trump?
2. A do të jetë politikisht i qëndrueshëm programi i tij i administrimit ekonomik?
3. Çfarë impakti mund të ketë Trumpism-i në rang global lidhur me mendimin ekonomik dhe qëndrimet ndaj kapitalizmit?

Në pikënisje të këtyre çështjeve, vetëm një numër i vogël ekonomistësh shohin disa arsye për të pasur shpresë, por, shumica janë thellësisht pesimist. Ky qëndrim mishërohet nga fituesi i çmimit Nobel, **Joseph Stiglitz**, i cili shprehet: *“Tani në të vërtet nuk ka më asnjë rreze dritë mbi retë që po mbulojnë SHBA-në dhe botën”*. Rruga e vetme që Trump të përmbushë premtimet e tij për rritje të infrastrukturës dhe të shpenzimeve të mbrojtës, duke bërë shkurtime të mëdha të taksave dhe reduktim të deficitit buxhetor, është një dozë e rëndë e asaj që do të quhet “Ekonomia Voodoo”. Për Stiglitz, Trump përfaqëson një ri-miratim të Epokës Regan për sa i përket prapavijës sociale të rënies ekonomike, por duke i shtuar atij dy komponentë të mëtejshëm vdekjeprurës: luftën tregtare me Kinën dhe humbje të aksesit në kujdesin shëndetësor për miliona njerëz.

Stiglitz beson se pasojat politike do të jenë katastrofike. Eksperienca do të tregojë se kjo “historia e tatëpjetës/rënies”, nuk do të përfundojë mirë për zemërimin e Trump të zhvendosur ndaj votuesve të Rust Belt, të cilët do të provokohen për të kërkuar edhe me agresivisht “koka-turku” kur të kuptojnë se sa thellësisht i ka tradhtuar Trump interesat e tyre.

Simon Johnson i Institutit MIT Sloan dhe Institutit Peterson për Ekonominë Ndërkombëtare, ka arritur në një konkluzion të ngjashëm duke u shprehur se: “Prioritetet e politikave ekonomike të Trump, reflektohen në propozimet e kabinetit të tij të cilat përfaqësojnë një ndryshim dramatik të oligarkisë së drejtpërdrejtë; dhe kontroll i drejtpërdrejtë i shtetit nga njerëz me fuqi ekonomike private të konsiderueshme”. Trump, duket i vendosur për të ulur taksat mbi të ardhurat për amerikanët me të ardhura të larta si dhe për të zvogëluar tatimin mbi fitimin (që kryesisht paguhen nga të pasurit) dhe pothuajse të eliminojë taksat e korporatave (përsëri në mënyrë disproporcionale përfitojnë me të pasurit).

Duke u ndalur në politikën e planeve të reja të administrimit, Johnson, një ish-shef ekonomie i Fondit Monetar Ndërkombëtar, vë në dukje se Trump drejton një koalicion “të njerëzve të biznesit”, të cilët, gabimisht, besojnë se proteksionizmi është një mënyrë e mirë për të ndihmuar ekonominë ndërsa pjesa tjetër e koalicionit “fundamentalistët e tregut”, janë të vendosur për uljen e taksave. Për të konsoliduar këtë koalicion, fundamentalistët e tregut kanë përqafuar proteksionizmin, duke justifikuar tarifën e importit të propozuar nga Trump, si një mënyrë për të paguar për uljen e taksave të korporatave. Megjithatë, tarifën janë ekuivalente me rritjen e tatimit mbi shitjen. Kështu, rezultati do të jetë shmangia e vëmendjes nga bazat e politikës së tyre dhe taksa më të ulëta për oligarkët, duke paguar taksa më të larta për pothuajse gjithë të tjerët (për të mos përmendur humbjet e konsiderueshme të vendeve të mirë paguara të punës si rezultat i proteksionizmit).

Ndryshe nga Johnson, **Martin Feldsteini** Universitetit të Harvardit, i cili shërbeu si Kryetar i Këshilltarëve të Këshillit Ekonomik të Presidentit Ronald Reagan, mirëpret mundësinë e një reduktimi në normat e larta tatimore marxhinale. Feldstein argumenton se politikat e Presidentit Barak Obama vijuan një “ndryshim jo të shëndetshëm në barrën e taksave për ata me nivelet më të larta të të ardhurave”, të nisur qysh që prej epokës së Reganit. Por, ndërsa Feldstein favorizon zgjerimin e bazës tatimore larg prej amerikanëve më të pasur si një “mënyrë të vendosjes së të ardhurave neutrale”, ai është skeptik në lidhje me premtimet e nënshkruara nga Trump për paga më të larta, më shumë vende punë për “klasën e mesme” dhe rritje më të fortë ekonomike. Ekonomia ka arritur në thelb punësimin e plotë, me normën e papunësisë 4.9% (shënuar në muajin tetor). Zvogëlimi i tregut të punës ka shkaktuar rritjen e çmimeve të konsumit me 2.2% gjatë vitit të kaluar, vlerë kjo më e lartë se një viti më parë, e cila arrinte në 1.9%. Nga ana tjetër “pagat e punëtorëve të prodhimit” rriten me 2.4% dhe duke pasur parasysh rritjen reale të pagave dhe rritjen e inflacionit, ai vlerëson se “nuk ka arsye për të kërkuar një rritje të kërkesës agregate në këtë kohë”.

Shpresa të çuditshme

Ashtu si edhe skepticizmi, tregon Feldstein, komentatorët e Trumponomics nuk ecin me mjeshtëri përgjatë vijave ideologjike. Në të vërtetë, eksperti i zhvillimit ekonomik të Harvardit, **Dani Rodrik**, me siguri jo fundamentalist tregu, gjen arsye për shpresë në kundërshtimin e Trump për “tregtinë e lirë”, duke e ngarkuar atë me dispozita që nuk kanë të bëjnë fare me tregun. Ai shprehet se “Adam Smith dhe David Ricardo do të riktheheshin andej nga kanë ardhur, nëse do të lexonin Partneritetin Trans-Paqësor”, ku industrisë specifike i janë ofruar preferenca të veçanta dhe interesa personale, apo marrëveshjet më të reja tregtare që Trump ka denoncuar. Ato të gjitha përfshijnë rregulla në pronësinë intelektuale, flukse në kapital, dhe mbrojtje të investimeve, që janë projektuar kryesisht për të gjeneruar dhe ruajtur fitimet si për institucionet financiare ashtu dhe për ndërmarrjet shumëkombëshe, në kurriz të qëllimeve të tjera legjitime të politikës.

Kështu, ndërsa Rodrik shpreh keqardhje për politikën demagogjike të Trump dhe pretendimeve absurde të shumë prej politikave të tij, ai shpreson se zgjedhja e Trump do të ndalojë prirjen e hiper-globalizimit e cila ka lëvizur më shpejt se sa mund të justifikohet ekonomikisht. Ekonomistët, prej një kohe të gjatë, e dinë se dështimet e tregut - duke përfshirë tregjet e funksionimit të dobët të punës, të metat e tregut të kreditit, njohuritë apo faktorët e jashtëm të mjedisit, dhe monopolet - mund të pasqyrohen në fitimet e korrura nga tregtia. E megjithatë, ata e kanë minimizuar vazhdimisht kapacitetin e globalizimit në thellimin e ndarjeve shoqërore, në përkeqësimin e problemeve të shpërndarjes dhe në shkatërrimin e marrëveshjeve të brendshme sociale - rezultati i të gjitha këtyre ka prekur drejtpërdrejt komunitetet në Shtetet e Bashkuara.

Historiani ekonomik keynesian **Robert Skidelsky** shikon karakteristika të tjera pozitive në idetë politike të Trump - madje edhe në filozofinë e tij ekonomike. “Proteksionizmi i Trump të rikthen në traditën e vjetër amerikane, atë të pagave të larta, të ekonomisë prodhuese dhe të punëve të të pasurve, pra, asaj që ka dështuar me globalizmin”. Skidelsky vazhdon më tej duke thënë: “Madje edhe izolimi i Trump, është një mënyrë populliste e të

shprehurit se, Shtetet e Bashkuara duhet të tërhiqen nga angazhimet të cilat nuk kanë as fuqi e as vullnet për t'i respektuar”.

Më e rëndësishmja nga të gjitha, propozimi i Trump mbi “një program prej 800 bilion \$ - 1 trilion \$ për investime në infrastrukturë”; “një shkurtim masiv të taksave të korporatave”; dhe “një premtim për të ruajtur të drejtën e mirëqenies”, vjen si një formë moderne e politikës fiskale Keynesian-e. Sa me sipër, Trumpism-i përbën një sfidë botëkuptimi në maninë neoliberalale me deficite dhe reduktim të borxhit, si dhe mbështetje në matjen sasiore (si metoda e vetme dhe e rraskapitur tashmë, e kërkesës së menaxhimit). Duke rihapur debatin për çështje të tilla, më parë të konsideruara tabu, Skidelsky vazhdon: *“Trumpism-i mund të jetë një zgjidhje për krizën e liberalizmit, jo një ogur i shpërbërjes së saj”*. Nëse është kështu, atëherë liberalët nuk duhet të largohen me neveri dhe dëshpërim, por duhet të angazhohen më tepër me potencialet pozitive të Trumpism-it. Së fundmi, ai shprehet: *“Propozimet e Trump, duhet të diskutohen e të rafinohen, jo të hidhen poshtë si përçartje injorantësh”*.

Në një mënyrë të ngjashme, **Kenneth Rogoff** paralajmëron mosmiratimin e politikës së Trump, e cila turbullon gjykimin ekonomik. Stimuli fiskal i Trump dhe theksi mbi liberalizimin, do të nxisë kërkesën për mënyrën klasike Keynesian-e që tashmë ka “mahnitur” disa udhëheqës të biznesit. Ndërsa liberalizimi, jo domosdoshmërisht, do të “përmirësojë mirëqenien mesatare të amerikaneve” dhe propozimet e tij mbi taksat do të “çojnë në përfitimin në mënyrë dis-proporcionale të të pasurve”, atëherë ai mund të bëjë ekonominë amerikane të lëvizë në mënyrë të konsiderueshme më shpejt, të paktën për një fare kohë. Kjo është arsyeja pse është e dobishme të kujtoni se “Nuk duhet të jeni një djalë i mirë për ta bërë ekonominë të ecë përpara!”, përfundon Rogoff. Në shumë mënyra, Gjermania ka qenë po aq e suksesshme sa Amerika në përdorimin e stimujve për të lënë ekonominë kombëtare jashtë Depresionit të Madh.

Lindur për të humbur

Suksesi apo dështimi i Trump si President, mund të varet më pak nga evoluimi i variabileve makroekonomikë si: rritja, punësimi, pagat, dhe nor-

mat e taksave. Kryesisht bazohet në forcat themelore socio-ekonomike që mundësuan fushatën e tij. Për shqyrtimin e forcave të tilla përqendrohemi në pabarazinë e të ardhurave, ndërsa të tjerë theksojnë faktorët kulturorë dhe demografikë. Por, të gjithë arrijnë në përfundimin se Trumpism-i, si një program politik, nuk ka gjasa të jetë një krijim i zbatueshëm.

N.q.s. zgjerimi i pabarazisë dhe rënia e të ardhurave të klasës së mesme ishin shkaqet kryesore të revoltës së popullsisë amerikane, *Trumpism-i në fund të fundit do t'i rëndojë dhe sigurisht nuk do t'i përmirësojë këto ankesa.* "Treguesit realë të inflacionit të pagave në pjesën e poshtme të shpërndarjes së të ardhurave, janë afërsisht aty ku ishin 60 vjet më parë", - vuri në dukje Stiglitz. Pra, nuk është çudi që Trump gjen hapur një audiencë të madhe kur thotë se situata ekonomike është e kalbur. E megjithatë, për dy breza, demokratët dhe republikanët këmbëngulën njësoj se tregtia dhe liberalizimi financiar - reformat kyçe të cilat mbështesin globalizimin - do të sigurojnë prosperitet për të gjithë. *Pak e çuditshme në fakt që votuesit, standardi i jetesës se të cilëve nuk ka lëvizur ose ka rënë, arrijnë në përfundimin se liderët politikë amerikanë ose nuk e dinin për çfarë ishin duke folur, ose ishin duke gënjyer, ose të dyja.*

Dilema për Trump është se ndërsa ai qartësisht përfiton nga përhapja e zemërimit që buron nga humbja e besimit tek qeveria, a do të arrijnë politikat e tij ta ulin këtë zemërim? Sigurisht, një tjetër dozë e llojit të ekonomisë që ai premton, me qëllim shkurtimet e taksave thuajse tërësisht për amerikanët e pasur dhe korporatat, është ekonomia rrjedhëse, por, a do të prodhojë rezultate më të mira se herën e fundit që ata u përpoqën?

Robert Johnson, President i Institutit për Mendimin e Ri Ekonomik, ofron një tjetër arsye përse votuesit e Trump, të dëmtuar nga zgjerimi i pabarazisë së pasurisë dhe të pushtetit, ishin aty për një zgjim të ashpër. Nuk ishte rastësi, vëren Johnson, që gjatë zgjedhjeve paraprake të partisë, vetëm Trump dhe Senatori Bernie Sanders i partisë Demokratike, vendosën në pamje të parë atë që ka më shumë rëndësi për votuesit: një politikë ekonomike në të cilën zyrtarët e zgjedhur, promovojnë fuqimisht një prosperitet me bazë të gjerë që i përfshin edhe ata.

Kandidatët e tjerë, të kufizuar nga një sistem që e bën jashtëzakonisht të vështirë financimin e një fushatë të besueshme politike, pa ushqyer skllavërinë në shtresat e pasura të shoqërisë amerikane, thjesht nuk mund të pozicionohen. Ky sistem fton rebelizmin, dhe Trump e Sanders, respektivisht me vetëfinancim dhe mbledhje fondesh bazë - u pozicionuan në mënyre ideale për të udhëhequr.

“Tani Trump do të duhet të shpikë mjete juridike për problemet sociale, ekonomike dhe politike që ai i ka përshkruar, vazhdon Johnson, por për të bërë këtë, ai do të duhet të punojë brenda të njëjtin sistem “të manipuluar”, kundër të cilit luftoi”. Më tej, ai duhet të krijojë politika që janë vërtet të realizueshme dhe që kanë efekt pozitiv në jetën e amerikanëve. Së fundmi, për shkak se zgjerimi fiskal i Trump do të çojë në përfitimin dis-proporcional të të pasurve, pa asnjë rezultat në pjesën tjetër të amerikanëve, do të krijohet zhgënjimi.

Po sikur pabarazia e të ardhurave të mos jetë arsyeja kryesore përse votuesit e shtresës së mesme refuzuan partitë politike tradicionale dhe u kthyen nga Trump? Po, në qoftë se, siç argumenton **Michael Sandel**, filozofi i politikave të Harvardit, ankesat e votuesve të kenë të bëjnë me respektin e shtresave sociale, pra, jo vetëm për pagat dhe vendet e punës?

Edmund Phelps, një tjetër ekonomist fitues i çmimit Nobel, citon të dhëna të mbështetura në hipotezën e Sandel. *Në fakt, që nga viti 1970, shpërblimi total i punës (pagat plus përfitimet shitesë) është rritur pak më ngadalë se fitimet totale - vë në dukje Phelps - ndërkohë që rritja mesatare e pagave në fund të çdo shkalle të të ardhurave, nuk është ngadalësuar në krahasim me klasat e mesme. Në anën tjetër, përfitimi mesatar për orë, për punonjësit e sektorit privat (të prodhimit dhe të vetë-punësuarve), është rritur shumë më ngadalë nga ai i gjithë të tjerëve. “Jakat e bardha” dhe klasa e të vetë punësuarve në prodhim, kanë pësuar humbjet më të mëdha. Këtu bëjnë pjesë edhe punëtorët të cilët janë nxjerrë jashtë klasës punëtore me shpesh, dhe kanë më shumë gjasa të dorëzohen ndaj shëndetit të dobët, vetëvrasjeve apo varësive nga droga. Këta njerëz e kanë humbur mundësinë për të bërë një punë kuptimplotë ku të ndjejnë sensin e bashkëpunimit dhe kanë qenë të privuar ndaj një hapësire ku mund të përparojnë duke shijuar*

kënaqësinë e suksesit dhe të vetë-përmbushjes profesionale. Ky, me siguri, është grupi demografik që siguroi fitoren e Trump në betejën e tij me shtetet industriale të Iowa, Michigan, Ohio, Pennsylvania dhe Wisconsin. Phelps beson se mundësitë ekonomike për punëtorët e krahut në rajone të tilla, mund të rivendosen vetëm nëse rritja e produktivitetit bazohet në industrinë e prodhimit nëpërmjet hapjes së konkurrencës dhe jo vetëm duke iu rikthyer rregulloreve. Ai vë në dukje se megjithëse politika e proteksionizmit tregtar Trump, përmes politikave, synon ruajtjen e punësimit ekzistues dhe shkurtime të taksave të përshtatur për korporatat e mëdha, ka shumë gjasa që rritja të shtypen dhe jo të nxiten.

Ekonomisti francez **Jean Pisani-Ferry** arrin në një përfundim të ngjashëm, por, nga një këndvështrim i tjetër. Ai vë në dukje se e kaluara, papritmas, mund të ketë më shumë ndikim se e ardhmja, jo vetëm në SHBA, por edhe në Britani, Francë, e në shumë vende të tjera të zhvilluara dhe në zhvillim, dhe si shkak për këtë, ai propozon katër arsye: a) rritje e dobët ekonomike; b) zgjerimi pabarazisë në të ardhura; c) zhvillim teknologjik që eliminon punën e krahut; dhe një faktor i katërt më pak i njohur, d) pabarazia e re ka një dimension politik gjerësisht të spikatur.

Njerëzit e arsimuar dhe profesionalisht të suksesshëm gjithnjë martohen dhe jetojnë afër njëri-tjetrit, kryesisht në metropole të mëdha dhe të lulëzuara. Ata që janë jashtë këtij grupi, gjithashtu martohen dhe jetojnë afër njëri-tjetrit kryesisht në zona të zymta dhe qytete të vogla. Si rezultat, shtetet amerikane të fituara nga Trump llogariten të zënë 36% të GDP-së, kurse ato të fituara nga Hilary Clinton llogariten në 64 %. Shtrirja masive e pabarazisë krijon komunitete të mëdha të njerëzve pa të ardhme, ku aspirata kryesore mund të jetë vetëm të kthejnë kohën prapa. Përballë këtyre aspekteve të shumta të problemeve socialo-ekonomike, ai beson se një program i ndjeshëm duhet të ndikojë njëkohësisht në makroekonomi, në edukim dhe në shpërndarjen demografike. Nuk ka asnjë të dhënë nëse propozimet politike të Trump mund të arrijnë diçka të këtij lloji, madje në të kundërtën, ndërsa Skidelsky citon premtimin e Trump për të mos hequr të drejtat e mirëqenies, Kongresmenët Republikanë janë duke realizuar pikërisht këtë. Me mbështetjen dhe inkurajimin e Trump, ata tashmë kanë filluar shpërbërjen e reformës së kujdesit

shëndetësor "Affordable Care Act" (Akti i kujdesit të përballueshëm), të nënshkruar nga Obama, duke mos e zëvendësuar me asnjë paketë tjetër. Kjo lëvizje, sipas përlllogaritjeve të fundit të Zyrës së Buxhetit, do të shkaktojë një rritje të numrit të të pasiguarve me 18 milion, vetëm në vitin e parë.

Konkluzione

Në reagimin tim fillestar për fitoren e Trump, identifikova pesë përfitime të mundshme ekonomike që mund të kompensojnë pjesërisht rreziqet e dukshme të normave të larta të interesit, të luftërave tregtare, të mbivlerësimit të dollarit dhe të efekteve shpërndarëse zbritëse të kritikuara me të drejtë nga Stiglitz, Johnson dhe Rogoff. Më të rëndësishme janë premtimet për një stimulim të fortë të rritjes së Keynesianizm-it, të një lehtësimi të procedurave të vetëfinancimit që i mban shumë të punësuar nga shtëpia larg prej tregjeve të hipotekës dhe të disa reformave të ndjeshme në sistemin e taksave, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me nxitjen e përfitimit të riatdhësi- mit nga kompanitë amerikane dhe rritjen e tatimit në burim.

Të gjitha këto, në fund të drejtojnë në pyetjen se si presidenca e Trump ka gjasa të krijojë mendimin ekonomik global dhe të ardhmen e kapitalizmit? Phelps ofron një prognozë të zyrtë duke u shprehur se risitë amerikane, fillimisht nisën të binin ose të ngushtoheshin qysh në fund të viteve 1960 për shkak të ideologjisë korporatiste që përshkruante të gjitha nivelet e qeverisjes. Vërtet, **Silicon Valley** krijoi industri të reja dhe përmirësoi ritmin e inovacionit për një kohë të shkurtër, por, tani ajo ka dalë kundër pakësimit të përfitimeve të kthyeshme.

Phelps e sheh zgjidhjen në përpunimin e ideologjisë individualiste mbi të cilën lulëzoi kapitalizmi dhe në ringjalljen e frymës novatore amerikane: dashuria për përfytyrimin, eksplorimin, eksperimentim dhe krijimin. Por, ai beson se kjo nuk është axhenda e Trump. Trump e ka përmendur shumë rrallë inovacionin dhe grupi i tij i punës është duke marrë në konsideratë një qasje të rrezikshme, e cila në fakt mund ta shkatërrojë atë. Rritje në ndërhyrjen e qeverisë, frenim i tregtisë dhe i konkurrencës dhe zgjerim i politikës korporatiste, përkrahja e të cilave nuk ishte shfaqur prej ekonomisë fashiste Gjermane dhe Italiane të viteve 1930. Por, çdo politikë që i shërben mbrojtjes

së funksionarëve dhe bllokimit të të sapoardhurve, me shumë gjasa do të ngul “një shigjetë” në zemër të procesit të inovacionit.

Unë jam me shumë optimist në lidhje me perspektivën afatgjatë. Kapitalizmi është një sistem evolucionar që i përgjigjet krizave duke transformuar rrënjësisht të dy komponentët, si lidhjet ekonomike ashtu dhe institucionet politike. Mesazhi i revoltave të sotme popullore është se politikanët duhet të heqin dorë nga paketat e para-krizës dhe të inkurajojnë një revolucion të mendimit ekonomik.

Trump përfaqëson një refuzim të plotë të mendimit ekonomik që ka dominuar botën për një brez. Formësimi i të menduarit tëri ekonomik do të jetë sfida më e rëndësishme gjatë viteve të ardhshme për të dyja palët, për ekonomistët dhe për politikanët. Në vlerësimin tim, tiparet përcaktuese të çdo transformimi të njëpasnjëshme të kapitalizmit global, kanë bërë një zhvendosje të kufijve midis ekonomisë dhe politikës, midis besimit në forcat e tregut dhe mbështetjes në ndërhyrjen e qeverisë.

Yoon Young-Kwan, një ish-ministër i Jashtëm i Koresë së Jugut, bën një vështrim të ngjashëm. “Ne jemi ndërmjet dy regjimeve”, shkruan ai. “Populizmi, nacionalizmi dhe ksenofobia notojnë mbi sipërfaqen e një ndryshimi të madh, një ndryshimi thelbësor në të gjithë botën mbi marrëdhëniet shteti-treg”. Bashkërendimi i këtyre dy fushave të veprimtarisë është shqetësimi kryesor i politikave të sotme ekonomike, ashtu siç ishte për Adam Smith në shek.. XVIII, për Friedrich List dhe Karl Marks në shek. XIX dhe për John Maynard Keynes dhe Friedrich von Hayek në debatin e tyre të gjatë mbi këtë temë gjatë mesit të dhjetëvjeçarit të shek. XX.

Dhe, në të vërtetë, Trump është simptoma më e mprehtë e fenomenit global. Pakënaqësitë sociale dhe politike do të vazhdojnë të fluskojnë rreth botës derisa të rikthejmë marrëdhëniet shtet-treg në një ekuilibër të shëndetshëm.

Presidenca Trump, si anti-themelim i përmbysjeve në Evropë dhe gjetkë, do të detyrojë mbarë botën të ngrejë pyetjen themelore: *Si do të evoluojnë marrëdhëniet mes tregut dhe qeverisë në fazën tjetër të kapitalizmit global?*

Gjatë katër viteve të ardhshme, nën udhëheqjen e Trump, politikat ekonomike të SHBA-së, nuk kanë shumë gjasa të japin përgjigjen e duhur, por administrimi i tij mundet të paktën t’i tregojë botës çfarë nuk duhet të bëjë.

BIBLIOGRAFIA

1. Giordano, S. 2016. *La fine del capitalismo*. Dieci scenari, Asterios Italia.
2. Kaletsky, A. 2011. *Capitalism 4.0 The birth of new economy*. Bloomsbury London.
3. Reich Robert, B. 2015. *Comesalvareil capitalismo*, Fazi Italia.
4. Sharma, K. M. 2007. *Globalization, Privatisation and market economy*. Jaipur.
5. <https://www.ft.com/>
6. <https://www.ilsole24ore.it/>
7. <https://www.project-syndicate.org/>
8. <https://www.worldbank.org/>
9. <https://www.economist.com/>

SUMMARY

Globalization is the phenomenon of our times. In almost every area of human activity, the international interconnectedness of peoples, institutions, states and systems is increasing exponentially. This applies whether the activities are economic, social, cultural, technological, environmental or political. The issues and problems that arise in each of these spheres are also becoming increasingly global in scale. In this sense this paper is aiming to explore different facets of the complex, evolving phenomenon of globalization in accordance to the new capitalist system called trumping capitalism. In this work we aim to give answers by referring to some analyzes made by some economists. Is it possible that Trumpism is actually the end of the beginning? Could Trump's victory mark the end of a period of post-crisis confusion, when the economic model that failed in 2008 was finally recognized as irretrievably broken, and the start of a new phase of global capitalism, when a new approach to economic management gradually evolves? We will also refer to previous systemic crisis of global capitalism trying to answer this question: Could Trumpism - understood as a lagged response to the 2008 crisis - herald the emergence of a new capitalist regime? This question can be divided into three parts: Can Trump's economic policies work? Will his administration's economic program be politically sustainable? And what impact might Trumpism have on economic thinking and attitudes to capitalism around the world? Trying to understand the future prospective of this system in global economic relations in accordance with the opinions of the various American and world economists. It does also introduce some of the main debates about the globalization and its effects in the global economy.

Keywords: *Globalization, Capitalism, Trumpism, protectionism, liberalization.*

TË MËSUARIT THELLUES PËRMES PEDAGOGJISË TRANSFORMUESE

MSc. Aida Zoto*

*“Më trego, do të harroj.
Më mëso, do të mbaj mend.
Më përfshij, do të mësoj.”*

Benjamin Franklin

ABSTRAKT

Arsimimi si vlerë universale e shoqërisë njerëzore, është zhvilluar në një ndërlidhje të ngushtë me zhvillimet shkencore, teknologjike, ekonomike, sociale, kulturore e politike. Për këtë arsye, sistemet arsimore janë përpjekur për përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm jo vetëm të njohurive por dhe të aftësive personale e profesionale të individëve. Përmes përmbajtjes, qëllimit, metodologjisë dhe strukturës së tyre organizative, këto sisteme janë përpjekur t’iu japin zgjidhje kërkesave të shoqërive.

Edhe pse teoritë e ndryshme arsimore dallojnë midis tyre, ende asnjë metodë pedagogjike nuk ka mundur të përmbledhë

* Pedagoge e Gjuhës Greke, Kolegji Universitar “Logos”.

të gjitha dimensionet e ndërtimit mendor, emocional dhe psikofizik të njeriut. Megjithëse përfundimet shkencore mbi procesin e të mësuarit dhe të nxënies dhe këndvështrimet nga shkencat kognitive (njohëse) e perspektivat Neuro-shkencore, kanë përparuar, ende ka shumë punë për t'u realizuar.

Procesi i të mësuarit përqendrohet në etapat e zhvillimit të të nxënies dhe format e shumëllojshme të inteligjencës. Faktorë që kontribuojnë në këtë proces janë zhvillimet fiziologjike, mjediset e të mësuarit, mësimdhënia, proceset socio-kulturore, etj.

Pedagogjia Transformuese, si strategji mësimore efektive e autentike, dhe përmes metodës së mësuarit thellues, nxit zbulime të vetvetes, të ideve, të botes përreth, të identitetit dhe ndihmon studentët që të bëhen mendimtarë të pavarur, krijues të rinj dhe komunikues efektivë si në nivel individual ashtu dhe në nivel shoqëror.

Fjalë kyçe: *Arsimi, strategji mësimore, të mësuarit thellues, Pedagogji transformuese*

Mësimi dhe shkenca e të mësuarit

Gjatë viteve, të shumta kanë qenë spekulimet dhe hipotezat lidhur me natyrën e mendjes njerëzore dhe mënyrës të së menduarit. Por, në ditët e sotme, falë mjeteve dhe metodave bashkëkohore të kërkimit, prurjeve e rezultateve shkencore të jashtëzakonshme nga shkencëtarë të shquar të fushave të ndryshme, mendja, truri, proceset nervore, proceset e të menduarit dhe të mësuarit, dhe zhvillimi i kompetencës janë të kapshme. Edhe pse në thelb janë hipoteza shkencore, të eksportuara nga vëzhgimi dhe studimi i rasteve të shumta, procesi i të mësuarit është i pafund dhe lë vend për studime të mëtejshme.

Shkenca kognitive (njohëse) dhe studimet lidhur me natyrën e proceseve njohëse, emocionale dhe sociale të të mësuarit i kanë ofruar arsimit jo vetëm teori të reja e efektive, të cilat po vihen në zbatim për hartimin e kurrikulave

të reja, por edhe ndryshim të metodave të mësimdhënies e të vlerësimit të studentëve.

Në thelb, shkenca e të mësuarit ofron shumë më tepër informacion në ditët e sotme dhe premton evoluime të mëtejshme në gjeneratën e ardhshme edhe pse shpesh herë këto evoluime përmbysin ose kundërshtojnë disa prej koncepteve tradicionale pedagogjike të të mësuarit.¹

Çfarë është të mësuarit?

Qasja e parë për të përshkruar procesin e të mësuarit u realizua nga Saljö², i cili përmes intervistave të grup-moshave 18-70 vjeç, kategorizoi procesin e të mësuarit si më poshtë: a) rritje të njohurive të individit, b) memorizim dhe riprodhim, c) aplikim, d) të kuptuarit, dhe e) një këndvështrim ndryshe mbi gjithçka.

Giorgi³, përmes një metodologjie ndryshe, konfirmon këto ndarje dhe hedh një këndvështrim më fenomenologjik mbi procesin, ndërsa Marton, Dall'Alba, dhe Beaty⁴, pas një studimi të kryer në Universitetin Britanik, për më tepër shtuan dhe një kategori të gjashtë, f) me anë të të mësuarit bëhesh njeri tjetër.

Sipas Fjalorit së gjuhës shqipe, të mësuarit është procesi përmes të cilit individi përvetëson njohuri, aftësi, shprehje dhe vlera. Gjithçka realizohet përmes ndërthurjes së materialeve didaktike dhe zbatimit të proceseve njohëse. Edhe pse termi mësim sugjeron procesin e të mësuarit si rezultat i punës së organizuar dhe të rregullt të mësuesit në shkollë, sipas një programi të caktuar⁵, ky term ka një kuptim më të gjerë.

1. National Research Council. 2000. Inquiry and the National Science Education Standards (A Guide for Teaching and Learning).

2. Saljö, R. 1979. Learning in the learner's experience. 1. Some common-sense conceptions. In Report No 76. Department of Education, University of Göteborg.

3. Giorgi, A. 1986. A phenomenological analysis of descriptions of concepts of learning from a phenomenological perspective. Publikationer fran institufionem for pedagogik, Goteborgs Universitet.

4. Marton, F., Dall'Alba, G. and Beaty, E. 1993. Conceptions of learning. International Journal of Educational Research, fq. 277-300.

5. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. 2002. Fjalor i shqipes së sotme. Tiranë: Toena, fq.779.

Flouris⁶ shprehet se të mësuarit mbetet një proces i cili ende nuk është interpretuar, kuptuar apo pranuar plotësisht nga të gjithë aktorët e përfshirë në të. Në thelb ato që shkruhen dhe thuhën në lidhje me të mësuarit janë hipoteza shkencore që rrjedhin nga vëzhgimi dhe studimi i procesit të tij.

Nga ana tjetër, Trilianos⁷ vë në dukje se ka një divergjencë e madhe mes studiuesve mbi përcaktimin e konceptit të të mësuarit. Kohë pas kohe, të mësuarit u përcaktua si krijimi i refleksive zëvendësuese (Pavlov), si gjykim dhe gabim (Thorndike), si përsëritje e reagimeve pozitive (Skinner), si pasqyrë (Kohler), si imitim i modelit origjinal (Bandura), si përpunim i informacionit (Neisser, Seymour, Gagné) dhe si interpretim personal i informacionit të fituar rishtas (Maslow, Rogers).

Më tej, Gagné⁸ shprehet se të mësuarit është një proces që ndihmon organizmat për të modifikuar sjelljen e tyre në një kohë relativisht të shkurtër dhe në mënyrë të përhershme (ndryshimi nuk ndodh në mënyrë të përsëritur për çdo rast të ri). Ky ndryshim apo modifikim perceptohet nga vetë personi që mëson, pasi pas përfundimit të procesit të të mësuarit, ai do të jetë i aftë të kryej veprime të cilat nuk mund t'i realizonte më parë.

Së fundmi, një përkufizim i ofruar nga Kimble⁹, ndoshta dhe më përfaqësues, sugjeron se të mësuarit është një ndryshim relativisht i qëndrueshëm, pjesë e tiparit të sjelljes, i cili ndodh si pasojë e praktikës së përfortuar.

Si mëson truri?

Siç u shprehëm edhe më sipër dhe duke qenë se procesi i të mësuarit ende është jo plotësisht i qartë, ai përbën objekt studimi të shkencave të ndryshme. Duke marrë parasysh se ky proces ndikon gjithanshëm në zhvillimin dhe modifikimin e personalitetin e individit, nevoja për të kuptuar kompleksitetin e trurit njerëzor u bë e domosdoshme. Mjetet e reja eksperimentale

6. Φλουρίης, Γ. 2003. Σκέψεις για την αναζήτηση ενός πλαισίου επιμόρφωσης και δια βίου μάθησης των εκπαιδευτικών στην κοινωνία της γνώσης. Αθήνα: Περιβολάκι και Ατραπός.

7. Τριλιανός, Θ. 2003. Μεθοδολογία της σύγχρονης διδασκαλίας Ι. Αθήνα: Περιβολάκι και Ατραπός.

8. Gagné, R, M. 1975. Essentials of learning for instruction, Principles of educational psychology series. University of Michigan: Dryden Press.

9. Kimble, G, A. 1980. Principles of General Psychology, John Wiley & Sons Inc; 5th edition: Hardcover.

dhe metodologjitë bashkëkohore u mundësuan shkencëtarëve fillimin e studime serioze mbi funksionimit mendor (të menduarit dhe procesin e të mësuarit)¹⁰.

Që nga fillimet e saj, shkenca kognitive (njohëse) studioi procesin e të mësuarit nga një perspektivë multidisiplinare që përfshinte Psikologjinë, Fiziologjinë, Antropologjinë, Neuroshkencën, Shkencat kompjuterike, Pedagogjinë, etj.¹¹ Për shkak të aspekteve të ndryshme të secilës shkencë, këndvështrimi dhe përkufizimi i tyre i shërben çdo herë një funksioni të ndryshëm.¹²

Kështu, Psikologjia sociale dhe kognitive (njohëse) studion kuptimin e natyrës së performancës kompetente dhe parimet e organizimit të njohurive. Ato formojnë shtresën bazë të aftësive të njerëzve për zgjidhjen e problemeve në një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë matematikën, shkencën, letërsinë, studimet sociale dhe historinë.

Fiziologjia, ka treguar se fëmijët mësojnë dhe përvetësojnë lehtas parimet themelore të biologjisë dhe shkakësisë fizike në lidhje me numrat dhe narrativat. Këto aftësi u mundësojnë atyre krijimin e programeve të reja për t'u njohur me koncepte të rëndësishme, për arsyetimin e avancuar në moshë të hershme si dhe përdorimin e tyre në mjedise të reja.

Antropologjia trajton procesin e të mësuarit nga ana e normave dhe pritshmërive kulturore e sociale, dhe tregon se ndikimi i të mësuarit e transferon individin në mënyra të fuqishme.

Neuroshkenca, ofron prova të qarta për shumë parime të të mësimit dhe vërteton se të mësuarit e ndryshon strukturën fizike dhe organizimin funksional të trurit. Nga perspektiva e saj zhvillimi i trurit dhe zhvillimi psikologjik përfshijnë ndërveprime të vazhdueshme midis individit dhe mjedisit të jashtëm, më saktë, mes hierarkisë së mjediseve, që shtrihet nga niveli i qelizave individuale të trupit deri në kufirin më të dukshme të lëkurës. Koizumi¹³, shprehet se të mësuarit është një proces fiziologjik ku truri

10. Anderson, J.R. 1982. Acquisition of cognitive skill. *Psychological Review*, fq. 369-406.

11. Norman, D. A. 1980. Twelve issues for cognitive science. *Cognitive Science*, 4, 1-32.

12. Newell, A. & Simon, H. A. 1972. *Human Problem Solving*. Englewood Cliffs. NJ:Prentice-Hall.

13. Koizumi, H. 2003. *Science of Learning and Education: An Approach with Brain-function Imaging*, NoTo Hattatsu, Vol. 35, No. 2, fq. 126-129.

reagon ndaj stimujve dhe kryen lidhje neuronale të cilat veprojnë si një qark i përpunimit të informacionit. Në fund të këtij procesi, informacioni ruhet.

Teknologjitë e reja dhe shkencat kompjuterike po zhvillojnë shumë mundësi të reja drejt rritjes dhe përmirësimit të cilësisë të procesit të të mësuarit. Mundësi, metoda dhe praktika, të paimagjinueshme disa vite më parë.

Së fundmi, Pedagogjia dhe më konkretisht fusha e mësimdhënies, e trajton procesin e të mësuarit nga arkitektura e mësimdhënies dhe vë në dukje se ky proces i përcaktohet nga veprimtaritë mësimore (vazhdimësia si pjesë e një kapitulli mësimor, program i shkurtër i drejtuar apo edhe kurrikul e integruar). Pra, kjo fushë përcakton përmbajtjen e një programi mësimor.¹⁴ Madje Coffield, pohon se të mësuarit i referohet ndryshimeve të rëndësishme në aftësi, në të kuptuar, në qëndrimet dhe vlerat e individëve, grupeve, organizatave apo shoqërive. Ai në mënyrë eksplicite përjashton mbledhjen e informacione të mëtejshme kur ato nuk vijnë si pasojë e ndryshimeve të sipërpërmendura.¹⁵

Të gjitha këto do të ishin të pamundura pa makinën kryesore të funksionimit të njeriut, vetë trurin. Po si reagon ai ndaj procesit të të mësuarit? Si mendojnë dhe mësojnë njerëzit? Për përgjigjen e kësaj pyetje na vjen në ndihmë Neuroshkenca dhe shkencat kognitive (njohëse).

Edhe pse truri luan rol themelor dhe është në ndërveprim të vazhdueshëm me të gjitha pjesët e trupit, ai përsëri mbetet një pjesë e vetme e një organizmi të tërë.

Truri i njeriut është i përbërë nga një numër i rajoneve të ndryshme. Secila nga këto rajone ka rëndësi dhe funksione të specializuara në shikim, në dëgjim, në të folur, në prekje, në kujtesën afat-shkurtër, në kujtesën afat-gjatë, në gjuhën dhe në aftësinë e të arsyetuarit.¹⁶ Sigurisht që gjuha dhe të arsyetuarit janë më të rëndësishmet për procesin e të mësuarit.

14. Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE). 2013. MËSIMDHËNIA E TË MËSUARIT.

15. Coffield. 2005. It takes two to tango. Paper written upon request of CERl in preparation of the 4th meeting of the CERl's Lifelong Learning Network. Wako-shi. 2004.

16. Mandal, A. 2013. Human Brain Structure. <http://www.news-medical.net/health/Human-Brain-Structure.aspx>

Truri vepron si një rrjet i dendur fibrash, i përbërë prej rreth 100 miliardë neuroneve dhe është i ndarë përafërsisht në tri pjesë kryesore: a) truri i madh, b) truri i ndërmjetëm, dhe c) truri i vogël.¹⁷ Truri i vogël ka rol kryesor për procesin e të mësuarit, pasi ky është vendi ku funksionet më të larta si kujtesa dhe arsyetimi ndodhin. Përmes një rrjeti neuronesh, informacioni ndijor transmetohet me anë të sinapseve përgjatë shtegut nervor dhe ruhet përkohësisht në kujtesën afat-shkurtër, e cila vepron si një qendër pritëse. Pasi këto informacione përpunohen në kujtesën afat-shkurtër, atëherë përmes rrugëve nervore të trurit ato përçohen si kujtime në bërthamën strukturore, ku krahasohen me kujtimet ekzistuese dhe ruhen në kujtesën afat-gjatë, aty ku gjendet çdo ngjarje që kemi përjetuar në jetën tonë. Pra, fjalët, fotografitë, dhe kategoritë e tjera të informacionit që përfshijnë procese të përsëritura komplekse kognitive (njohëse), aktivizojnë trurin i cili vë në lëvizje ngjarjet që janë koduar si pjesë e kujtesës afat-gjatë. Në fund gjithë të dhënat mbledhen në një tablo të plotë duke u bërë kujtim i një ngjarjeje. Nuk i jepet rendësi vetëm arsyes apo logjikës, pasi veç e veç këto nuk mund të krijojnë kujtime të fuqishme, por angazhohen të gjitha shqisat dhe anët emocionale të trurit (humori, tregimi, aktivitetet në grup dhe lojërat).

Hipotezat e mësipërme vërtetohen dhe nga Spitali i Massachusetts¹⁸ në bashkëpunim me Shkollën Mjekësore Harvard¹⁹, të cilët duke u bazuar në tri pika kryesore, të cilat zgjerojnë njohuritë e mekanizmave të trurit gjatë procesit të të mësuarit, sugjerojnë se: a) të mësuarit ndryshon strukturën fizike të trurit, b) këto ndryshime strukturore ndryshojnë organizimin funksional të trurit (procesi organizon dhe riorganizon trurin), dhe c) pjesë të ndryshme të trurit mund të jenë gati për të mësuar në kohë të ndryshme.

Në thelb mund të themi se të mësuarit kërkon pranimin e informacioneve të reja, pra truri ynë përqendrohet në hyrjet e reja dhe harron tepricat e panevojshme. Duke qenë i programuar për t'i kushtuar vëmendje të veçantë

17. Medical Clinic. <http://shmtiep.wixsite.com/shmiep/single-post/2014/05/05/Truri-i-njeriut-dhe-pjeser-kryesore>

18. University of California. Irvine's Center for the Neurobiology of Learning and Memory (CNLM).

19. Martinos Center for Biomedical Imaging. Department of Radiology. Massachusetts General Hospital & Harvard Medical School.

çdo përvojë të re apo të pazakontë, truri krahason informacionin e ri (kujtesa afat-shkurtër) dhe informacionin ekzistues (kujtesa afat-gjatë). Kur gjen një përputhshmëri, atëherë ai duke e menduar kujtimin e ri si të tepërt, e eliminon. Megjithatë, në rastet kur informacioni i ri është i dobishëm për ne, ai bëhet një kujtim i përhershëm. Me anë të kësaj procedure truri ynë bëhet një alet natyror i të mësuarit.²⁰

Proceset e të mësuarit

«Studentët e mi nuk kuptojnë asgjë! Studentët e mi nuk përpiqen të mësojnë as konceptet bazë!», janë disa nga shprehjet dhe pakënaqësitë e dëgjuara shpesh nga mësuesit dhe profesorët. Ndërsa nga ana tjetër studentët ankohen: «Çfarë presin profesorët më shumë nga mua? Çfarë duhet të bëj që të marr këtë lëndë?» Gjatë dyzet viteve të fundit një numër i konsiderueshëm studimesh janë përpjekur të hedhin dritë mbi faktin se përse profesorët dhe studentët nuk gjejnë gjithmonë një rrugë të përbashkët. Literatura mbi të mësuarit thellues ofron ide të pasura e të plota se si studentët dhe profesorët mund të punojnë së bashku për të gjetur përvojat më kuptimplota për procesin e të mësuarit.

Analiza e profesorëve Bain dhe Zimmerman²¹, duke u bazuar në eksperimentin e kryer në Universitetin e Suedisë²², paraqet në mënyrë të detajuar qasjen e studentëve drejt procesit të të mësuarit. Duke marrë parasysh dëshirën që ata kanë për studimet e tyre, Degën që ata studiojnë dhe strategjitë që ata ndjekin për të përfunduar studimet, analiza i ndan studentët dhe procesin e tyre të të mësuarit në tri kategori: a) të mësuarit sipërfaqësor, b) të mësuarit thellues, dhe c) të mësuarit strategjik.²³

20. Ford, D.J. 2011. How the Brain Learns. <https://www.trainingindustry.com/content-development/articles/how-the-brain-learns.aspx>

21. Bain, K., Zimmerman, J. 2009. ANALYSIS: Understanding Great Teaching. Peer Review. AAC&U.

22. Eksperimenti i kryer në vitin 1976, u kërkonte studentëve t'u përgjigjeshin disa pyetjeve lidhur me një tekst që iu ishte dhënë për lexim. Bazuar në përgjigjet e studentëve, hulumtuesit nxorën përfundime mbi procesin e të mësuarit.

23. Bain, K. 2013. Introduction: Growing Deep Learning, Teaching and Learning Together in Higher Education: Iss. 8.

Në kategorinë e parë bëjnë pjesë ata studentë që, në përgjithësi, përpiqen t'i mbijetojnë shkollës, të kalojnë lëndën dhe të marrin diplomën. Ata kanë frikë dështimin ndaj edhe shpesh përdorin mënyrën më të lehtë, sipas tyre, për të mësuar duke riprodhuar atë çka munden nga çdo lëndë, në formë rutine, qoftë hapat për zgjidhjen e një problemi, qoftë informacione të izoluara. Janë pranues pasivë të ideve dhe të informacioneve dhe përqendrohen vetëm në atë që është e nevojshme për vlerësim nga profesori. Nuk reflektojnë në qëllimet apo strategjitë për zgjidhjen e një detyre dhe nuk bëjnë dot dallimin midis parimeve apo modeleve udhëzuese.

Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë ata studentë, të cilët qëllim primar kanë të kuptuarit dhe të zbatuarit të koncepteve të tyre me ide dhe metoda efektive. Këta studentë gjithmonë kërkojnë kuptimin përtej faqeve, shqyrtojnë ndikimet, aplikimet, përdorimet dhe mundësitë për zgjidhur problemet. Ata teorizojnë nga ajo çka kanë mësuar dhe të mësuarit ka një ndikim të thellë në mënyrën se si ata mendojnë, veprojnë, dhe ndihen në të ardhmen. Vetëm ata kanë gjasa të bëhen ekspertë që kanë mundësinë dhe ndjejnë nevojën për të kapërcyer metodat tradicionale dhe për shpikur të reja, më adaptive.

Ndërsa në kategorinë e tretë dhe të fundit, bëjnë pjesë ata studentë të cilët dëshirojnë të shkëlqejnë, të marrin nota të larta dhe të vlerësohen nga profesorët e tyre. Megjithatë, këto ambicie nuk shprehin dëshirën e tyre për të mësuar apo për të përdorur njohuritë e marra. Në klasë, zakonisht, e kalojnë kohën duke u përpjekur të zbulojnë se çfarë do t'i pyesë profesori dhe pavarësisht se mund të mësojnë përmendësh formula matematikore apo procese algoritmike, shpesh dështojnë t'i kuptojnë ato konceptualisht, thjesht sepse ky nuk është qëllimi i tyre. Kjo e metodë e të mësuarit nuk ka ndikim të qëndrueshëm apo substancial në mënyrën se si ata mendojnë, veprojnë dhe ndihen në të ardhmen.

Houghton²⁴, duke u bazuar dhe në studimet e fundit nga Ramsden, Prosser dhe Miller si dhe Trigwell²⁵ rreth procesit të të mësuarit thellues, i bashkohet

24. Houghton, W. 2004. Engineering subject centre guide: Learning and teaching theory forengineering academics. Higher Education Academy Engineering.

25. Ramsden, P. 1992. Learning to Teach in Higher Education. London: Routledge, fq. 263.

Prosser, M. & Miller, R. 1989. The 'how' and 'what' of learning physics, European Journal of Psychology of Education, 4(4), fq. 513-528.

Trigwell, K. & Prosser, M. 1991. High Education, fq. 251.

vlerësimit të tyre, duke sugjeruar se cilësia e të mësuarit dhe rezultatet e larta mund të arrihen vetëm përmes metodës së të mësuarit thellues. Ai shprehet se qëllimi i Arsimit Universitar është të inkurajojë të mësuarit thellues pasi vetëm përmes kësaj metode, studentët do të ndryshojnë mënyrën se si shohin botën. Projektimet dhe planifikimet e përshtatshme të kurrikulave mësimore, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të studentëve janë hapat e parë që të kjo metodë e të mësuarit të nxitet.

Në të njëjtat linja, Biggs dhe Tang²⁶, dhe duke mbështetur teorinë e Dr. Ramsden, ata shohin dhe analizojnë metodën e të mësuarit thellues si nga perspektiva e studentëve ashtu dhe nga ajo e profesorëve. Kështu, studentët përfitojnë: nxitje, përjasje, vendosmëri dhe angazhim maksimal me detyrën e dhënë; lindje të një kurioziteti të brendshëm, eksplorim dhe gjetje të pyetjeve apo përgjigjeve; krijim dhe pasurim të njohurive fillestare; nivel të lartë përqendrimi konceptual; krijim të një baze të mirë e të strukturuar të njohurive; aftësi të të punuarit në mënyrë të organizuar dhe jo me detaje të veçuara; përvoja kuptimplota.

Më tej analiza vazhdon me avantazhet e po kësaj metode të të mësuarit, parë nga ana e pedagogëve. Sipas tyre, me anë të kësaj metode: struktura apo tema e lëndës paraqitet në mënyrë të qartë; përftohet një reagim aktiv nga studentët (me anë të pyetjeve, problemeve dhe përgjigjeve, në vend të mësimdhënies tradicionale dhe thjesht shpjegimit të informacionit); mësimi ndërtohet dhe zhvillohet mbi bazat aktuale të studentëve; vlerësohet struktura dhe jo fakte të veçuara ose të pavarura; mundësohet konfrontimi dhe adresimi i keqkuptimeve nga ana e studentëve; me mësimdhënien dhe vlerësimin e duhur, inkurajohen dhe këshillohen studentët duke mbështetur qëllimet dhe synimet e lëndës; krijohet një atmosferë pozitive pune dhe bashkëpunimi; studentëve u lejohen gabimet si formë mundësie për të mësuar prej tyre; i jepet më tepër rëndësi të mësuarit thellues se sa sasisë së informacionit të ofruar.

Edhe pse zhvillimet e fundit lidhur me studimin dhe të kuptuarit të procesit të të mësuarit kanë një rëndësi të veçantë në sistemet arsimore, dallimi

26. Biggs, J. & Tang, C. 2007. Teaching for Quality Learning at University - What the Student Does. 3rd edition. Poland: OZ Graf. S.A.

kryesor midis mënyrave të të mësuarit bazohet në vullnetin individual të studentit për të mësuar.

Pedagogjia transformuese

Arsimimi i lartë është i domosdoshëm pothuajse nga të gjithë në kompleksitetin e jetës bashkëkohore dhe qëllimet e sistemeve arsimore janë të ndihmojnë studentët jo vetëm të zhvillojnë mjetet intelektuale, por dhe të mësojnë strategjitë e nevojshme, të fitojnë njohuri e të mendojnë në mënyrë produktive për historisë, shkencën dhe teknologjinë, fenomenet sociale, matematikën, dhe artet.²⁷

Fullan dhe Langworthy²⁸ argumentojnë se, nëse forma të reja pedagogjie nuk aplikohen, studentët do të shfaqin gjithmonë e më pak interes dhe apati ndaj lëndëve ndërsa profesorët do të ndjejnë më tepër stres. Sipas tyre metodat e reja pedagogjike do të kërkojnë ndryshime rrënjësore në marrëdhëniet mes profesorëve dhe studentëve, si në strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënies, ashtu dhe në mënyrën e të vlerësuarit.

Po ku bazohet një student për të përzgjedhur metodën e të mësuarit? Përse disa zgjedhin të mësuarit sipërfaqësor, disa të mësuarit thellues e

të tjerë të mësuarit strategjik? Nëse mendoni se përgjigja është e thjeshtë dhe se studentët e zgjuar ndjekin metodën e të mësuarit thellues ndërsa studentët më pak të aftë metodën e të mësuarit sipërfaqësor apo strategjik, atëherë gaboheni! Arsimitarët, është përgjigja!

Arsyet kryesore përse studentët ndjekin një metodë të caktuar kanë të bëjnë vetëm me arsimtarin dhe mënyrën e qasjes së tij ndaj tyre. Disa profesorë «krijojnë» shpesh studentë me qëllime thelluese e ndërsa të tjerë rrallë. Pra, mund të quajmë profesorë «të mëdhenj» ata njerëz të cilët kanë sukses të konsiderueshëm e rezultate të larta në nxitjen e qasjeve të të mësuarit thellues tek studentët e tyre. Edhe pse profesori nuk mund t'iu

27. Scardamalia, M. & Bereiter, C. 1991. Higher levels of agency for children in knowledge-building: A challenge for the design of new knowledge media. *Journal of the Learning Sciences*, fq. 37-68.

28. Fullan, M., & Langworthy, M. 2013. Towards a new end: New pedagogies for deep learning.

diktojë studentëve mënyrën që ata do të përzgjedhin për të mësuar efektivisht, ai mund t'iu krijojë mundësi dhe t'i inkurajojë në një numër mënyrash, kjo është diçka arsimtarët shumë të suksesshëm e kuptojnë thellësisht.²⁹

Në këtë kontekst, kontributi i arsimtarëve për të zhvilluar aftësitë metodologjike, vlerat, qëndrimet, aftësitë e të menduarit dhe të mësuarit të studentëve, për t'u përballur me shoqërinë e dijeve dhe të informacionit, të tilla si aftësitë e komunikimit, bashkëpunimit me të tjerët, përdorimin e burimeve të ndryshme të mjeteve të informacionit dhe komunikimit, zgjidhjen e problemeve etj., është thelbësor.³⁰

Mësimdhënie dhe mjedise efektive

Në pjesën e parë të shekullit të njëzetë, arsimi ka qenë i fokusuar në përvetësimin e aftësive kryesore edukative: të lexuarit, të shkruarit, dhe të llogariturit. Por në ditët e sotme sfidat dhe pritjet kanë ndryshuar në mënyrë dramatike.³¹ Ndryshimet e njëpasnjëshme të shoqërisë dhe nevoja e përshtatjes së kurrikulave mësimore përbën një domosdoshmëri.³² Metoda e të mësuarit thellues rekomandon strategji të mësimdhënies të cilat prej kohësh konsideroheshin praktika efektive, si të mësuarit duke u bazuar në projekte, vlerësimet afatgjata kumulative, kurse këshilluese etj., pra metoda pedagogjike që i kanë rrënjët në filozofinë konstruktiviste.³³ Scardamalia dhe Bereiter³⁴ me anë të eksperimentit të tre mësuesve përpiqen të na tregojnë se si qëndrimet dhe praktikat e arsimtarëve ndikojnë tek studentët.

Një grup studentësh punojnë në grupe të përbashkëta dhe kanë si detyrë të prodhojnë një prezantim multimedial. Mësuesi A kërkon nga studentët të

29. Bain, K., Zimmerman, J. 2009. ANALYSIS: Understanding Great Teaching. Peer Review. AAC&U.

30. Διαθεματικό Ενιαίο Πλαίσιο Προγραμμάτων Σπουδών (ΔΕΠΠΣ). 2003.

31. Bruer, J.T. 1993. Schools for thought. Cambridge, MA: MIT Press.

32. Kress, G. 1999. Education of the 21st century. Inaugural Lecture. Institute of education. University of London.

33. Dewey, J. 1997. How we think. New York, NY: Dover Publications.

Ginsburg, H. P., & Oppen, S. 1987. Piaget's theory of intellectual development (3rd ed). New York, NY: Pearson.

34. Scardamalia, M. & Bereiter, C. 1991. Higher levels of agency for children in knowledge-building: A challenge for the design of new knowledge media. Journal of the Learning Sciences, fq. 37-68.

prodhojnë sa më shumë punë. Ai i mbikëqyr dhe vëzhgon vazhdimisht sasinë dhe cilësinë e punës së kryer prej tyre. Fokusi është në aktivitete të ndryshme, nisur nga ato manuale të stilit të vjetër me anë të librave e deri në projektet e kohëve të fundit me teknologji të përparuar. Mësuesi B merr mbi vete përgjegjësinë për atë çka nxënësit do të mësojnë përgjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre. Mësuesi C gjithashtu merr mbi vete përgjegjësinë, por dhe me një objektiv shtesë. Ai fokusohet më tepër mbi procesin e të mësuarit nga studentët. Pas disa ditësh punim vihen re dhe dallimet midis mësuesve A dhe B. Mësuesi A është tërësisht i fokusuar në procesin e prodhimit dhe në produktin kryesor - pavarësisht angazhimit të studentëve, apo pavarësisht produktit cilësor të dorëzuar. Mësuesi B gjithashtu është pjesë e kësaj procedure, por mësuesi B sigurohet që studentët po mësojnë nga përvoja dhe merr masa për t'u siguruar që studentët po përpunojnë realisht mbi përmbajtjen e detyrës dhe jo thjesht të paraqesin një produkt përfundimtar. Megjithatë për të parë ndryshimin mes Mësuesit B dhe C, duhet të shkojmë pas, në projektin fillestar të prodhimit multimedial. Përse u përzgjedh ky projekt? A u konceptua që në fillim si një aktivitet mësimor, apo erdhi si rezultat i një përpjekjeje për të zhvilluar njohuri konstruktive tek studentët?

Në përfundim të eksperimentit dallimet dhe konkluzionet janë shumë të thella. Në klasën e Mësuesit A, studentët po mësojnë diçka në lidhje me prodhimin e medias, por ky prodhim multimedial mund të jetë një pengesë për të mësuar gjithçka tjetër. Në klasën e Mësuesit B, mësuesi po përpiqet që qëllimet origjinale arsimore të kësaj veprimtarie të përmbushen dhe të mos jetë thjesht një ushtrim se si mund të prodhojmë multimedial. Në klasën e Mësuesit C, prodhimi multimedial është i vazhdueshëm dhe vjen si rezultat i drejtpërdrejt i të mësuarit, çka dhe merr formë në punimin përfundimtar. Pjesa më e madhe e punës së Mësuesit C është bërë shumë herët, para se vet ideja e projektit multimedial të konceptohej. Ajo çka ai bën tani është të ndihmojë studentët të jenë të fokusuar mbi qëllimet e tyre gjatë kohës që punojnë projektin. Për studentët, aftësitë dhe përmbajtja së njohurive të fituara gjatë realizimit të produktit përfundimtar, kanë rëndësi strukturore për kompleksitetin e jetës reale.

Këta mësues hipotetikë A, B, dhe C, janë modele abstrakte që natyrisht me disa mësues përshtaten pjesërisht e me të tjerë disi më shumë. Këto modele japin këndvështrime të rëndësishme të lidhjeve ndërmjet objektivave dhe praktikave mësimore.

Megjithatë nuk ka një recetë të thjeshtë as për një proces mësimor efektiv e as për mjediset efektive të mësimdhënies.

Motivim

Motivimi është thelbësor për të mësuar në mënyrë të suksesshme dhe mund të përshkruhet si një forcë rezultante e komponentëve fizikë dhe emocionalë, pasi përbën mënyrën se si truri vlerëson nëse duhet të veprohet - p.sh. ai do të afrohet, nëse ndjen kënaqësi dhe do të shmanget nëse ndjen pakënaqësi.

Një dallim themelor i motivimit është a) motivimi jokarakteristik (lidhur me faktorët e jashtëm) dhe b) motivimi i brendshëm (lidhur me faktorët e brendshëm). Ndërsa motivimi jokarakteristik arrihet duke ndikuar sjelljen nga jashtë (p.sh. me anë të shpërblimeve dhe ndëshkimeve, të dyja objektive apo simbolike), motivimi i brendshëm reflekton dëshirën për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e brendshme.³⁵

Sistemet tradicionale të arsimit përqendrohen përgjithësisht në motivimin jokarakteristik përmes ndëshkimit dhe shpërblimit. Edhe pse të mësuarit varet kryesisht nga faktorë të brendshëm, pra motivim të brendshëm, Neuroshkenca ende nuk ka përparuar mjaftueshëm në studimin e mekanizmave të brendshme për shkak të vështirësive të transkriptimit të imazheve neurologjike. Studimet e kohëve të fundit për trajtimin e sistemeve të brendshme të motivimit, kanë dhënë rezultate tepër pozitive por më shumë punë është e nevojshme në mënyrë që t'i lidhin ato në dobi të drejtpërdrejtë për arsimin.

35. McGraw, K.O. 1978. The Detrimental Effects of Reward on Performance: A Literature Review and a Prediction Model, in M.R. Lepper and D. Greene (eds.). The Hidden Costs of Reward: New Perspectives on the Psychology of Human Motivation. Lawrence Erlbaum. Hillsdale. NJ, fq. 33-60.

Keller³⁶, i referohet motivimit si zgjedhje e njerëzve në lidhje dhe synimet e tyre për të ndjekur ose shmangur eksperiencë, si dhe numrin e përpjekjeve që ata do të paguajnë për të arritur këtë synim.

Aubé³⁷, studion motivimin krahasuar rolit të emocioneve, nevojave dhe burimeve në dispozicion. Ai pohon se motivi ka si qëllimin final menaxhimin optimal të burimeve për të mirën e individit.

Së fundmi, Dimitriadis³⁸ beson se shtysë motivimi mund të konsiderojmë numrin e përpjekjeve (jo detyrimisht të suksesshme) si dhe ndjenjat e përjetuara gjatë angazhimit të individit si tregues i angazhimeve të ndërmarra.

Shumica pajtohen se shkolla nuk është gjithmonë argëtuese, dhe disa herë ajo vepron si një pengesë dhe në fakt mund të jetë dhe de-motivuese. Truri bëhet i motivuar nga bashkëveprimi i ndikimeve të brendshme dhe atyre të jashtme. Sfida e arsimtarëve është për të gjetur një rrugë të ndërmjetshme midis qëllimit për të mësuar dhe inkurajimit të studentëve.³⁹

Detyrat, vlerësimi dhe feedback (reagimi)

Kur është fjala për të mësuarit thellues, detyrat, vlerësimi dhe feedback janë vendimtare. Detyrat dhe vlerësimi i tyre duhet të pasqyrojnë objektivat e studentëve dhe të kursit, jo thjesht të kenë rol shpërblyes. Përveç kësaj, vlerësimet duhet të shqyrtohen dhe në aspektin e shpeshtësisë së tyre. Akademia e Arsimit të Lartë tërhiqet vërejtje: «Detyrat dhe testimet e shpeshta, e detyrojnë studentin të fokusohet rregullisht mbi materialin, por kjo metodë ka të ngjarë të ketë efekt të kundërt me atë të dëshiruar. Ju thjesht i inkurajoni ata në memorizimin e fakteve. Nga ana tjetër detyrat dhe testimet më të rralla në shpeshtësi, si dhe vlerësimet që nxisin studentët

36. Keller, J. M. 1983. Motivational Design of Instruction. In Reigeluth C. M. (edt.), *Instructional Design Theories and Models: An Overview of Their Current Status*. New York: Lawrence Erlbaum Associates Publishers, fq. 383-434.

37. Aubé, M. 1997. Toward Computational Models of Motivation: A Much Needed Foundation for Social Sciences and Education. *Journal of Artificial Intelligence in Education*. 8(1), AACE, fq. 43-75.

38. Δημητριάδης, Στ. 2000. Τεχνολογία των Πολυμέσων και η Εφαρμογή της στην Εκπαιδευτική Διαδικασία. Διδακτορική Διατριβή, ΑΠΘ, τμήμα Πληροφορικής.

39. OECD. 2007. *Understanding the brain: The birth of a learning science. The impact of environment on the learning brain*.

të kërkojnë dhe të angazhohen me probleme, do t'i inkurajojnë ata që të përdorin dhe të aplikojnë metoda drejt të mësuarit thellues.»⁴⁰

Feedback (reagimi), sipas studimeve të ekspertizës adaptive, është një faktor tejet i rëndësishëm për ecurinë e suksesshme të të mësuarit. Mendimet e studentëve duhet të jenë të qarta e të dukshme (përmes diskutimeve, detyrave, testeve), dhe feedback-u (reagimi), i cili mund të jetë formal ose informal, duhet t'ju ofrohet patjetër, diskret, jo si pjesë e mësimit, por të ketë funksion mbështetës.⁴¹

Shumica e profesorëve shprehin reagimet e tyre përmes notave të testeve apo të detyrave të kursit, ose me anë të një përmbledhjeje përfundimtare e cila ka si qëllim të vlerësojë rezultatet e të mësuarit dhe të të nxënit. Por, shpesh herë, pas marrjes së notave, studentët i drejtohen një lënde të re dhe rinisin punën për një vlerësim (notë) të re. Feedback-u (reagimi) është më i vlefshëm kur studentët e përdorin atë për të rishikuar mënyrën e të menduarit dhe lidhin veprimtaritë aktuale me pjesët e tjera të programit mësimor apo dhe me jetën e tyre.⁴²

Ofrimi i mundësive

Sipas Lublin⁴³, ka shumë gjasa që studentët të adoptojnë një qasje mësimi thellues ndaj lëndëve të caktuara, nëse në to ka elementë të zgjedhjes. Kur kjo është e pamundur, ose kur një lëndë është me detyrim, duhet bërë një

40. Houghton, W. 2004. Engineering Subject Centre Guide: learning and teaching theory for engineering academics. Loughborough: Higher Education Academy Engineering Subject Centre, Loughborough University.

41. Vye, N.J., Goldman, S.R., Voss, J.F., Hmelo, C., Williams, S. & Cognition and Technology Group at Vanderbilt. 1998a. Complex mathematical problem solving by individuals and dyads. *Cognition and Instruction* 15(4).

42. Black, P. & William, D. 1998. Assessment and classroom learning. In *Assessment and Education. Special issue of Assessment in Education: Principles, policy and practice*, fq. 7-75. Carfax Pub. Co./ Vye, N.J., D.L.Schwartz, J.D.Bransford, B.J.Barron, L.Zech, and Cognition and Technology Group at Vanderbilt 1998b SMART environments that support monitoring, reflection, and revision. In *Metacognition in Educational Theory and Practice*, D. Hacker, J.Dunlosky, and A.Graesser, eds. Mahwah, NJ: Erlbaum.

43. Lubin, J. 2003. Deep, Surface, and Strategic Approaches to Learning. Online Document from UCD Dublin Centre For Teaching and Learning. http://www2.warwick.ac.uk/services/ldc/development/pga/introtandl/resources/2a_deep_surfacestrategic_approaches_to_learning.pdf,

shpjegim sa më i detajuar i mundshëm, për rëndësinë dhe përmbajtjen e lëndës. Shpesh, kur ngarkesa e punës është e madhe apo sfiduese, studentët instinktivisht përdorin qasje sipërfaqësore për të mësuar. Duke ndihmuar studentët të bëjnë zgjedhje të mira për të menaxhuar më mirë ngarkesën e tyre mësimore, kemi zgjedhur një mënyrë të dobishme për t'i afruar ata drejt të mësuarit thellues.

Entuziazmi dhe Interesi

Nëse shfaqni interes dhe entuziazëm për lënë tuaj, me siguri keni gjetur mënyrën më të fuqishme për të nxitur entuziazëm dhe interes tek studentët tuaj. Por, nëse jeni qartësisht i mërzhitur apo i çinteresuar për lëndën, ka të ngjarë që studentë të mos kenë as interes dhe as entuziazëm. Modelimi dhe këshillimi janë dy nga metodat më të vjetra dhe më efektive në mësimdhënie, dhe në kohën e teknologjisë së përparuar dhe emocionuese, këto qasje, për të ndihmuar studentët të mësojnë janë ende të rëndësishme.

Mësimi i suksesshëm kërkon një vazhdimësi të përpjekjeve të koordinuara midis arsimtarëve dhe studentëve, duke nisur që nga arsimi parashkollor e deri tek mundësitë për një zhvillim afatgjatë si profesionistë. Krijimi i mundësive të tilla, të ndërtuara mbi bazën e njohurive nga shkenca e të mësuarit, paraqet një sfidë të madhe, por kjo nuk është një detyrë e pamundur.

Në përmbyllje të artikullin do të dëshiroja të paraqes disa kufizime të hasura gjatë këtij punimi, të cilat sigurisht do të kenë jo vetëm karakter informues, por do të jenë një shtysë për studime të mëtejshme në fushën e Pedagogjisë.

Fillimisht, rezultatet apo vëzhgimet e sjelljeve studentore, për të arritur në konkluzionet e mësipërme, janë rezultate të marra nga studentë apo nga Universitete jashtë Shqipërisë. Kjo nuk na jep një pasqyrë të qartë për realitetin tonë, pra, nëse studentët tanë ndjekin të njëjtat metoda drejt përgatitjes apo studimit të tyre, gjithmonë duke marrë parasysh se programet kurrikulare apo infrastruktura mund të kenë ndryshime.

Së dyti, edhe pse të mësuarit si koncept abstrakt, apo përkufizimi i Pedagogjisë Transformuese, janë përkufizuar më sipër, kryesisht, këto përkufizime janë të autorëve të huaj. Kjo për shkak se literatura e vendit tonë ka disa kufizime lidhur me këto koncepte.

Në përfundim, ftoj të gjithë të interesuarit për studime të mëtejshme dhe konkrete me studentët tanë lidhur me metodologjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

LITERATURA

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. 2002. Fjalor i shqipes së sotme. Tiranë: Toena, fq.779.
2. Anderson, J.R. 1982. Acquisition of cognitive skill. Psychological Review, fq. 369-406.
3. Aubé, M. 1997. Toward Computational Models of Motivation: A Much Needed Foundation for Social Sciences and Education. Journal of Artificial Intelligence in Education. 8(1), AACE, fq. 43-75.
4. Bain, K. 2013. Introduction: Growing Deep Learning, Teaching and Learning Together in Higher Education: Iss. 8.
5. Bain, K., Zimmerman, J. 2009. ANALYSIS: Understanding Great Teaching. Peer Review. AAC&U.
6. Biggs, J. & Tang, C. 2007. Teaching for Quality Learning at University - What the Student Does. 3rd edition. Poland:OZ Graf. S.A.
7. Black, P. & William, D. 1998. Assessment and classroom learning. In Assessment and Education. Special issue of Assessment in Education: Principles, policy and practice, fq. 7-75. Carfax Pub. Co./ Vye, N.J., D.L.Schwartz, J.D.Bransford, B.J.Barron, L.Zech, and Cognition and Technology Group at Vanderbilt 1998b SMART environments that support monitoring, reflection, and revision. In Metacognition in Educational Theory and Practice, D.Hacker, J.Dunlosky, and A.Graesser, eds. Mahwah, NJ: Erlbaum.
8. Bruer, J.T. 1993. Schools for thought. Cambridge, MA: MIT Press.
9. Coffield. 2005. It takes two to tango. Paper written upon request of CERI in preparation of the 4th meeting of the CERI's Lifelong Learning Network. Wako-shi. 2004.
10. Dewey, J. 1997. How we think. New York, NY: Dover Publications.

11. Eksperimenti i kryer në vitin 1976, u kërkonte studentëve t'u përgjigjeshin disa pyetjeve lidhur me një tekst që iu ishte dhënë për lexim. Bazuar në përgjigjet e studentëve, hulumtuesit nxorën përfundime mbi procesin e të mësuarit.

12. Ford, D.J. 2011. How the Brain Learns. <https://www.trainingindustry.com/content-development/articles/how-the-brain-learns.aspx>

13. Fullan, M., & Langworthy, M. 2013. Towards a new end: New pedagogies for deep learning.

14. Gagné, R, M. 1975. Essentials of learning for instruction, Principles of educational psychology series. University of Michigan: Dryden Press.

15. Ginsburg, H. P., & Opper, S. 1987. Piaget's theory of intellectual development (3rd ed). New York, NY: Pearson.

16. Giorgi, A. 1986. A phenomenological analysis of descriptions of concepts of learning from a phenomenological perspective. Publikationer fran institufionem for pedagogik, Goteborgs Universitet.

17. Houghton, W. 2004. Engineering Subject Centre Guide: learning and teaching theory for engineering academics. Loughborough: Higher Education Academy Engineering Subject Centre, Loughborough University.

18. Houghton, W. 2004. Engineering subject centre guide: Learning and teaching theory forengineering academics. Higher Education Academy Engineering.

19. Keller, J. M. 1983. Motivational Design of Instruction. In Reigeluth C. M. (edt.), Instructional Design Theories and Models: An Overview of Their Current Status. New York: Lawrence Erlbaum Associates Publishers, fq. 383-434.

20. Kimble, G, A. 1980. Principles of General Psychology, John Wiley & Sons Inc; 5th edition: Hardcover.

21. Koizumi, H. 2003. Science of Learning and Education: An Approach with Brain-function Imaging, NoTo Hattatsu, Vol. 35, No. 2, fq. 126-129.

22. Kress, G. 1999. Education of the 21st century. Inaugural Lecture. Institute of education. University of London.

23. Lubin, J. 2003. Deep, Surface, and Strategic Approaches to Learning. Online Document from UCD Dublin Centre For Teaching and Learning. http://www2.warwick.ac.uk/services/ldc/development/pga/introtandl/resources/2a_deep_surfacestrategic_approaches_to_learning.pdf,

24. Mandal, A. 2013. Human Brain Structure. <http://www.news-medical.net/health/Human-Brain-Structure.aspx>

25. Martinos Center for Biomedical Imaging. Department of Radiology. Massachusetts General Hospital & Harvard Medical School.

26. Marton,F., Dall’Alba, G. and Beaty, E. 1993. Conceptions of learning. International Journal of Educational Research, fq. 277-300.

27. McGraw, K.O. 1978. The Detrimental Effects of Reward on Performance: A Literature Review and a Medical Clinic. <http://shmtiep.wixsite.com/shmiep/single-post/2014/05/05/Truri-i-njeriut-dhe-pjeser-kryesore>

28. National Research Council. 2000. Inquiry and the National Science Education Standards (A Guide for Teaching and Learning). 2000.

29. Newell, A. & Simon, H. A. 1972. Human Problem Solving. Englewood Cliffs. NJ:Prentice-Hall.

30. Norman, D. A. 1980. Twelve issues for cognitive science. Cognitive Science, 4, 1-32.

31. OECD. 2007. Understanding the brain: The birth of a learning science. The impact of environment on the learning brain.

32. Prediction Model, in M.R. Lepper and D. Greene (eds.). The Hidden Costs of Reward: New Perspectives on the Psychology of Human Motivation. Lawrence Erlbaum. Hillsdale. NJ, fq. 33-60.

33. Prosser, M. & Miller, R. 1989. The ‘how’ and ‘what’ of learning physics, European Journal of Psychology of Education, 4(4), fq. 513-528.

34. Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE). 2013. MËSIMDHËNIA E TË MËSUARIT.

35. Ramsden, P. 1992. Learning to Teach in Higher Education. London: Routledge, fq. 263.

36. Saljö, R. 1979. Learning in the learner's experience. 1. Some common-sense conceptions. In Report No 76. Department of Education, University of Göteborg.

37. Scardamalia, M. & Bereiter, C. 1991. Higher levels of agency for children in knowledge-building: A challenge for the design of new knowledge media. Journal of the Learning Sciences, fq. 37-68.

38. Scardamalia, M. & Bereiter, C. 1991. Higher levels of agency for children in knowledge-building: A challenge for the design of new knowledge media. Journal of the Learning Sciences, fq. 37-68.

39. Trigwell, K. & Prosser, M. 1991. High Education, fq. 251.

40. University of California. Irvine's Center for the Neurobiology of Learning and Memory (CNLM).

41. Vye, N.J., Goldman, S.R., Voss, J.F., Hmelo, C., Williams, S. & Cognition and Technology Group at Vanderbilt. 1998a. Complex mathematical problem solving by individuals and dyads. Cognition and Instruction 15(4).

42. Δημητριάδης, Στ. 2000. Τεχνολογία των Πολυμέσων και η Εφαρμογή της στην Εκπαιδευτική Διαδικασία. Διδακτορική Διατριβή, ΑΠΘ, τμήμα Πληροφορικής.

43. Διαθεματικό Ενιαίο Πλαίσιο Προγραμμάτων Σπουδών (ΔΕΠΠΣ). 2003.

44. Τριλιανός, Θ. 2003. Μεθοδολογία της σύγχρονης διδασκαλίας Ι. Αθήνα: Περιβολάκι και Ατραπός.

45. Φλουρή, Γ. 2003. Σκέψεις για την αναζήτηση ενός πλαισίου επιμόρφωσης και δια βίου μάθησης των εκπαιδευτικών στην κοινωνία της γνώσης. Αθήνα: Περιβολάκι και Ατραπός.

DEEP LEARNING

THROUGH TRANSFORMATIVE PEDAGOGY

SUMMARY

Education as a universal value of human society has developed into a close liaison with the scientific developments of technological, economic, social, cultural and political life. For this reason, education systems are attempting to continuously update and improve knowledge in parallel with personal and professional skills of individuals. Through the content, purpose, and methodology of their organizational structure, these systems have sought to address the requirements of societies provide solutions.

Although different educational theories distinguish between them, yet no pedagogical method has been unable to encompass all dimensions of mental, emotional and psycho-physical construction. Although scientific findings in the process of teaching and learning and perspectives of cognitive sciences and Neuro-scientific perspectives have progressed, there is still much work to be done.

The learning process focuses on the evolution of learning and diverse forms of intelligence. Factors that contribute to this process are physiological development, learning environments, teaching, socio-cultural processes, etc.

Transformative Pedagogy as an effective and authentic learning strategy and through deep learning method promotes self-discovery, new ideas, encourage the world discovery, establish identity and helps students to become thinkers, creative, and effective communicators as at an individual and societal level.

Keywords: *Education, teaching strategies, deep learning, Transformative Pedagogy.*

VIZIONI TRAGJIKOMIK I FILIP ROTHIT NË “NJOLLA NJERËZORE”

MSc. Erion Shehu*

ABSTRAKT

Në këtë artikull autori synon të pasqyrojë vizionin tragjikomik që karakterizon njërën prej veprave më të famshme të shkrimtarit amerikan, Filip Roth. Në artikull do të trajtohet ndërthurja e elementëve të teatrit të absurditetit dhe të far-sës që karakterizojnë këtë roman paralelisht me elementët e tjerë socio-kulturorë. Ky roman, nga Rothi, i shkruar në vitet e fundit të mandatit të ish-presidentit Klinton, jep një pasqyrë të Amerikës së fund shekullit të XX dhe valës së korrektësisë politike (political correctness) që përfshiu vendin. Edhe pse kanë kaluar më shumë se 50 vjet që prej lëvizjes së të Drejtave Civile, në Amerikë ende vazhdojnë tensionet dhe përçarjet midis afro-amerikanëve, hebrenjve dhe shumicës së bardhë amerikane. Mes këtij tensioni qëndron tensioni midis Un-it të individit dhe presionit shtypës së shumicës, të Ne-ve, dëshirës për të qenë i pavarur larg çdo lloj identifikimi racor dhe shembjes së këtij vullneti prej konstrukteve paragjyquese që shoqëria ka ndërtuar.

Nga të gjithë shkrimtarët bashkëkohorë amerikanë, Filip Roth është padyshim shkrimtari më ambicioz dhe më i famshëm.

* Pedagog i Gjuhës Angleze, Kolegji Universitar “Logos”.

Ndryshe nga shkrimtarët e tjerë në moshë, krijimtaria e të cilëve bie me kalimin e kohës, Roth ka dëshmuar një talent unik jo vetëm në qëndrueshmërinë e prodhimit të tij artistik por edhe në tejkalimin e fokusit dhe talentit mbartës në veprat e tij të mëparshme. Synimi i këtij artikulli është të informojë lexuesit e interesuar në letërsinë bashkëkohore mbi këtë vepër të arrirë të Filip Roth-it, duke dhënë një pasqyrë të qartë të parametrave të letërsisë bashkëkohore.

Fjalët kyç: *purifikim, tragjedi, absurditet, farsë, njollë.*

Tashmë është një fakt i ditur që me publikimin e *Pastorales Amerikane* (1997), *Martesa me një Komunist* (1998), dhe *Njolla Njerëzore* (2000), tri vepra që së bashku njihen si “Trilogjia amerikane”, nisë një rigjallërim i karrierës së shkrimtarit amerikan Filip Roth, i cili hyn vonë në fazën më prodhimtare të krijimtarisë së tij artistike, një krijimtari që për nga prodhimtaria rivalizon një tjetër shkrimtar të madh amerikan të shek. XX, Henri Xhejms.

Për shumë kritikë, pozicionimi i tre personazheve të trilogjisë, në tri periudha të ndryshme të historisë amerikane, me Rothin që pyet dhe hedh dritë mbi forcat historike që çojnë në rënien e secilit personazh, është dëshmi e padiskutueshme e artit të Roth-it i cili tashmë renditet si shkrimtari më i njohur amerikan, ende në jetë, duke eksploruar “ironitë dhe tragjeditë e përvojës së shoqërisë amerikane”¹.

Vetë Rothi i ka quajtur tri novelat e mësipërme “trilogji tematike”. Ai sqaron se “tre ishin lëvizjet historike në jetën e Amerikës së pasluftës, që patën ndikim të lartë në brezin e tij”: a) periudha e McCarthy-it; b) lufta e Vietnamit; dhe c) më 1998, akuzat ndaj Bill Clinton². Ky polaritet thërret në mendje kritikën e hershme ndaj artit të Roth-it dhe të karrierës së tij në

1. Cryer, D. 1993. *Talking with Philip Roth: Author Meets the Critics*. Newsday: 28th March. Pg. 14.

2. McGrath, Ch. 2000. *Zuckerman's Alter Brain*. New York Times. Book Review: 7th May. Pg. 8.

përgjithësi, një art i përqendruar në rrëfimin autobiografik që anashkalon çështjet e botës së gjerë, për t'u përqendruar më shumë dhe pandërprerë në vetvete. Këto variacione të pafundme na tregojnë më shumë për vetë Filip Rothin sesa për çdo gjë tjetër.

Bazuar mbi këtë formulim, trilogjia përfaqëson një shkëputje të fokusit në vetvete dhe nxjerr në pah rrëfimin historiko-artistik, një lëvizje në artin e Rothit që pritej herët a vonë dhe nga vetë shkrimtarët në përgjithësi, pra, “të merren me kulturën rreth tyre”³.

Sfondi kulturor i romanit *Njolla Njerëzore* bazohet mbi skandalin e ish-presidentit amerikan Bill Clinton me Monika Levinski. Në fakt, romani nis me një panoramë të gjerë historike që vendos telashet e Clintonit në qendër të romanit. *Njolla Njerëzore*, siç çdo roman tjetër i trilogjisë, bën satirë, përqesh dhe njëkohësisht vajton tragjikisht një aspekt të skenës politike shoqërore pas luftës së Dytë Botërore (intolerancën e njerëzve të thjeshtë, jo-liberalizmin e liberalëve dhe fanatizmin e konservatorëve).

Larmishmëria e humorit në *Njollën Njerëzore* kalon nga toni i humorit të zi në farsë. Roth, njësoj si shkrimtarët e tjerë të humorit të zi, Heller, Vonnegut etj., shpesh “na ndërgjegjëson për faktin se jetojmë në një botë të humorit të zi”⁴. Për më tepër, duke kaluar në “kufijtë e komedisë”, *Njolla Njerëzore*, pasqyron dështimin e pajtimit racor që ka pllakosur Amerikën e shek. të XX. Ky roman është një kritikë e hollë ndaj Amerikës dhe imazhit dominues të saj si një shoqëri multi-kulturore, duke theksuar barrën që përmban kategorizimi i “Ne” ndaj “Unë».

Tragjedia dhe farsa

Njolla Njerëzore, siç çdo roman tjetër i trilogjisë, i bën satirë, vë në “lojë”, dhe vajton në mënyrë tragjike një aspekt politik të shoqërisë të pas luftës së Dytë Botërore. Romani ndërlidh sjelljet politikisht korrekte dhe paragjykimet e komunitetit akademik të kolegjit të Athinës me sjelljet e amerikanëve të thjeshtë të cilët ishin të zemëruar me skandalin Clinton-Levinski.

3. Gooblar, D. 2001. *The Major Phases of Philip Roth*. Bloomsbury Academic. 1st edition. 1st September. Pg. 131.

4. Halio, J. L. (Editor) & Siegel, E. (Editor). *Turning Up the Flame: Philip Roth's Later Novels*. Pg. 174.

Dëshira për hakmarrje dhe “çmenduria për spastrim” në kampusin e kolegjit të Athinës, krahasohet me një turmë që pret jashtë Shtëpisë së Bardhë për të varur presidentin e saj. *Njolla Njerëzore* kalon nga sfondi kombëtar, Klintoni në shtëpinë e Bardhë, tek një zonë provinciale, një kolegji i vogël në Anglinë e Re; nga publikimi i zjarrit të skandalit Klinton-Levinski, tek turpërimi i Kolman Silk, profesorit të Kolegjit të Athinës i cili shkarkohet nga detyra për një fjalë raciste ndaj një studenti.

Kritikja e *Nju York Times*, Michiko Kakutani, e lavdëron veprën për “përballje me tematikat e Rothit dhe ekspozim nën lupën e gjerë të shkrimtarit, të përçarjeve dhe tensioneve të jetës së shek. të XX”⁵. Ajo vijon duke u shprehur se z. Roth ka shkruar diçka plot nuancë, të shkëlqyeshme, që me raste shpreh komikë dhe trishtim në të njëjtën kohë”.

Kolegji i Athinës shndërrohet në një mikrokozmos i zellit për korrektësi politike dhe atë çfarë Rothi e quan “vala e çmendurisë”, e cila preku qytetet e mëdha dhe të vogla amerikane. Përmes fjalëve si, “marrëzia e fanatizmit” apo “çmenduria e puritanizmit”, rrëfimtari përshkruan plot satirë dhe humor, duke kritikuar përkuljen hipokrite të Kongresit dhe medias mbi sjelljen etike. Duke shtuar më tej hiperbolën, Zuckerman i krahason këto thirrje për dënim, të ngjashme me thirrjen për dënim me vdekje të Komeinit të Iranit ndaj shkrimtarit Salman Rushdie. Këto thirrje janë të ngjashme me atë çfarë Hothorni e quan “shpirt persekutues”⁶. Më shumë se çdo roman tjetër i Roth-it, *Njolla Njerëzore*, ekzaminon më intësisht psikikën e personazheve të saj.

Filip Roth satirizon kaosin që shkaktohet kur njerëzit, më kot përpiqen të lartësojnë idealet e tyre, në një kohë kur amerikanët me prejardhjen e tyre puritane, shokohen dhe shqetësohen me veprimet e presidentit të tyre. Mund të gjejmë paralele midis nxitimit të shfrenuar për të “pastruar” shtëpinë e Bardhë nga Klintoni dhe presioneve të forta për të detyruar Kolman Silk të jap dorëheqjen. Roth, gjithashtu, sugjeron krahasime midis etiketimit të Klintonit si misogjinist, për shkak të aferës së tij me Levinskin, e cila kishte gjysmën

5. Kakutani, M. 2000. *The Human Stain*. Review. New York Times. May.

6. Bloom, H. (Editor)&Welsch, G. (Editor). 2003. Philip Roth (Bloom’s Modern Critical Views). *Chelsea House Pub.* June. Pg. 240.

e moshës së tij, dhe ndaj 71 vjetarit Kolman Silk, duke përdorur të njëjtën akuzë për shkak të marrëdhënies së tij me 34 vjeçaren, Faunia Farley.

Larmishmëria e humorit në *Njollën Njerëzore* varion vazhdimisht nga tonet e zymta të humorit të zi në farsë. Roth na bën të ndërgjegjshëm që jetojmë në një botë të çuditshme dhe humoristike, ku ironia dhe tragjikja përzihen; në një botë në të cilën humori tragjik rishfaqet dhe “nuk dimë nëse duhet të qajmë apo të qeshim”⁷. Farsa e romanit përfaqësohet nga personazhet Lester dhe Delfin, të dy personifikime ironike të ngurtësisë dhe jo-fleksibilitetit njerëzor. Skenat më qesharake në roman përqendrohen rreth dy personazheve, Lester (ish-bashkëshorti i Faunia Farley) dhe Delfin Roux (profesoresha e frëngjishtes në Kolegjin e Athinës).

Lexuesit qeshin, madje me superioritet, ndaj botës qesharake, kur një veteran i Vietnamit shpall se aty ku ka “kinezë” ka dhe terror, veçanërisht në një restorant kinez. Lexuesit qeshin ndaj profesoreshës së frëngjishtes e cila rimishëron personin komik “që është e padukshme ndaj vetes, duke qëndruar e dukshme ndaj të tjerëve”⁸. Ajo ndjek përkrahimin bergsonian të progresit “nga një person i hutuar, tek një person me entuziazëm të egër e deri tek deformimet e karakterit dhe vullnetit, duke u shndërruar gjithmonë e më shumë komik për lexuesin. Ndaj, e keqja që buron nga këta dy personazhe, komikë dhe tragjikë, mund të tensionojë lexuesin përmes kalimeve nga tragjikja në farsë. Romani vazhdimisht zhvendoset në portretizimin e tij nga karikaturat e Lester dhe Delfin, tek personazhet e zhvilluara të Kolman Silk, Faunia Farley dhe Nathan Zuckerman. Zhvendosja e perspektivës dhe humorit të romanit, i çorienton lexuesit duke u sjellë ankth gjatë pritjes se çfarë do ndodhë më pas.

Në *Njollën Njerëzore*, teatri i paradoksit është qartas në mospërputhje midis ideale dhe reales, të shenjtës dhe profanes. Kjo mospërputhje, në themel, haset jo vetëm në humorin hebraiko-amerikan por edhe në atë çfarë Louis D. Rubin e quan “Shakaja e madhe amerikane”. Ai vë në dukje se “humori buron nga boshllëku midis ideale dhe faktive të jetës së

7. Safer, E. S. 2006. *Mocking the Age: The Later Novels of Philip Roth* (S U N Y Series in Modern Jewish Literature and Culture). State Univ of New York Pr, March 2. Pg. 118.

8. Safer, E. S. 2006. *Mocking the Age: The Later Novels of Philip Roth* (S U N Y Series in Modern Jewish Literature and Culture). State Univ of New York Pr, March 2. Pg. 119.

përditshme, ku idealja merr përmasa të cekëta dhe hipokrite, dhe faktiken e realitetit të hidhur”.

Roth e nis *Njollën Njerëzore* me një epigraf nga *Mbreti Edip* i Sofokliut. Në fillim të tragjedisë, Edipi pyet: “Cili është riti i pastrimit? Si mund të kryhet?” Kreoni i përgjigjet: - “Duke dëbuar personin ose duke purifikuar gjakun me gjak”.

Këto rreshta janë një referencë e përshtatshme e romanit për profesorin e letërsisë klasike, i cili për shkeljen e tij, pra, duke përdorur një fjalë raciste, detyrohet të largohet nga kolegji i Athinës. Rreshtat e mësipërm paraqesin dhe dualitetin kryesor të romanit: njolla njerëzore dhe dëshira idealiste e njerëzve për perfeksion; dhe krim dhe purifikim përmes spastrimit. Edipi përpiket të shmangë tragjedinë duke vrarë babain dhe duke u martuar me nënën e tij; pasi e kupton çfarë ka ndodhur, ai verbon veten dhe dëbohet nga Teba në mënyrë që qyteti të ketë *catharsis* (“pastrim/purifikim”).

Kolman e ndjen që ngjyra e lëkurës së tij e njollosë atë në një shoqëri ku të qenurit “tjetër”, afro-amerikan, e vendos atë në shënjestër të paragjytimeve. Dëshira e tij për purifikim, dhe si pasojë për liri, e bind atë të shtretit si i bardhë dhe të martohet me një femër të bardhë, duke shmangur në këtë mënyrë fatin e një afro-amerikani i cili duhet të vuajë sulmet e një shoqërie paragjyquese. Gjithsesi, Kolman-it i mungon statura e Edipit, romanit i mungon *katharsisi* që lind nga tragjedia. Në vend të saj, Rothi përdor humorin e absurditetit, me polet e saj ironike si një mënyrë për ta bërë dramatike tragjikomedinë e afro-amerikanit Kolman.

Roth përdor humorin e zi për të “vënë në lojë” dëshirat e shoqërisë për purifikim. Kalimet e tij çorientuese, në roman, nga humori tek drama, shkakton tek lexuesi një lloj pavetëmbrojtje dhe tërheqje në tragjikomedinë e *Njollës Njerëzore*. Dhimbja përplasit me humorin, ndërsa lexuesi e gjen veten në duart e një dirigjenti të madh si Filip Roth.

Leximi i racës dhe mëdyshjet e identitetit

Njolla Njerëzore ndërlihd ngushtë marrëdhënien midis gjinisë, racës dhe identitetit. Personazhi kryesor në *Njollën Njerëzore* të Rothit, Kolman Silk,

dekani afro-amerikan i kolegjit fiktiv të Athinës, ka rimodeluar veten si hebre në mënyrë që të përfitojë lirinë si “një nga pionierët më të mëdhenj të Un-it”. Duke ndryshuar identitetin e tij në një mister të palexueshëm nga të tjerët, Kolman bie pre e çorientimit që vjen nga identiteti i rremë që ai ka marrë. Ky çorientim dhe kjo humbje e identitetit real, ilustron më së miri politikat e identitetit që Roth ngre si pyetje në këtë vepër, pra, tjetërsimi i identitetit dhe pamundësia e anashkalimit të tij.

Në këtë rast, *Njolla Njerëzore* ofron një argument të fortë për një rikthim tek “Un-i” universal, të shkëputur nga politikat e identitetit. Vihet re që shumë prej personazheve të Roth-it bien pre, duke hedhur mënjanë “Un-in” dhe duke tjetërsuar “Ne-në” dhe gjuhën e quajtur “korrektësi politike”.

Prapë, edhe pse Kolman ka zgjedhur të identifikohet si hebre, ai nuk mund t’i shpëtojë “tiranisë” së kategorizimit. I etiketuar si afro-amerikan ose hebre, Kolman, vuan pasojat e racizmit dhe anti-semitizmit. Prandaj, *Njolla Njerëzore* argumenton kundër vetvetes: ndërkohë që lavdëron lirinë e “Un-it” nga skllavëria e kolektivizmit të “Ne-ve”, personazhet e tij vazhdimisht dëshmojnë se, sado të përpiqen, presioni kolektiv i “Ne-ve”, sidomos ai i bazuar mbi racën, do të jetë gjithmonë në gjendje të mposhtë vullnetin e lirë të “Un-it”⁹.

Roth argumenton se, e vetmja mënyrë për të shmangur tensionet racore është mënjanimi i konceptit të racës, se vet konceptit “racë”, si një term të shpikur nga njeriu. Gjithsesi, ky zhvillim duket i pamundur pasi shoqëria është akoma e fiksuar me kategorizimin e racës, një fiksion që e bën zhdukjen e racizmit dhe anti-semitizmin akoma më të vështirë. Madje, sipas logjikës së *Njollës Njerëzore*, paqja racore mund të ndodhë vetëm nëse anashkalohen politikat e identitetit.

Roth, vendos shumë prej personazheve të tij përballë një kritike të ashpër të korrektësisë politike (political correctness) ose i konsideron ata përfaqësues të hipokrizisë së saj, veçanërisht kur ndajnë fantazinë e shpërbërjes së kategorisë së racës në favor të një “Un-i”, jo të kompromentuar.

9. Halio, J. L. (Editor) & Siegel, B. (Editor). 2005. *Turning Up the Flame: Philip Roth's Later Novels*. University of Delaware Press, March 1. Pg. 172.

Roth nënkupton se paqja racore nuk mund të arrihet kurrë për sa kohë “autoritetet reaksionare të korrektësisë politike qëndrojnë të pakontrolluar”¹⁰. Shkurt, në pikëpamjen paradoksale neo-konservative të *Njollës Njerëzore*, korrektësia politike parandalon paqen racore.

Bazuar sa më lartë, mund të thuhet se Roth në veprën *Njolla Njerëzore*, parashtrojnë jo vetëm mundësinë e pajtimit racor, por edhe atë që Kafka e quan “pajtimit personal”. Kafka e përndjek Rothin dhe, ashtu siç Sanford Pinkser vë re: “Nëse do ketë ndonjëherë një shkrimtar që i përngjason më së miri Kafkës, ky do ishte Roth”. Ky version i pajtimit Roth-Kafka, një version më i pastër sesa ai i propozuar nga iniciativa e presidentit Klinton mbi racën, është në vetvete një mënyrë për të bërë paqe me defektet e vetvetes dhe jo për t’u përballur me ato. Duke modeluar veten e tij si Kafka dhe duke qenë doppelganger (pra, duke dashur të ndjekë me përpikëri çdo hap të tij, edhe pse kanë identitete të ndryshme), Roth ofron një art që pasqyron përlëshjet e pajtimit në nivel personal dhe social.

Për më tepër, ironia qendrore e romanit ushqehet nga falsifikimi i identitetit personal dhe racor. Telashet për Kolman nisin kur dy studentë e akuzojnë atë për një fjalë raciste që ai thotë në auditor. Ironia e romanit qëndron në faktin se Kolman është afro-amerikan, por jo qartë i dallueshëm nga lëkura (për këtë arsye ai shtiret si i bardhë). Pra, nëse Kolman do kishte pranuar që ishte afro-amerikan, akuzat e dy studentëve për racizëm ndaj tij do binin poshtë. Por, Kolman, bën gabimin fatal duke mohuar identitetin e tij afro-amerikan, çka sjellë mbi të peshën e akuzave për racizëm nga dy studentë afro-amerikan. Në vijim, turpërimi dhe dëbimi i tij nga kolegji i Athinës është i pashmangshëm.

Dëshira për falje rrezaton me strukturën e fshehtësisë që shënon vepra e fundit e Rothit. Në roman, të gjithë, përfshirë edhe presidentin Klinton, mbajnë sekrete me të cilat fshehin identitetin e tyre të vërtetë, dëshirat apo gjendjen psikologjike. Mashtrimi dhe hipokrizia vet-gënjeshtrore janë “njolla” të qarta të pesë personazheve kryesorë të romanit, madje dhe të personazheve Kolman e Faunia, për të cilët krijojmë simpati.

10. Halio, J. L. (Editor) & Siegel, B. (Editor). 2005. *Turning Up the Flame: Philip Roth's Later Novels*. University of Delaware Press, March 1. Pg. 173.

Faunia mendon se është më e sigurt nëse gënjen dhe shfaqet si e paarsimuar, ndërsa Kolman mendon se liria e tij vjen duke gënjyer dhe duke u shtirur si i bardhë. Kolman Silk nuk është fajtor për racizmin ose shfrytëzimin e femrave, por ai është fajtor për deformimin e së shkuarës së tij, duke e detyruar veten “të zhdukë çdo gjurmë të saj”¹¹.

Rrëfimtari i tregimit, Nathan Zuckerman, shprehet se “ai humbi veten nga njerëzit e tij” (144). Mund të argumentohet se në vend që t’i jepej liria të shprehej si individ, ai përfundon me humbjen e identitetit të Kolman Silk, nga shkëputja e të shkuarës së tij. Për më tepër, ne kuptojmë se zbulimi i identitetit të Kolman-it, do të përmbyste dëshirat sekrete të profesoreshës së frëngjishtes, Delifn, e cila ka një mëri personale ndaj tij; jo vetëm për fjalën e tij “raciste” por edhe për shkak të marrëdhënies së tij me femrën e bukur, Faunia Farley. Secili nga personazhet mban një sekret në vetvete, përshirë dhe Faunia për të cilën të gjithë mendojnë se është analfabete dhe vjen nga klasa punëtore, kur në fakt është goxha e arsimuar dhe vjen nga një familje e edukuar të Bostonit.

Ndaj, ndërkohë që romani hapet me zbulimin e skandalit të presidentit Klinton, dalja në pah e sekreteve të personazheve të tjerë mban gjallë eksplorimin e Rothit mbi temën e identitetit dhe “vet-ribërjes” së tij. Edhe titulli i romanit madje, *Njolla Njerëzore*, thekson shpresën e kotë të shpengohemi dhe ripajtimit, njëlloj kur vetë Faunia na e shpjegon me deklaratën e saj: “Njolla njerëzore... ne lëmë një njollë, një gjurmë, gjurmët tona”. Në këtë vegim të errët, Roth lë të nënkuptohet se të gjithë ne, jemi të përlyer me gjakun e së shkuarës sonë dhe palëvizshmërinë e asaj së shkuare. Pranimi dhe përqafimi i asaj së shkuare është hapi i parë drejt shpengimit.

Në *Njollën Njerëzore* duket qartë beteja midis vetvetes dhe konstrakteve socio-kulturore, si p.sh. kur vetë Nathan përshkruan justifikimin e Kolman-it lidhur me shndërrimin e tij nga afro-amerikan, në i bardhë duke u bazuar në termat klasike liberale mbi vlerat e lirisë dhe lëvizshmërisë sociale. “Gjithçka që ai ka dashur, që nga fëmijëria e deri vonë, ka qenë të jetë i lirë! Jo si zezak, madje as si i bardhë, por thjesht të jetë vetvetja dhe i lirë”. Gjithsesi, kjo

11. Halio, J. L. (Editor) & Siegel, B. (Editor). 2005. *Turning Up the Flame: Philip Roth's Later Novels*. University of Delaware Press, March 1. Pg. 174.

fantazi prej pionierit të “Un-it”, bie kur Kolman zbulon shpejt që nuk mund të jesh i lirë në një Amerikë të fiksuar me racën.

Mentaliteti i tij buron nga ideja se liria bazohet mbi kategorinë e racës. Koncepti i Rothit mbi aftësinë e “Un-it” për të krijuar dhe jetuar në konstruktet e veta, bie ndesh me “tiraninë e shumësit”. Kjo “tirani” që do të përpohet nga morali shtypës, gllabërues, historik dhe i pashmangshëm i shumësit të “Ne-ve”, me sloganin e tij të errët “*E pluribus unum*”¹².

Atë çfarë Rothi quan “tiraninë e shumësit”, mund të konsiderohet dhe si politikë e identitetit, si lirim i identitetit të shtypur prej kulturës konformiste të “Ne-ve”. Duke pretenduar që romani i Roth-it dënon “tiraninë” e shumësit dhe fjalimet e “Ne-ve”, të nxitura nga korrektësia politike, Ross Posnok, e lidh qartë këtë shumë të “Ne-ve” me korrektësinë politike¹³. Porë në këtë dritë, Rothi tregon absurditetin e politikave të identitetit dhe korrektësisë politike duke gjurmuar fatin e hidhur dhe ironik të Kolman-it pas rrënimit të tij. Dëshira e egër e njerëzve për hakmarrje sjell në mendje personazhin e Hothornit në “Damkën e Turpit”, Hester Prin, e cila nxirret nga burgu për të dalë para turmës me shkronjën e kuqe të “turpit”. Filip Roth, ashtu si dhe Hothorni, e drejton gishtin ndaj hipokrizisë dhe mërisë së këtyre njerëzve kaq të “panjollësor”.

Pra, mund të thuhet se Kolman Silk jeton në një shoqëri të përbërë nga njerëz të cekët, të cilët nga njëra anë paragjykojnë “tjetrin”, ndërsa nga ana tjetër mbështesin korrektësinë politike.

Shkrimtarja amerikane Toni Morrison e quan afro-amerikanin një “përzjerje e fabrikuar e errësirës, e tjetërsisë, e alarmit dhe dëshirës që është aspekt unik amerikan”¹⁴. Akademikët politikisht korrektë të kolegjit të Athinës, u bashkuan për ta quajtur Kolman Silk një racist, si mënyrë për të mbuluar paragjykimet e tyre të fshehura; tendenca e tyre për të parë njeriun afro-amerikan si një qenie “tjetër”; dhe dëshira e tyre për të parë njeriun hebre si “tjetër” etj.

12. Halio, J. L. (Editor) & Siegel, B. (Editor). 2005. *Turning Up the Flame: Philip Roth's Later Novels*. University of Delaware Press, March 1. Pg. 175.

13. Posnok, R. *Purity and Danger: On Philip Roth*. *Raritan Quarterly Review* 21. Pg. 97.

14. Morrison, T. 1998. *The New Yorker*. October 5. Pg. 32.

Rothi e strukturon *Njollën Njerëzore* duke i treguar lexuesit sekretin e Kolman-it shumë kohë para se rrëfimtari Zuckerman të zbulojë identitetin e këtij të fundit. Ndërkohë që lexuesi imagjinon se rrëfimi i romanit po ndodh nga rrëfimtari i gjithëdijshtëm, nga fundi i romanit zbulohet se rrëfimtari ka qenë Nathan, duke rrëfyer në vetën e tretë përgjatë gjithë tekstit.

Madje, Nathan Zuckerman simpatizon me Kolman-in i cili *gabimisht* merret si afro-amerikan, duke vuajtur njëkohësisht pasojat e racizmit dhe anti-semitizmit. Për këtë arsye, një nga mesazhet kryesore të këtij romani është keqinterpretimi dhe njohja e identitetit personal. Filip Roth argumenton se pajtimi racor mund të arrihet vetëm nëse politikat e identitetit të “Neve” zëvendësohen nga origjinaliteti i individit të vetformuar. Gjithsesi, vetë personazhet e romanit dëshmojnë se pajtimi racor dështon gjithmonë prej forcave të papajtueshme toksike të sekreteve personale.

REFERENCA

1. Bloom, H. & Welsch, G. 2003. **Philip Roth (Bloom's Modern Critical Views)**. Chelsea House Pub, June. Print.
2. Gooblar, D. 2011. **The Major Phases of Philip Roth**. Bloomsbury Academic; 1 edition, September 1. Print.
3. Halio, J. & Siegel, B. 2005. **Turning Up the Flame: Philip Roth's Later Novels**. University of Delaware Press, March 1. Print.
4. Parrish, T. 2007. **The Cambridge Companion to Philip Roth**. Cambridge University Press, January 22. Print.
5. Posnock, R. 2006. **Philip Roth's Rude Truth: The Art of Immaturity**. Princeton University Press; 1st Edition, September 13. Print.
6. Royal, D. P. 2005. **Philip Roth: New Perspectives on an American Author**. Praeger, April 30. Print.
7. Safer, E. 2006. **Mocking the Age: The Later Novels of Philip Roth (S U N Y Series in Modern Jewish Literature and Culture)**. State Univ of New York Pr, March 2. Print.

SUMMARY

The Human Stain, like other Roth novels such as *Sabbath Theater*, *I Married a Communist*, *American Pastoral*, satirizes, ridicules and tragically deplores an aspect of the political life in the society after WW2. The political correctness has permeated the ordinary life and the people in America are already shouting out loud for the impeachment of president Bill Clinton due to his affair with Monica Lewinsky. Although the novel starts with the frenzy against president Clinton, the real story concerns the downfall of Coleman Silk, the classic professor at the Athena College who is banned from the academic community for using a “racial slur” against two black students. Coleman Silk, whose real identity is African-American, in order to escape his racial confines, passes as Jew in order to escape as white and have better chances “out there.” Nonetheless, it is precisely his denial of his race, that dooms him and makes him fall out of grace.

The novel is permeated with black humor mingled with tragedy and farce which Roth uses effectively in laying bare the five characters of the novel. Coleman Silk, 70, after being banished, starts an affair with the beautiful but half his age, Faunia Farley. The community here condemns him for his “exploitation of women” and the shocking expression here of a lynch-mob mentality becomes a microcosm for the political correctness fever and what Roth terms “calculated frenzy” that seized the nation in 1998.

Roth starts the novel with an epigraph from Sophocles’ *Oedipus the King*. Oedipus asks: “What is the rite of purification? How shall it be done?” Creon replies: “By banishing a man, or expiation of blood by blood.” The transgression committed here by Coleman Silk, caused his virtual banishment from Athena College. Therefore, the above lines also help establish the novel’s major duality: the human stain and people’s idealistic desire for perfection; crime and purification by banishment.

Nonetheless, the novel lacks the stature of Oedipus and the catharsis that arises from tragedy. Instead, Roth uses the tragedy of the absurd with its amalgam of ironic twists in order to dramatize the ironic fate of African American Coleman. In the end, both Coleman and Faunia die of an accident but the novel doesn't convey the feeling of the catharsis as neither does the impeachment of president Bill Clinton who stands for the hidden lusts of the people who want to lynch him and "cleanse" the White House. The underlying message is that the concept of purification, the aim to rid people of human stain, of imperfection causes evil in a tragicomic sense. In a famous quote by Dr. House in the popular show "House M.D, "Everybody lies" - trying to purify people because of their imperfections causes pure sorrow, farce and it's not what makes us human.

APLIKIMI I RREGULAVE TË WESTGARD-IT NË LABORATORËT MJEKESORË

MSc. Ariol Rama^{1, 2}, Bruna Dungu¹

ABSTRAKT

Ky studim ka për qëllim të evidentojë rëndësinë dhe mënyrën e aplikimit të multi-rregullave të Westgard-it në laboratorët mjekësorë. Gjatë këtij studimi janë kryer 358 matje të dy niveleve të kontrollit të analitit të glukozës në ambientet laboratorike të SHLP LOGOS. Analiza statistikore u përpunua me anë të MedCalc Statistical Software version 13.3.3 (MedCalc Software, Ostend, Belgium; <http://www.medcalc.org>; 2014). Variablat kualitative janë shprehur në (%). Përpunimi i të dhënave gjatë aplikimit të multi-rregullave demonstroi që 18% e vlerave të QC-it të cilat kalojnë limitet e vendimmarrjes $\pm 2SD$, janë vlera të pranueshme që shoqërojnë një performancë të mirë analitike.

I. Hyrje

Laboratorët klinikë duhet t'iu përmbahen praktikave të mira laboratorike për të siguruar cilësinë, integritetin dhe besueshmërinë e rezultateve të pacientëve. Integriteti dhe besueshmëria përfshijnë organizim dhe program të sigurimit të cilësisë.

-
1. Kolegji Universitar "Logos", Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Departamenti "Teknikë e Lartë në Laboratorë mjekësorë", Tiranë.
 2. Laboratori Qendror Diagnostik, Spitali "Hygeia", Tiranë.

Programi i mirë i cilësisë në laborator, përfshin pajisjet, reagentët, materialet, procedurat standarde të operimit, raportimin e rezultateve dhe ruajtjen apo arkivimin e të dhënave laboratorike. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave, si tregues i cilësisë, ndihmon në përmirësimin apo në zhvillimin e performancës laboratorike. Kjo e fundit është një proces që përdor informacione nga burime të shumta për të rritur mundësinë e realizimit të rezultateve të sakta dhe për t'i shërbyer më mirë nevojave dhe kërkesave të pacientëve. Menaxhimi i cilësisë në laborator kalon në tri faza gjatë kryerjes së testeve analitike: në fazën para-analitike, në fazën analitike dhe në fazën post-analitike [8].

Kualiteti i kontrollit [QC] në laboratorin mjekësor është një proces analitik dhe statistikor. Në vijim, të dhënat e QC-it përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar procesin analitik që prodhon rezultate të analizave të pacientëve. QC-it ndahet në: kualitet kontrolli të **brendshëm**, ku përfshihen mostra me vlera të njohura të cilat analizohen dhe kualitet kontrolli të **jashtëm**, ku përfshihen mostra biologjike me vlera të panjohura që gjenerohen nga laboratorë të jashtëm ose nga një laborator referencë [2].

Një produkt i QC-it është një material i përbërë në mënyrë ideale nga serum njeriu, urinë apo fluid. Produkti i kontrollit mund të jetë likuid ose i liofilizuar (Lyophilized), material ky i përbërë nga një ose më shumë përqendrime të njohura të analizëve. Produktet e kontrollit duhet të testohen gjithmonë në të njëjtën mënyrë si mostra e pacientëve. Produktet e kualitetit të kontrollit mund të jenë të 3 niveleve të ndryshme: abnormale të larta (vlera të larta të analizit), normale (vlera normale të analizit), abnormale të ulura (vlera të ulura të analizit). Rregullat e testimit të QC-it në praktikën e përditshme laboratorike, bazohen në testimin e kontrollit normal dhe abnormal (jo normale) për çdo test të monitoruar gjatë procesit analitik. Frekuenca e testimit të kontrolleve është në varësi të stabilitetit të analizit dhe të procedurave të ndryshme që mund të ndikojnë në performancën analitike. Vlerat e plota të QC-it që janë gjeneruar gjatë procesit të testimit, përdoren për të ndërtuar një bazë të dhënash të cilat më tej përdoren për të vlerësuar performancën e laboratorit në aspektin analitik. Llogaritjet e rezultateve të analizave dhe përdorimi i të dhënave statistikore të QC-it kalon në disa hapa: a) Llogaritja e mesatares

aritmetike [X]; b) llogaritja e deviacionit të standardit [SD]; dhe c) llogaritja e koeficientit të variancës [CV] [11].

Multi-rregullat (Westgard multirules)

dhe roli i tyre në vlerësimin e kualitetit të kontrollit (QC-it)

Ideimi i multi-rregullave i Dr. James O. Westgard, mori nisëm nga procesi i kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, kur vlerat e deviacionit standard janë jashtë limiteve $\pm 2SD$ dhe nuk kalojnë limitet $\pm 3SD$. Si rrjedhojë, për këto vlera (5%) nuk është e nevojshme të kryhen përlllogaritje dhe kalibrime të aparaturave nga e para, e cila do të nënkuptonte humbje në kohë për kryerjen e procedurave dhe kosto të shtuar për laboratorin. Multi-rregullat përfshijnë një kombinim të kriterëve për të vendosur nëse sistemi analitik mund të përdoret për të matur mostrat biologjike të pacientëve.

Gjatë implementimit të rregullave të Westgard-it në validimin e vlerave të kontrolleve të cilat kufizohen nga intervali $\pm 2SD$ - $\pm 3SD$ zakonisht observohen të dhënat e mëposhtme:

- Për një nivel kontrolli rezultatet false arrijnë deri në 5%;
- Për dy nivele kontrolli rezultatet false arrijnë deri në 9%;
- Për tre nivele kontrolli rezultatet false arrijnë deri në 14%.

Për të zvogëluar pasaktësinë dhe impaktin e rezultateve false të kualitetit të kontrollit, Westgard aplikon multi-rregullat për të analizuar të dhënat e QC-it. Rregullat Westgard janë përdorur zakonisht për të analizuar të dhënat e grafikut Levey-Jennings dhe për të përcaktuar kufizime të veçanta të performancës analitike, nëse është brenda apo jashtë limiteve të vendim-marrjes. Sistemi i multi-rregullave mund të gjenerojë të dhëna në lidhje me natyrën e gabimeve që ndodhin në një proces analitik. Këto gabime klasifikohen në: sistematike (si rezultat i mesatares $\bar{x}$) dhe të rastësishme (si rezultat i standardit të deviacionit SD). Procedura me multi-rregullat e QC-it bazohet kryesisht në 4 kriterë specifikë, të cilat përdoren për të gjykuar provueshmërinë e QC-it të një analiti.

Gjatë implementimit të rregullave të Westgard-it duhet të përdoren të paktën **2 nivele** të kualitetit të kontrollit të cilat paraqiten me anë të grafikëve Levey-Jennings të kufizuar nga limitet e vendim-marrjes $\pm 2SD$ dhe $\pm 3SD$ [1].

II. Materialet dhe metoda

Për implementimin e multi-rregullave, gjatë këtij studimi, është përdorur testi i glukozës, i markës prodhuese AMS (Analyzer Medical System) me nr. LOT ACO19BF dhe dt. skadimi 10/07/2017.

Aplikimi i rregullave të Westgard-it u implementua, gjatë aplikimit të 2 niveleve të kontrollit për testin e glukozës. Materiali i përzgjedhur në zhvillimin e kualitetit të kontrollit ishte i markës BIO-RAD liquid assayed multiqual. Kontrolli i parë (CON_{1-Multiqual 1}) me nr. Lot 45731 dhe dt. skadimi 12/10/2018 dhe CON_{2-Multiqual 2} me nr. Lot 45683 dhe dt. skadimi 12/11/2018.

Metodika e përgatitjes dhe matjes së 2 niveleve të kontrolleve të brendshëm në laboratorë, u adaptua nga fleta shoqëruese e reagentit të glukozës së lartpërmendur.


Matjet e QC-it janë kryer gjatë një intervali kohor prej 40 ditësh, kohë gjatë se cilës janë gjeneruar 358 matje në total të dy kontrolleve. Frekuenca e matjeve është ruajtur uniformë duke ekzaminuar 9 matje në ditë. Të gjithë kampionët e kualitetit të brendshëm të kontrollit, janë ekzaminuar sipas rregullave dhe procedurave të rekomanduara duke ruajtur gjurmueshmërinë në çdo majte.

Manipulimi i reagentëve dhe kampionëve është ndërmarrë sipas kushteve të ruajtjes të rekomanduar në fletën shoqëruese të prodhuesit.


Matjet fotometrike u kryen me anë të Huma Lyzer Primus në gjatësinë e valës 505nm.

III. Rezultatet e punimit

Të dhënat e plota të matjeve iu nënshtruan procesit të shpërndarjes random për të stimuluar shpërndarjen karakteristike të 358 matjeve, të kontrollove me një frekuencë normale prej 9 matjeve në ditë, të çdo niveli kontrolli. Vlerat e gjeneruara gjatë matjeve të kualitetit të brendshëm të kontrollit në laborator, janë përpunuar statistikisht dhe janë paraqitur me anë të grafikut Nr. 3-1 dhe Nr. 3-2.



Grafiku 3.1. Kualiteti i kontrollit 1



Grafiku 3.2. Kualiteti i kontrollit 2

IV. Konkluzionet dhe rekomandime

Gjatë këtij studimi vërehet qartësisht rëndësia e aplikimit të multi-rregullave të Westgard-it në procesin e kualitetit të kontrollit të brendshëm në laboratorët mjekësorë. Gjithashtu, është evidente që aplikimi i multi-rregullave ka nevojë për personel më të kualifikuar dhe paraqet vështirësi gjatë implementimit si pasojë e metodave të komplikuara statistikore. Megjithatë, implementimi i këtij sistemi kontrolli bën të mundur vlerësimin e hollësishëm të vlerave të QC-it, të cilat kalojnë limitet e vendimmarrjes $\pm 2SD$ por që shoqërohen me performancë analitike të pranueshme. Në kontrast, mos implementimi i multi-rregullave do të pasohej me rritje në përqindje të rezultateve false të papranueshme të vlerave të QC-it në laborator - rritje e cila do të shoqërohej me alterime në kosto dhe me zgjatje të kohës për raportimin e rezultateve të pacientëve.

Analizimi i vlerave të QC-it në nivelin Multiqua 1 evidenton 8.5% të rezultateve, të cilat kalojnë limitet e vendimmarrjes $\pm 2SD$, si të pranueshme dhe indikatorë të rëndësishëm të performancës së mirë analitike në laborator. Gjithashtu, gjatë analizimit të vlerave të QC-it të Multiqua 2, evidentohen 9.5% e matjeve, të cilat janë indikatorë të performancës së pranueshme analitike. Statistikat e lartpërmendura janë më të larta se vlerat e publikuara nga literaturat e konsultuara. Analizimi i dy niveleve të kontrollit (multiqua 1 dhe multiqua 2) me anë të multi-rregullave “lejon” 18% të matjeve.

Nga totali i 358 matjeve të QC-it, 64 prej tyre konsiderohen si kontrolle të cilat përputhen me performancën e duhur analitike të glukozës. Mos aplikimi i multi-rregullave do të shoqërohej më implementimin e masave korrigjuese në rastin e 64 (18%) të matjeve individuale të QC-it.

Aplikimi i multi-rregullave të Westgard-it është një sipërmarrje e rëndësishme në të gjithë laboratorët mjekësorë dhe sidomos në realitetin shqiptar të diagnostikës laboratorike. Implementimi i procedurave të standardizuara të kualitetit të kontrollit është një ndër elementët më të rëndësishëm që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me saktësinë dhe besueshmërinë e vlerave të analizave të pacientëve.

BIBLIOGRAFIA

1. BioRad. 1990. *Basic & Intermediate Systems of Quality Control for the Clinical Laboratory*. BioRad Laboratories, Lit. No. Q-1102 4/05.
2. Cembrowski, G. S. & Carey R. N. 1989. *Quality Control Procedures*. Chapter 4 in *Laboratory Quality Management*. ASCP Press, Chicago, pp.59-79.
3. Cembrowski, G. S. & Sullivan, A. M. 1996. *Quality Control and Statistics*. Chapter 4 in *Clinical Chemistry: Principles, Procedures, Correlations*, 3rd edition. Bishop ML, ed., Lippincott, Philadelphia, pp.61-96.
4. Elmasri, R. a. N., S. B. 2003. *Fundamentals of database systems*. Addison Wesley, USA, Lumsden, J. H. (2000). *Laboratory test method validation*. *Revue Med. Vet.* 151, (623-630), Plebani, M. (2006). <http://www.citationmachine.net/apa/cite-a-book/manual>
5. Lee, G. R., Fitzgibbon, M. C., & Oshea, P. 2012. *In control IQC consensus and statutory regulation*.
6. Souan, L. & Sughayre, M. A. 2011. *Innovative Approaches in Quality Management in Clinical Laboratories*.
7. Vaxler, A., Ruopp, M. D., & Schisterman, E. F. 2001. *Monitoring Quality Control*. <http://www.citationmachine.net/apa/cite-a-book/manual>
8. Westgard, J. & Klee, G. 1994. *Quality Management*. Chapter 17 in *Textbook of Clinical Chemistry*, 2nd edition. Burtis C, ed., WB Saunders Company, Philadelphia, pp. 548-592.
9. Westgard, J. & Klee, G. 1999. *Quality Management*. Chapter 16 in *Fundamentals of Clinical Chemistry*, 4th edition. Burtis C, ed., WB Saunders Company, Philadelphia, pp.211-223.
10. Westgard, J. 2009. *Westgard Rules and Multirules*. Retrieved July 12, 2016, from <https://www.westgard.com/mltirule.htm>.
11. Westgard, J., Barry, P., Hunt, M. & Groth, T. 1981. *A multi-rule Shewhart chart for quality control in clinical chemistry*. *Clin Chem*.

SUMMARY

This study aims to highlight the importance and the way how the Multi Rules of Westgard's are applied in the medical laboratories. During this study we have made 358 measurements of two levels of glucose analytic controls in laboratory environments of LOGOS SHLP. Statistical analysis was processed by MedCalc Statistical Software version 13.3.3 (MedCalc Software, Ostend, Belgium; <http://www.medcalc.org>; 2014). Qualitative variables are expressed as (%). Data Processing during the appliance of the multi rules demonstrates that 18% of the value of QC which exceeds the limits of $\pm 2SD$ decision are acceptable values that associate a good analytical performance.

PËRCAKTIMI I ANTIGJENIT SPECIFIK TE PROSTATES (TPSA) NË SERUM ME METODËN E IMUNOFLUORESHENCËS NË MATRIKS NITROCELULOZE

Dr. Stilian Buzo*

I. Hyrje

Një ndër patologjitë më të shpeshta te meshkujt mbi moshën 50 vjeç është hipertrofia beninje e prostatës si dhe kanceri i prostatës. Diagnostikimi i hershëm i kësaj patologjie ndikon shumë në mënyrën e trajtimit dhe suksesin e mjekimit. Krahas ekzaminimeve klinike dhe imazherike një rol të rëndësishëm zë dhe përcaktimi i Antigenit Specifik të Prostatës (TPSA). Ky markues tumoral i vjen në ndihmë mjekut për të diferencuar hipertrofinë beninje të prostatës nga proçesi malinj.

II. Qëllimi i studimit

Matja e TPSA në serum mund të realizohet përmes disa metodave analitike, ndër të cilat më të spikatura janë: metoda imunoenzimatiske ELISA, metoda e imunofluoreshencës së polarizuar, metoda e kemiluminishencës. Këto metoda kanë specifikitet të lartë, por janë të kushtueshme, kërkojnë teknologji të përparuar dhe personel të kualifikuar për realizimin e tyre. Për këtë arsye ne studiuam përcaktimin e TPSA në serum me metodën e imunofluoreshencës në pllakë nitroceluloze. Përparësia e kësaj metode

* Kolegji Universitar "Logos".

qëndron në faktin se ajo është e shpejtë, ekonomike, ka saktësi të lartë dhe mund të përdoret me shumë lehtësi. Kjo metodë përdor teknologjinë e mikroçipeve parametrikë. Në mikroçipin parametrik i cili shoqëron kitin analitik, ndodhen të gjithë parametrat analitikë të metodës duke përfshirë edhe lakoren (kurbën) e kalibrimit të analizës që përcaktohet. Ky çip parametrik, instalohet në mikrofluorometrin që bën matjen e fluoreshencës analitike, duke siguruar në këtë mënyrë matje të shpetjshme dhe të besueshme.

III. Parimi i metodës

Në këtë teknologji përdoret një metodë imunodeteksi e tipit sandwich. Antikorpi analitik që ndodhet në buffer lidhet me antigenin që do të analizohet, i cili është i pranishëm në serum. Në këtë mënyrë formohen komplekset antikorp-antigen. Kjo përzierje analitike kalohet në pllakën kromatografike të nitrocelulozes, ku i nënshtrohet dukurisë së migrimit. Gjatë migrimit, komplekset antikorp-antigen kapen nga antikorpe të tjerë të imobilizuar në mjedisin e migrimit dhe të markuar me molekula fluoreshente. Intensiteti i fluoreshencës është në përpjestim të drejtë me përqëndrimin e substancës që analizohet. Rezultati analitik jepet në ekranin e mikrofluorometrit në trajtë shifrore.

IV. Materiale dhe metoda

Në studimin e kësaj teknologjie u bë matja e TPSA në 35 pacientë të diagnostikuar për hipertrofi beninje të prostatës. Mosha e këtyre pacientëve varionte nga 50 në 70 vjeç. Gjithashtu u bë matja e TPSA në 20 pacientë të tjerë me kancer të prostatës, mosha e të cilëve ndodhej në intervalin 60 deri 80 vjeç. Përcaktimi i TPSA u bë në serum. Matjet u bënë me kitin analitik ichroma, në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë: kyretat me buffer dedektimi, pllakat e nitrocelulozës, mikroçipi analitik parametrik, serum i kontrollit me vlerë të njohur të TPSA.

Leximi i pllakave të nitrocelulozës pas procedurës analitike, u bë në mikrofluorometër me reflektim.

V. Analiza e rezultateve të fituara

Rezultatet analitike të fituara gjatë matjes u përpunuan nga këndvështrimi matematiko-statistikor. U llogarit vlera mesatare $\bar{x}$, deviacioni standart D.S (σ) dhe T- Testi (Testi Student).

Të dhënat e fituara paraqiten në tabelën Nr 1 dhe tabelën Nr 2.

Emërtimi	Numri i pacientëve	Mesatarja aritmetike	Shmangia standarte	Intervali $\bar{x} \pm 2 \text{ S.D}$	T – Testi
Pacientë me hipertrofi beninje	35	9.0 ng/ml	2.5 ng/ml	4 - 14 ng/ml	P < 0.05
Vlerat normale të TPSA	/	2 ng/ml	1 ng/ml	0 - 4 ng/ml	

Tabela Nr 1. Vlerat e TPSA në 35 pacientë me hipertrofi beninje të prostatës matur me metodën e imunofluoreshencës në matriks nitrocelulozë.

Të dhënat e tabelës Nr 1 vënë në dukje, që në hipertrofinë beninje të prostatës, përqëndrimi i TPSA është i lartë, me një vlerë mesatare $\bar{x} = 9 \text{ ng/ml}$. Krahasuar me intervalin e vlerave normale, kjo rritje është statistikisht e besueshme (P < 0.05). Megjithatë kjo rritje në grupin e studiuar nuk e kalon përqëndrimin 14 ng/ml.

Emërtimi	Numri i pacientëve	Mesatarja aritmetike	Shmangia standarte	Intervali $\bar{x} \pm 2 \text{ S.D}$	T - Testi
Pacientë me kancer të prostatës	20	60 ng/ml	18 ng/ml	24 - 96 ng/ml	P < 0.01
Pacientë me hipertrofi beninje	35	9 ng/ml	2.5 ng/ml	4 - 14 ng/ml	P < 0.01
Vlerat normale të TPSA	/	2 ng/ml	1 ng/ml	0 - 4 ng/ml	P < 0.05

Tabela Nr 2. Vlerat e TPSA në 20 pacientë me hipertrofi të prostatës matur me metodën e imunofluoreshencës në matriks nitrocelulozë dhe krahasimi i tyre me përqëndrimet e TPSA në hipertrofinë beninje të prostatës dhe subjektet e shëndoshë.

Analiza e të dhënave të fituara tregon që rritja e përqëndrimit të TPSA në pacientët me kancer të prostatës është e lartë dhe kalon përqëndrimin 24ng/ml. Nga ana tjetër të dhënat e fituara vënë në dukje që metoda e imunofluoreshencës në matriks nitrocelulozë është në gjendje të dedektojë vlerat e larta të TPSA, të cilat shoqërojnë gjithmonë kancerin e prostatës. Metoda e përdorur paraqet sinjifikancë të lartë kur vlerat e TPSA të matura në pacientët me kancer të prostatës, krahasohen me vlerat e TPSA në hipertrofinë beninje të prostatës dhe intervalin e vlerave normale.

VI. Saktësia (preçizioni) i metodës

Për të gjykuar mbi preçizionin e kësaj metode analitike, u vlerësua duke marrë në konsideratë matjet paralele brenda serisë dhe jashtë serisë. U përzgjedhën 3 serume kontrolli me vlera të lejuara. Vlerat e serumeve të kontrollit ndodheshin në intervalin normal 0-4 ng/ml, në intervalin 0-15 ng/ml dhe në intervalin e vlerave të larta 25-50 ng/ml. Secili nga serumet e kontrollit u punua me nga 5 matje paralele. Të dhënat e fituara u përpunuan matematikisht duke llogaritur koeficientin e variacionit C.V %. Për të tre serumet e kontrollit, koeficienti i variacionit C.V është më i vogël se 10%, gjë që dëshmon për një saktësi të mirë të metodës së imunofluoreshencës në pllakë (matriks) nitrocelulozë. Për këtë arsye, përdorimi i kësaj metode për matjen e TPSA sidomos për qëllime depistuese, është i besueshëm.

VII. Ndjeshmëria (sensitiviteti) e metodës së imunofluoreshencës në pllakë nitroceluloze

Ndjeshmëria e metodës analitike ka të bëjë me përqëndrimin minimal të TPSA i cili mund të matet me anë të kësaj metode. Për të gjykuar mbi saktësinë e përcaktimit të TPSA me imunofluoreshencë të polarizuar në pllakë nitrocelulozë, u përzgjedh një seri tretësirash standarde me përqëndrime që variojnë nga 0 ng/ml deri në 100 ng/ml. Kjo seri tretësirash standarde u mat me anë të metodës të zgjedhur sikur të ishte seri analizash. Përpunimi i të dhënave të fituara tregoi se metoda e imunofluoreshencës në pllakë nitrocelulozë ka një saktësi në matjen e TPSA në serum ± 0.4 ng/ml.

VIII. Përfundime

1. Antigeni Specifik i Prostatës TPSA është një markues tumoral specifik për patologjitë malinje të prostatës, pasi përqëndrimi i tij në serum rritet në mënyrë sinjifikative.
2. Metoda e imunofluoreshencës në pllakë nitroceluloze mat saktë përqëndrimet normale të TPSA që i takojnë hipertrofisë beninje dhe përqëndrimet e larta të TPSA të cilat dëshmojnë për praninë e kancerit të prostatës .
3. Metoda është e thjeshtë, e shpejtë, ekonomike pasi bazohet në teknologjinë e kiteve analitike. Përdorimi i çipit parametrik shmang ndërtimin e vazhdueshëm të lakores (kurbës) së kalibrimit.
4. Metoda e imunofluoreshencës në pllakë nitroceluloze mund të përdoret me efikasitet për depistime dhe monitorim të terapisë të patologjive të prostatës.
5. Metoda zotëron siguri dhe saktësi të mirë analitike. Kjo metodë mund të përdoret lehtësisht nga çdo njësi mjekësore që merret me patologjitë e prostatës, pasi jep një orientim të saktë për strategjinë e mëtejshme të mjekimit.

LITERATURA

1. Stamey TA and col: Prostate specific antigen as a serum marker for adenocarcinoma of prostate. New Eng J. Med; 317, 909 - 16. 2000
2. Elefibrios P. Diamandis: Prostate - Specific Antigen a Cancer fighter and a valuable messenger. Clinical Chemistry 46; 7, 896 - 900. 2000
3. Goxharaj Altin; Buzo Stelijan and col: Praktikum i biokimisë, hematologjisë dhe mikrobiologjisë mjekësore. Tiranë 2012. 19-23

SUMMARY

TPSA is the tumoral marker the most important in clinical chemistry. This tumoral marker is used in diagnostics and monitoring of the prostatic carcinoma. TPSA is a glycoprotein chain that contains 7% carbohydrates. TPSA appears in serum, in different molecular forms.

The samples of 35 patients with HBP and 20 patients with prostatic carcinoma were analyzed with immunofluorescence method in nitrocellulose matrix. The measures were made with mikrofluorometer used parametric microchip.

In conclusion:

1. This method is totally equivalent with other method.
2. The method is exact, easy and economic.
3. TPSA is a tumor marker with high sensibility and high diagnostic efficacy.

Key words: *Tumor marker, TPSA, prostate carcinoma, immunofluorescence method, nitrocellulose matrix.*

NOCIONI I LIRISË TE MILLI DHE TE KROÇE

MSc. Dorian Sevo

ABSTRAKT

Idea kryesore e trajtesës është për të evidentuar, pra, për të nxjerrë në pah rëndësinë ekzistenciale të lirisë, rëndësinë rrënjësore të ekzaltimit të shpirtit njerëzor, utilitetin e saj jetësor.

Liria shihet si thelbi i njeriut, si vetë njeriu, si e ardhmja e vetë ekzistencës, si projekti i vetvetes përmes vetes, si plani i vazhdimit të ekzistencës dhe si forma e kapërcimit të pengesës ekzistenciale.

Në trajtesë kemi folur për dy autorë filozofë mjaftë në zë, Xhon Stjuart Mill dhe Benedeto Kroçe. Do të shohim, sipas këndvështrimeve të tyre, se si liria konsiderohet mënyrë ekskluzive e njeriut, si pjesë e pandashme e tij.

Mili e pa lirinë si “diçka”, si një pjesë përbërëse që karakterizon njeriun në fushën politike, qeverisëse dhe shoqërore. Si një filozof i lirisë, ai e lidhte lirinë me demokracinë, por edhe demokracia, sipas tij, kishte problemet e saj për sa i përket çështjes së lirisë. Pavarësisht se ai i kushtonte më shumë rëndësi lirisë së individit, pra, hapësirës së tij personale duke i kufizuar të drejtat e shtetit, ai mendonte se gjithsesi ka raste kur shteti ka të drejtë të ndërhyjë në jetën e gjithsecilit prej nesh kur bëhet fjalë për të mirën tonë, duke pasur parasysh këtu arsimimin e detyruar.

Në dallim me Millin, Kroçe paraqet një këndvështrim më intrisek dhe fenomenologjik për sa i përket problemit të lirisë.

“Liria është thelbi i njeriut dhe ai e zotëron atë në vetë qenien e tij si njeri”. Pra, do të shohim se në këndvështrimin e Kroçes liria është diçka interiore, e brendshme, dhe se si falë saj ne arrijmë të krijojmë, vetë ajo i jep shpirtit lirshmërinë e saj absolute dhe e bën atë të jetë një shpirt krijues.

Fjalët kyçe: *Liri, esencë, ekzistencë, interiore, realizim, vetë aktualizim, shpirt.*

Liria është një ndër temat më të debatuar dhe më të veçanta për sa i përket spektrit filozofik. Kjo për vetë faktin se është liria ajo për të cilën njerëzit kanë nevojë më së tepërmi. Akoma dhe luftërat më të mëdha janë bërë për liri, pasi privimi i saj e shndërron njeriun në një skllav, në një rob i cili pa të nuk mundet të jetojë.

Tek po shkruaj këto rreshta më kujtohet edhe një pasazh i Sartrit kur thotë se “nuk kemi qenë kurrë më të lirë se sa në periudhat e okupacionit, pasi vetëm atëherë e kemi ndjerë më së shumti nevojën për liri”¹.

Por, ne do të ndalemi tek dy autorë të tjerë me mjaft ndikim për sa i përket problemeve të lirisë. I pari është Xhon Stjuart Mill, ndërsa tjetri është filozofi i madh italian Benedeto Kroçe.

Le të ndalemi fillimisht tek Milli për të konkretizuar idenë e tij mbi lirinë.

Në kohën në të cilën jetoi Milli, ai ra dakord se demokracia ishte forma më e mirë e qeverisjes. Por, pavarësisht kësaj, në esenë e tij “*Për Lirinë*”, ai shkroi për disa rreziqe të trashëguara nga forma demokratike e qeverisë. Kryesisht, ai paralajmëronte se vullneti i popullit është shpesh vullneti i shumicës dhe kjo e bën plotësisht të mundur që shumica të shtypë pakicën.

Përveç kësaj, në demokraci ekziston tirania e opinioneve, një rrezik po aq i madh sa edhe vetë shtypja. Madje edhe në demokraci, është e nevojshme të vendosen roje kundra forcave që duan t’iu mohojnë njerëzve lirinë dhe

1. Sinani, Gj. *Leksionet e hyrjes në filozofi*.

vetëzhvillimin e plotë. Sipas kësaj ideje, me qëllim kryesor për të eliminuar të këqijat e dukshme shoqërore, Milli pasqyronte dëshirën e Bentamit për reformën. Ai ishte veçanërisht i interesuar që ta ruante lirinë, duke vendosur kufizime në veprimet e qeverisë dhe paralelisht këmbëngulte se i vetmi qëllim për të cilin njeriu është i justifikuar, individualisht apo kolektivisht, që të ndërhyjë në lirinë e veprimit të kujtdo tjetër, është vetëmbrojtja.

Më tej, ai vazhdonte se vetmi qëllim, për të cilin fuqia mund të ushtrohet në mënyrë të drejtë mbi çdo shtetas të një komuniteti të qytetëruar, kundër dëshirës së tij, është të parandalojë dëmin që ai mund t'iu sjellë të tjerëve. Sigurisht, shprehej ai, ka dhe një rol ligjor të qeverisë, por asnjë qeveri nuk mund të ndërhyjë mbi subjektet e veta në rastet kur: a) veprimet mund të kryhen më mirë nga persona privatë; b) edhe pse qeveria mund t'i kryejë veprimet më mirë se sa individët privatë, ata dëshirojnë t'i realizojnë vetë për zhvillimin apo arsimimin e tyre; dhe c) ka rrezik të ushtrohet fuqi e tepërt apo e panevojshme nga qeveria.

Milli vazhdonte me një tjetër argument rreth lirisë, një argument për individualizmin.

Por si duhej kuptuar kjo? Atëherë, përgjigjja na vjen me anë të thënies: “Lejoje çdo individ të ndjekë lumturinë e tij, në mënyrën e tij”! Individu është i pavarur në veten, në mendjen dhe trupin e tij. Madje edhe në fushën e ideve, po sipas tij, njerëzit mund të jenë të lirë të shprehin mendimet dhe besimet e tyre, sepse e vërteta zbulohet më shpejt, kur jepen mundësi për të refuzuar falsitetin. Më tej, vijon ai, një shoqëri e cila nuk pranon mendimin dhe debatin e lirë, shndërrohet në një shoqëri të dobët dhe të atrofizuar. Pra, njerëzit, në përgjithësi, duhet të jenë të lirë të mendojnë, të reflektojnë dhe të shprehin, sepse vetëm duke u lejuar atyre që të jenë të plotë, mund të krijohet një shoqëri që ka në themelet e saj njerëz të aftë.

Milli qëndroi në pozicionin se “ka një dallim të madh ndërmjet supozimit që një opinion është i vërtetë (sepse pavarësisht ç’do mundësie për ta kundërshtuar atë, nuk e hedh dot poshtë) dhe supozimit se është i vërtetë pikërisht nga qëllimi që të mos lejojmë refuzimin e tij”. Por, Milli pyeste veten: “Çfarë mund të thuhet më shumë apo më mirë për një kusht të problemeve njerëzore, se sa ajo që i sjell qeniet njerëzore më afër më të mirës së mundshme?”

“Pra, a mund të themi ne se është funksion apo detyrë e qeverisë që të afrojë qenien njerëzore sa më afër me më të mirën e asaj që mund të arrijë?”

Vetë Milli kishte një pakënaqësi të thellë për shtetin totalitarist, megjithëse ai jetoi shumë herët për të parë shfaqjet e tij të pështira, atëherë kur vendosi kufizimet prej të cilave qeveria nuk duhej të kalonte. Ai këmbënguli me forcë se njeriu, përveç se në rastin e parandalimit të dëmeve, nuk duhet të jetë subjekt i fuqisë së qeverisë dhe në mënyrë të veçantë “e mira e tij personale, qoftë fizike apo morale, nuk është garanci e mjaftueshme”.

Milli, i cili tashmë qe ndarë në mënyrë të dukshme nga versioni i utilitarizmit të Bentamit, vuri në lëvizje forcat e lehta, të cilat e drejtuan atë nga individualizmi i tij i qartë, tek format e vakëta të kolektivizmit.

Në qoftë se ai ishte i interesuar për cilësitë e kënaqësive, në vend të sasive të tyre dhe në qoftë se këto cilësi ishin mbështetur mbi të ekzistencën e qenieve njerëzore, “si më të mirat që ato mund të jenë”, atëherë, përfundimisht, vetëm ata individë të cilët kanë fituar kënaqësitë më të mëdha mund t’i njohin ato. Ekziston një nxitje natyrore, për ata që njohin këto kënaqësi, të kërkojnë që edhe të tjerët t’i kenë ato.

Por lind pyetja: Çfarë mund të ndodhë në qoftë se ata që nuk i njohin dhe nuk i vlerësojnë vlerat më të larta, nuk i duan ato? Nuk është çudi që Milli, në këtë rast, përkrah p.sh. arsimin e detyruar, duke u kthyer në idenë e tij të mëparshme që njeriu, nuk duhet të ndërhyjë asnjëherë në lirinë e anëtarëve të tjerë të njerëzimit, veçse në rastet kur bëhet fjalë “për të mirën e tyre”.

Ndodh shpesh që në emër të së mirës së përbashkët shteti lëviz në zonat e lirisë së njeriut. Ajo që Milli tha për lirinë, pati një shprehje të veçantë në shek. XX, dhe ka si dëshmi shkeljen që qeveria bëri mbi veprimet dhe mendimet e njerëzve kudo në botë.

Përse mbrojtja e lirisë individuale ishte kaq e shenjtë për Millin do të pyesnim?

Në qoftë se njerëzit nuk janë të lirë të jetojnë sipas dëshirës së tyre, pra, “sipas mënyrës që u takon ta caktojnë vetë”, thekson ai në esenë e tij të famshme, atëherë qytetërimi nuk do të përparonte, e vërteta nuk do të mundte të dilte në dritë. Kjo për faktin se do të mungonte tregu i këmbimit të lirë të ideve, ndërsa spontaniteti, origjinaliteti, gjenialiteti, energjia intelektuale dhe guximi moral nuk do të mund të shpaloseshin. Shoqëria do të

shtypej nën peshën e “mediokritetit kolektiv”, ndërsa larmia dhe pasuria e përvojave njerëzore do të asfiksoheshin nga konvencioni dhe nga prirja e përhershme konformiste e njerëzisë, e cila është prodhon vetëm “aftësi të atrofizuara” dhe njerëz “hipokritë e të ngurtë”.

Kroçe e shihte lirinë nga një spektër tjetër. Ai shprehej se “Brendia mendore e fjalës liri është vetë shpirti i njeriut”². Me anë të përgjigjes së tij, ai na tregon se liria përbën vetë thelbin e shpirtit tonë. Ajo, bëhet potenciali dhe materiali që vë në lëvizje, që formon dhe që krijon. Me pak fjalë, thelbi i shpirtit është liria!

Kjo tezë të sjell ndërmend pasazhin e Sartrit kur thotë: “Thelbi i shpirtit është liria dhe njeriu është i dënuar që të jetë i lirë”. Analiza e tij vazhdon me idenë që të gjithë njerëzit janë të lirë, sepse kush ka shpirt dhe prodhon përmes tij, tregon se e gjithë kjo buron nga thelbi i vet, pra, nga liria. Nuk mundet, njeriu të konceptohet pa qenë i lirë në thellësinë e tij, në thelbin dhe në esencën e tij.

Të thuash se liria është thelbi i shpirtit dhe më andej se ajo është thelbi i njeriut, nuk ke dhënë asnjë kuptim pa iu përgjigjur pyetjes: Po thelbi i lirisë, kush është? Të përcaktojmë thelbin e lirisë, duhet të themi diçka më të madhe, më kuptimplotë se vetë koncepti i saj. Liria thjesht është tek ne, ajo nuk përcaktohet dhe nuk ka thelb të vetin, pasi ajo është absolutja në qenien e njeriut. Pra, e thënë thjesht, është thelbi i vetvetes.

Vetë Kroçe do shprehej se: “Liria, është thelbi i njeriut dhe ai e zotëron në vetë qenien e tij si njeri”³. Pra, ajo as nuk na vjen, as e fitojmë as na e marrin, dhe as nuk na e dhurojnë. Liria thjesht është thelbi i saj, është si të themi burim i vetvetes. Ne lindim me të, si të thuash, natyra njerëzore e përmban atë si thelb të vetin. Ajo bëhet cilësia themelore e njeriut.

Kështu mund të themi se Liria përmban gjithçka dhe prej saj rrjedhin gjithë të tjerat ose siç shprehet Kroçe: “Liria përfshinë të gjithën dhe është e gjitha”⁴. Me këtë thënie, do të kuptojmë se, ajo është gjithçka dhe na jep gjithçka. Liria nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të kapet thelbi i saj, nëse

2. Kroçe, B. 2003. *Filozofia ime*. Botimet Enciklopedike. Fq. 76.

3. Kroçe, B. 2003. *Filozofia ime*. Botimet Enciklopedike. Fq. 76.

4. Kroçe, B. 2003. *Filozofia ime*. Botimet Enciklopedike. Fq. 77.

nuk e ke kuptuar atë vetë. Kjo për vetë faktin se, nuk mund të ketë thelb të ndryshëm nga vetja, jashtë saj dhe përtej saj. Ajo është vetë thelbi, forma dhe përmbajtja e vetvetes duke u përkufizuar nga vetvetja dhe duke qenë thelbësisht vetvetja. Ajo është më supremja, më kuptimplota për njeriun. Ajo thjesht është ajo që krijon gjithçka. Nga kjo mënyrë e të argumentuarit, na vjen ndërmend Hegeli pasi edhe vetë Kroçe është mbështetur në idetë e tij, dhe posaçërisht tek ideja përfundimtare e Hegelit të një “shpirti absolut”.⁵

Edhe Kroçe e shikon lirinë si thelb të shpirtit dhe ajo është absolutja që shfaq të gjithën. Përmendëm pak më lart se thelbi i njeriut është liria, liria si thelb i shpirtit, ku ky i fundit me “veprimtarinë e tij ,përbën realitetin e tij”⁶. Liria e cila vepron brenda shpirtit, gjithmonë krijon duke i dhënë shpirtit veprimtarinë e tij dhe me veprimtarinë e tij krijohen realitetet, ku këto të fundit shfaqen në planin e konkretes.

Nga këtu ne shohim se liria është ajo që prodhon dhe vepron në çdo sferë të jetës dhe duke qenë thelbi, natyrshëm, është edhe forca që projektton dhe krijon realitetet. Nga kjo, lind morali, historia, shkenca, estetika, feja, politika, ekonomia etj. Pra çdo veprimtari njerëzore merr hovin e saj, pikërisht nga liria që është në rrënjët e shpirtit.

Liria, duke qenë burim i krijimtarisë, objektivizohet tek shpirti. Njeriu duke u bërë i vetëdijshëm për krijimtarinë e tij, të cilat mund të jenë të ndryshme, vendos se kush është morali më i mirë, zakonet më të mira, feja më e besueshme, pra, gjithçka që përputhet me lirinë dhe me krijimet e tij. Ndaj, shohim shpesh mënyra të ndryshme të konceptimit për botën në tërësi, sepse qenia jonë, duke e projektuar realitetin në lirinë e saj, do të zgjedhë atë që është në përputhje me shpirtin e saj ose do ta ndryshojë ose do të sjellë risi në mundësitë e pafundme që mund t’i paraqesë natyra e tij.

Sipas Kroçes, e gjithë çka ne shohim dhe jetojmë, sot, nuk është gjë tjetër veçse krijimtaria e lirisë së shpirtit tonë. Ajo bëhet burim forcash të pashtershme për të krijuar gjithmonë e për të mos pushuar në asnjë moment. E tillë është liria, nuk rresht së menduari dhe së prodhuari. Gjithçka është një proces përpunimi dhe kjo fillon pikërisht nga formimi i njeriut. Realiteti që

5. Stumpf, S. E. *Filozofia, historia dhe problemet*. Botimet Toena. Fq. 320.

6. Kroçe, B. 2003. *Filozofia ime*. Botimet Enciklopedike. Fq. 76.

ai krijon mbi të gjitha, është një proces formimi i qenies së tij. Ai formohet dhe riformohet, sepse nga thelbi i tij buron gjithmonë forca e lirisë, burim që shuhet bashkë me ekzistencën tonë jetësore.

Gjithsesi, ajo që Kroçe bën është se, përveçse ai flet me pasion për lirinë, duket më konkret në realizimin e saj. Ai merr disa të vërteta nga idealizmi i Hegelit dhe me mjeshtri i zbret ato në jetën tonë konkrete, duke i prekur dhe duke reflektuar në mendimin e tij filozofik. Sepse, sipas tij, e mira e gjithë lirisë sonë është që ajo të shtrihet dhe të kuptohet drejt në planin e konkretes. Pasi është jeta jonë, ajo që duhet përmirësuar në ç'do hap të saj, është po kjo, që duhet mbushur gjithmonë, që të jetë sa më shumë dinamike. Por, për t'u plotësuar të gjitha këto dhe për të qenë e tillë, duhet jetuar në liri. Ndaj vetë Kroçe do të shprehej se: "Liria, ashtu si dashuria, është jeta që kërkon të përhapet dhe të kënaqet me veten, jeta në të gjitha format e saj dhe e ndjerë nga secili sipas mënyrës së vet, në atë larmi të pafund, në atë individualitet prirjesh dhe veprash me të cilat është endur njësia e universit"⁷. Një liri jetësore, optimiste dhe ekzistenciale, si një kusht i domosdoshëm i jetës sonë dhe terrenit ku ajo vepron. Larmia, lëvizja, progresi, konfrontizmi (në kuptimin pozitiv) etj., janë prirjet drejt lirisë. Forca dhe aftësia e saj qëndron në pafundësinë dhe mos shterimin e përpjekjeve për t'i dhënë zgjidhje problemeve dhe jo thjesht të jesh i lirë për të zgjidhur një problem të caktuar.

Me pak fjalë, ajo nuk është një vullnet i lirë zgjedhjeje, por një shpirt i lirë që punon dhe krijon për atë që është më e mira dhe kjo krijimtari shkon në pafundësi.

7. Kroçe, B. 2003. *Filozofia ime*. Botimet Enciklopedike. Fq. 155.

BIBLIOGRAFIA

1. Berlin. I . 2003. *Idetë filozofike të shekullit të XX dhe katër ese mbi lirinë*. Botimet Onufri.
2. Carrol. J. 2010. *Dialogu i Qytetërimeve*. Botimet Prizmi and Light. Tiranë.
3. Jacoby. E. 2006. *Filozofët më të mëdhenj të kohërave*. Botimet Shekulli. Tiranë.
4. Stumpf. S. *Filozofia, Historia dhe Problemet*. Botimet Toena. Tiranë.

MOTIVIMI I ADOLESHENTËVE PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE PLASTIKE

MSc. Enxhi Marku

ABSTRAKT

Ndërhyrja kozmetike është një fenomen që lidhet drejtpërdrejt me aspektet psikologjike të individit dhe një ndër shembujt më përfaqësues të ndikimit të aspekteve emocionale në vendimet e konsumatorëve. Qëllimi i këtij studimi është të identifikohen motivet që i shtyjnë adoleshentët të kryejnë ndërhyrje kozmetike. Metoda e përdorur për të realizuar këtë kërkim ishte anketimi. Ndër motivet kryesore që nxisin adoleshentët të kryejnë ndërhyrje kozmetike rezultoi: familja, vetë individi, të tjerët dhe burimet e informacionit jo të dominuara nga marketingu si p.sh. diskutimet në ambientet shoqërore. Klinikat që kryejnë këto ndërhyrje kozmetike duhet të informojnë dhe të komunikojnë në mënyrë më efektive me adoleshentët.

Kufizimet e Studimit

1. Ky studim është ndërmarrë në një kohë të kufizuar.
2. Buxheti në dispozicion për këtë studim ka qenë i kufizuar.
3. Aksesimi ndaj subjekteve të studimit ka qenë i kufizuar.

4. Fakti që subjektet janë adoleshentë, e bën informacionin jo qëndrueshëm në kohë.
5. Në raste të tilla, individët jo gjithmonë duan t'i zbulojnë motivet e tyre reale.
6. Për realizimin e këtij studimi është supozuar se të gjithë adoleshentët e moshës 15-18 vjeç ndjekin shkollën e mesme.

1. Hyrja

Qëllimi i këtij punimi është identifikimi, kuptimi dhe interpretimi i motiveve që i shtojnë adoleshentët të konsiderojnë ndërhyrjet kirurgjikale plastike, në të ardhmen, në funksion të hartimit dhe të implementimit të një strategjie marketingu efektiv me fokus konsumatorin. Në radhë të parë do të hedhim një vështrim mbi teoritë e motivimit. Gjithashtu, do të shohim motivimin e adoleshentëve në botë në lidhje me operacionet plastike duke marrë në konsideratë edhe disa rezultate të studimeve konkrete të realizuara nga mjekë apo psikologë, profesionistë të fushës.

Në pjesën e tretë do të njihemi me metodologjinë e studimit, me metodën përkatëse dhe mundësitë analizuese që të jep kjo metodë.

Pjesa e katërt dhe e pestë janë analiza e gjetjeve. Pjesa e katërt përfshin identifikimin dhe analizën thellësisht të të gjithë faktorëve që ndikojnë në qëndrimet që adoleshentët kanë kundrejt operacioneve plastike. Do të shohim motivet e ndërgjegjshme, por gjithashtu do të thellohem për të zbuluar edhe motivet e fshehta. Pjesa e pestë përfshin një interpretim më të thellë dhe konkret të motivimit. Së fundi do të shohim se cila pjesë e popullsisë do të jetë një treg potencial për këtë lloj shërbimi.

Në pjesën e fundit do të përmbledhen shkurtimisht gjetjet dhe do të sugjerohen strategjitë e mundshme që kirurgët ose klinikat e ndryshme në këtë fushë duhet të ndjekin. Hartimi i strategjive mbështetur në motivet e konsumatorit do të rrisë mundësinë e ofrimit të një niveli shërbimi superior ku prioritet është kënaqësia e klientit të ardhshëm apo edhe atij aktual. Gjithashtu, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet hartimit të strategjive në përputhje me elementët e Etikës Profesionale.

2. Vështrim Kritik i Literaturës

2.1. Koncepti i Motivimit

Termi motivim, që rrjedh nga fjala latine “movere” domethënë, “lëviz”, “nxit”, përmban dy elementë: drejtimin dhe energjizimin ose gjallërimin. Teoritë e motivimit ekzaminojnë drejt çfarë aktiviteteve, detyrash apo qëllimesh “lëvizin” njerëzit (drejtimi) dhe cilët faktorësh i bëjnë ata të lëvizin (energizimi)¹². Në ditët e sotme koncepti “Motivim”, është i nevojshëm në çdo fushë por nuk ekziston një përkufizim “i prerë”. Studiues në fusha të ndryshme e përkufizojnë atë në forma të ndryshme. Megjithatë, esenca (thelbi) i konceptit “Motivim” mbetet i njëjtë.

Motivimi përfaqësohet nga forca të ndryshme, që veprojnë mbi ose brenda një personi dhe që e shtojnë atë të sillet në një mënyrë të caktuar, të orientuar nga disa qëllime (objektiva). “Motivimi është një konstrukt hipotetik që përdoret për të shpjeguar sjelljen, ai nuk duhet të ekuivalentohet me të”. Motivimi në këndvështrimin e sjelljes së individit në një organizatë mund të përkufizohet si “gatishmëria e një individi që përpiqet për arritjen e objektivave të organizatës, duke vënë në përdorim një sasi të madhe energjish dhe përpjekjesh, me kusht që këto përpjekje të sjellin plotësimin e objektivave të tij individuale”. Në fushën e psikologjisë Motivimi përcaktohet si proces që inicion, udhëzon, dhe mban sjelljet të orientuara nga qëllimi. Motivimi është ajo çka na bën të veprojmë”³.

Motivimi në Sjelljen Konsumatore paraqet “motorin” e kënaqjes së nevojave fiziologjike dhe psikologjike, nëpërmjet blerjes dhe konsumit të produkteve. Pra, megjithëse ekzistojnë një sërë përcaktimesh mund të themi se në thelb Motivimi është “Pse bëjmë këtë që bëjmë”⁴. Të njëjtën gjë mund të themi se vlen edhe për shërbimet.

1. Ryan, R. M. & Deci, E. L. 1985. *Intrinsic and Extrinsic Motivations*.

2. Pintrich, P. R. 2000. *An Achievement Goal Theory Perspective on Issues in Motivation Terminology*.

3. Kasimati, M. 2010. *Sjellje Organizative*.

4. Bakiu, V. 2007. *Sjellje Konsumatore*.

2.2. Procesi i Motivimit

Procesi i motivimit është një proces jo i thjeshtë, pasi në qendër është individi me nevojat dhe dëshirat e tij. Në tërësinë e tij procesi motivimit është mjaft kompleks pasi lidhet me perceptimin. Ky cikël fillon me identifikimin e një nevoje të paplotësuar, e cila shkakton një tension psikologjik dhe emocional brenda individit. Pas identifikimit të kësaj nevoje të pa plotësuar dhe të këtij tensioni, vijnë një sërë veprimesh apo sjelljesh që individi ndërmerr me qëllim plotësimin e kësaj nevoje. Me përmbushjen e nevojës mbyllet cikli motivues për të vazhduar përsëri këtë rrugë për kënaqjen dhe plotësimin e një nevoje tjetër që mund të shfaqet në të ardhmen⁵.

Vështrimi kritik i literaturës mbi Kirurgjinë kozmetike tek adoleshentët

Kirurgjia kozmetike është rritur në mënyrë dramatike gjatë 10 viteve të fundit. Me këtë rritje në popullaritet, qëndrimet kanë ndryshuar. Pak njerëz po plaken me dinjitet, ndërkohë që shumë të tjerë po pranojnë alternativën e kirurgjisë kozmetike. Por, në kohën që kërkesa vazhdon të rritet është e rëndësishme, për punonjësit e kujdesit shëndetësor, të njohin motivin prapa vendimit për të kërkuar kirurgji kozmetike.

1. Një studim i realizuar nga ASPS në lidhje me identifikimin e motiveve tek adoleshentët për të kryer operacione plastike vuri re se: “Adoleshentët që duan të ndërmarrin një kirurgji plastike zakonisht motivohen nga motive dhe qëllime të tjera krahasuar me të rriturit. Ata shpesh bëjnë kirurgji plastike për të përmirësuar karakteristikat fizike, jo të pëlqyeshme nga ana e tyre, të cilat nëse lihen “pa u korrigjuar”, mund të ndikojnë gjatë rritjes apo në moshën adulte. Adoleshentët kanë tendencë të ndërmarrin kirurgji plastike për t’u përshtatur me moshatarët, pra, të duken të ngjashëm, ndërsa të rriturit shfaqen ndryshe. Ata kanë tendencë të kryejnë kirurgji plastike për t’u shquar/dalluar nga të tjerët”⁶. Karakteristikat fizike apo shqetësimet që një adoleshent dëshiron të korrigjojë përfshijnë hundë të deformuar, veshë

5. Kasimati, M. 2010. *Sjellje Organizative*.

6. ASPS. 2013. *Plastic Surgery Statistics: Cosmetic Patients Ages 13-19*.

të spikatur, gjinj të sheshtë, gjinj asimetrikë, ose puçrra të rënda dhe me dhëmbëza. Adoleshentët shpesh e fitojnë vetë-respektin dhe besimin kur problemet e tyre fizike janë korrigjuar. Në fakt, operacioni i suksesshëm plastik mund të përmbysë efektin social që shoqëron adoleshentët që ndihen si të “ndryshëm” në kuptimin jo pozitiv.

2. Një studim tjetër i realizuar nga American Academy of Facial Plastic and Reconstructive Surgery konstaton se: trendi “Selfie” ka rritur kërkesën për operacione plastike në fytyrë. Studimi zbuloi nga vëzhgimi se një në tre kirurgji plastike të fytyrës vinin për shkak se pacientët ishin bërë më të ndjeshëm ndaj pamjes së tyre në rrjetet sociale. Në fakt, 13% e adoleshentëve të vëzhguar nga AAFPRS, identifikuan një rritje në publikimin e fotografive dhe gjithashtu një rritje në pakënaqësinë e të rinjve për imazhin e tyre në faqet e rrjeteve sociale, si një trend në rritje. Nga të rinjtë e vëzhguar AAFPRS vuri re një rritje prej 13% në lidhje me shpërndarjen e fotografive në rrjetet sociale dhe pakënaqësisë në rritje të tyre në lidhje me fotografitë që ata vetë shpërndanin si pasojë e këtij trendi.

Platformat sociale si Instagram, Snapchat dhe iPhone app Selfie.im, të cilat janë vetëm imazh i bazuar virtual “i detyrojnë” adoleshentët të bëjnë “zoom” sikur të duan t’i shohin me mikroskop imazhet e tyre apo t’i shohin me një sy vetë-kritikues, më shumë se kurrë më parë. Këto imazhe janë shpesh përshtypjet e para që të rinjtë duan të lënë tek miqtë e mundshëm apo punëdhënësit. Adoleshentët duan të shfaqin fytyrën e tyre “më të mirë”.

3. Metodologjia e studimit

Për të realizuar këtë punim jam mbështetur në kombinimin e kërkimit primar me atë sekondar. Fillimisht është realizuar një vështrim kritik i literaturës në fushën e sjelljes, motivimit dhe operacioneve plastike (seksioni 2).

3.1. Kërkimi Primar

Metoda e zgjedhur e kërkimit është anketa. Me anë të saj kam mbledhur të dhëna sasiore dhe përfaqësuese për popullsinë. Popullsia e këtij studimi, janë adoleshentët që jetojnë në Tiranë. Numri i popullsisë së Tiranës për moshën

15-19 vjeç është rreth 158.920 persona⁷. Duke përdorur një llogaritës të thjeshtë, numri i zgjedhjes me një interval besimi 8.5% dhe nivel besimi 90%, rezultoi në 95 individë⁸.

Për të pasur një zgjedhje sa më përfaqësuese, kam marrë në studim nxënësit e tre gjimnazeve bazuar në vendndodhjen e tyre. Për të përcaktuar këtë vendndodhje pika e referimit është qendra (pra, largësia e tyre nga kjo pikë). Duke u mbështetur në këtë kriter kam identifikuar tri zona kryesore: Zona Periferike (Kombinat), Zona e Qendrës (Brenda Unazës) dhe Zona e Ndërmjetme (Jashtë Unazës).

Përveç pozicionimit fizik të këtyre gjimnazeve, kam marrë në konsideratë se nga cilat shkolla 9-vjeçare janë prurjet e tyre. Rrjedhimisht, gjimnazet frekuentohen nga nxënës që përfundojnë shkollën 9-vjeçare përreth tyre, sipas rregullores së Drejtorisë Arsimore. Nga ky rregull mund të kemi përjashtime të mundshme, por masa e përjashtimeve është relativisht e vogël dhe jo domethënëse për rezultatin e këtij studimi.

Nga 100 pyetësorët që shpërndamë, 12 prej tyre u eliminuan pasi rezultuan të pavlefshëm, duke dhënë një zgjedhje prej 88 individësh, e cila është përsëri një zgjedhje përfaqësuese. 88 individë përfaqësojnë një normë të përgjigjeve 88%.

Ajo që vlen të theksoj qëndron në faktin e formulimit të pyetjeve, edhe pse në parim “afati kohor” është një tregues i rëndësishëm i sjelljes konsumatore. Në këtë rast ky kriter kohor nuk është përdorur pasi ata që anketohen janë adoleshentë, mosha 15-19 vjeç, ndërsa mosha për të kryer një operacion plastik është minimumi 18 vjeç. Duke qenë se ky pyetësor kërkon më tepër të përcaktojë trendin apo të shpjegojë motivet, në afatgjatë asgjë nuk është konstante. Nëpërmjet këtij punimi synoj të identifikoj motivet në këtë periudhë. Nëse ato do të jenë të qëndrueshme apo jo, është e nevojshme të kryhen studime të tjera në po këta adoleshentë, në mënyrë të vazhdueshme.

7. www.instat.gov. Bashkia e Tiranës. 2009. *Statistikat e Tiranës*, (Aksesuar: 15.01.15)

8. <http://www.calculator.net/sample-size-calculator.html?type=1&ci=90&ci=8.5&ps=158920&x=58&y=8>

(Aksesuar: 04.02.15)

Pyetjet kërkimore:

1. Nga se motivohen adoleshentët për të kryer një operacion plastik?
2. Sa ndikohen adoleshentët nga të tjerët?
3. Çfarë qëndrimi kanë ata ndaj pamjes së tyre të jashtme?
4. Cilat janë burimet e informacionit mbi operacionet plastike?
5. A do të konsideronin ata kryerjen e një operacioni plastik në të ardhmen?
6. Sa prej tyre janë klientë potencialë për operacione plastike?

4. Faktorët që ndikojnë në procesin e motivimit ndaj operacioneve plastike

4.1. Faktori “Të tjerët”

Fakti që pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen se nuk u intereson opinioni i të tjerëve, ose u intereson vetëm mjaftueshëm, nuk është e thënë të jetë ajo çka ndodh realisht. Metoda e përdorur ishte anketa anonime. Pavarësisht anonimitit, duhet të marrim në konsideratë disavantazhin që derivon nga vetë të anketuarit, në momentin që ata nuk duan të zbulojnë motivimin e tyre⁹. Përgjigja e pyetjes se sa i rëndësishëm është për ju opinioni i të tjerëve, mund të jetë ajo çka duan konsumatorët që të tjerët të mendojnë për ta, dhe jo ajo çka ata mendojnë dhe ndiejnë realisht. Ndonjëherë njerëzit prirën t'i fshehin motivet e tyre reale, hipotezë kjo që nëse vërtetohet, hedh poshtë dhe rezultatin e përgjithshëm të të anketuarve, pra, që nuk u intereson mendimi i të tjerëve. Ky argument është arsyetuar më tej në këtë kapitull.

Vihet re që influenca më e madhe ndaj qëndrimit pro ose kundër operacioneve plastike është familja. Në totalin e të anketuarve 40.9% ndikohen nga familja. Nëse e ndajmë vëmendjen midis atyre që janë të gatshëm të kryejnë operacione dhe atyre që nuk janë të gatshëm, 30% e të parëve nuk ndikohen nga familja dhe 41.1% e të dytëve ndikohen nga ajo. Pra, vihet re se ata që nuk do të kryenin operacione janë më tradicionalë dhe kanë një ndikim më të madh nga familja. Nga ana tjetër, ata që do të kryenin një operacion kanë

9. Bakiu, V. 2007. *Sjellje Konsumatore*.

një ndikim të njëjtë midis familjes dhe vetvetes. Ata janë më të pavarur nga mentaliteti dhe opinioni i të tjerëve.

Rezultoi se në momentin që nxënësit pyeteshin në lidhje me një situatë hipotetike ku dikush tjetër kishte kryer një operacion plastik dhe ata duhet të përmendnin një apo disa motive që mund ta kishin shtyrë këtë të fundit në vendimarrje, u vu re një lloj trendi në përgjigje. Duke qenë se ishte një pyetje e hapur identifikimi dhe kombinimi i motiveve varionte.

Përmendim:

- Shoqëria paragjyquese/ Opinioni;
- Mungesë vetëbesimi / Të ndihem më mirë;
- Pamje jo tërheqëse / Të ndihem më mirë;
- Dëshira / Pamje më tërheqëse/ Të ndihem më mirë.

Pjesa më e madhe i drejtoheshin shoqërisë si paragjyquese. Opinioni i të tjerëve diktonte një ndjesi inferioriteti/individit nuk ndihet mirë. Gjithashtu mungesa e vetëbesimit apo pamja e jashtme, ishin arsytet e mundshme të shprehura nga ata për këtë rast hipotetik. Identifikimi i shoqërisë si paragjyquese lë shumë vend për diskutim. Mbështetur në rezultatet e anketës të analizuara më sipër mund të vëmë re një lloj kontradikte për sa i përket kësaj situate.

Rreth 50% e nxënësve nuk ishin të ndjeshëm ndaj opinionit publik për pamjen e tyre të jashtme, e konsideronin atë të parëndësishme. Kjo përqindje ndiqej nga ata që e konsideronin atë relativisht të rëndësishme, rreth 41%. Nga kjo kontradiktë kuptojmë një lloj perceptimi të hapur në masë, në lidhje me operacionet plastike. “Duhet të jesh i shëmtuar...” apo “Duhet të kesh një defekt mjaft të dukshëm në pamjen tënde...” për të realizuar një operacion plastik. Edhe në qoftë se do të linim mënjatë rastin hipotetik dhe interpretimin e tij bazuar në literaturën shkencore, mund të themi se këta nxënës që shprehin këto motive janë po ata nxënës që janë pjesë e kësaj shoqërie paragjyquese dhe përderisa ata paragjykojnë, kanë frikë se do të paragjykojnë. Si përfundim, nxjerrim konkluzionin se opinioni i të tjerëve nuk qenka dhe aq i parëndësishëm për ta, sidomos nëse, të tjerët, janë familjarë.

4.2. Faktori “Vetvete”

Edhe pse 76% e të anketuarve shprehen se nuk ka asgjë që nuk shkon me pamjen e tyre, 24% do të ndryshonin diçka tek trupi i tyre. Çudia është që vetëm 19% e këtyre personave do të merrnin përsipër ndërhyrjen kirurgjikale për ta plotësuar këtë dëshirë. Në këtë çast mund të mendohet se përgjigjet kontradiktore hedhin poshtë njëra-tjetrën, por nuk ndodh kështu. Shumë dëshira dhe ëndrra të njerëzve mbesin të tilla sepse ata nuk janë të gatshëm të ndërmarrin një veprim për t'i përmbushur ato. Ky është dhe rasti i të anketuarve që, edhe pse duan të ndryshojnë diçka në trupin e tyre, nuk duan të ndërmarrin një operacion plastik. Arsytet e këtij mosveprimi mund të jenë paragjykimet e të tjerëve apo frika, sepse besohet se këto ndërhyrje janë të rrezikshme për shëndetin. Këto dhe të tjera arsye janë diskutuar gjerësisht më tej gjatë kësaj analize.

Për sa i përket personave që do të ndryshonin diçka në trupin e tyre (edhe pse nuk mendojnë thellësisht se ka diçka që nuk shkon dhe janë shprehur të hapur ndaj mundësisë për të kryer operacione plastike në të ardhmen), arsyet kryesore të kësaj kontradikte mund të jenë:

Së pari, studimet kanë treguar se ka njerëz të cilët sëmuren me sindromën BDD (Body Dysmorphic Disorder)¹⁰. Edhe pse trupi i tyre nuk ka asnjë gjë që nuk shkon në tërësinë e tij, ata fiksohen pas detajeve të vogla, të cilat u duken problematike. Këta njerëz janë konsumatorë të cilët edhe pasi kanë bërë ndërhyrjen dhe çdo gjë ka shkuar sipas parashikimit, ende nuk janë të kënaqur, sepse problemi i tyre nuk qëndron në aspektin fizik, por në atë psikologjik¹¹.

Së dyti, ndryshimi në trupin e tyre mund të shihet si diçka potenciale. Pra, ata mund të bazohen nga ndonjë tipar të trashëguar familjarisht që do të zhvillohet në të ardhmen dhe ata do të duan ta ndryshojnë atë. Ata e dinë që kur të arrijnë njëfarë moshe do t'iu duhet të bëjnë ndërhyrje, pasi do të ketë diçka që nuk do të jetë në rregull me pamjen e tyre.

10. Dorn, C. A. 2000. *Cutting Remarks: On Ethics, Consumer Behavior and Cosmetic Plastic Surgery*. San Diego. State University - Imperial Valley.

11. Billick, St. B. & Ericksen, W. L. 2012. *Psychiatric Issues in Cosmetic Plastic Surgery*.

4.3. Faktori “Gjini dhe Moshë”

Nga 70% femra të anketuara, 35% e tyre ishin të motivuara dhe mendonin se në të ardhmen do të mund të realizonin ndërhyrje kirurgjikale apo jo-kirurgjikale, ndërkohë që raporti i meshkujve ishte shumë më i ulët. Kjo diferencë preferencash midis gjinive nuk është diçka e re. Edhe në botë, meshkujt janë prezantuar më vonë me këto ndërhyrje. Diçka tjetër që vlen të përmendet është se, nëse vajzat kanë një gamë më të gjerë operacionesh nga ku mund të zgjedhin, meshkujt e kanë më të reduktuar këtë listë. Së fundmi, arsyeja thelbësore se pse meshkujt bëjnë një operacion plastik është për të ruajtur punën e tyre kur ata kanë një paraqitje të jashtme e cila dëshmon më shumë vite se sa duhet në fytyrën e tyre¹². Duke qenë se të anketuarit janë ende adoleshentë, pra në një moshë fare të re, ata ende nuk janë të prekur nga nevoja e mësipërme.

Duke u bazuar në moshën e tyre shikojmë se duke kaluar nga 15 në 18 vjeç probabiliteti i ndërhyrjeve vjen duke u rritur. Kjo ndoshta për faktin se gradualisht fiton një liri më të madhe në të vendosurit për veten, është më i ndërgjegjshëm dhe më i sigurt në atë që kërkon. Gjithashtu, aksesit në informacion dhe kuptimi për veten dhe shoqërinë është më i zhvilluar. Sa më shumë vite kalojnë aq më shumë informacion akumulohet dhe depozitohet në memorien tonë. Nga ana tjetër, sa më shumë informacion të kemi aq më tepër orientohejmë drejt marrjes së një vendimi¹³.

4.4. Faktori “MakroKulturë”

Rikthehemi dhe njëherë në idenë kryesore të seksionit 4.2. Në pamje të parë njerëzit që kanë më shumë pakënaqësi nga pamja e tyre janë më të prirur të ndërmarrin operacione plastike. Vetëm 17% e njerëzve që nuk do të kryenin një operacion janë të pakënaqur nga diçka në lidhje me trupin e tyre, ndërsa 30% do të konsideronin mundësinë e kryerjes së një operacioni plastik. Por duke parë dhe rezultatin e pyetjes verifikuese, mendoj se numri i atyre që mendojnë se ka diçka që nuk shkon në pamjen e tyre dhe duan të

12. Dorn, C. A. 2000. *Cutting Remarks: On Ethics, Consumer Behavior and Cosmetic Plastic Surgery*. San Diego. State University - Imperial Valley.

13. Bakiu, V. 2007. *Sjellje Konsumatore*.

bëjnë operacion, shkon mbi 30%. Megjithatë kjo gjë nuk ka ndikuar në asnjë aspekt të jetës së tyre.

Një gjë e tillë nuk përbën gjetje për kulturën tonë me frymë kolektiviste, por nëse do të kishim të njëjtin rezultat në SHBA atëherë do të ishte vërtetë çudi. Një pjesë e mirë e të rinjve që kryejnë operacione plastike në SHBA arsyen bazë e kanë sepse ngacmohen dhe përçmohen nga bashkëmoshatarët e tyre¹⁴. Kohët e fundit kirurgët plastikë kanë filluar të analizojnë mirë motivet e individëve që kërkojnë të bëjnë ndërhyrje të kësaj natyre. Kirurgët e mirë-afirmuar dhe profesionistë nuk pranojnë klientë që kanë baza motivimi ngacmimet e të tjerëve, sidomos në periudhën e adoleshencës, e cila shihet si një moshë me sjellje kalimtare dhe të paqëndrueshme.

Operacionet në moshë të tillë përveç riskut shëndetësor kanë dhe risk të lartë emocional dhe mundësi të mëdha mungese kënaqësie nga rezultati apo dhe pendesë kur individ arrin një moshë më të pjekur¹⁵. Edhe pse kirurgët në SHBA kanë filluar t'i studiojnë mirë motivet që çojnë në ndërhyrjet plastike ka ende nga ata që shfrytëzojnë çdo mundësi, pavarësisht etikës. Këta lloj kirurgësh kanë një orientim afatshkurtër dhe nuk nisen nga kënaqësia konsumatore, e cila duhet të jetë afatgjatë dhe jo e përkohshme, duke qenë se risku dhe kostot që konsumatori merr përsipër janë vërtetë të mëdha¹⁶. Nisur nga mjedisi kulturor në vendin tonë, do të arrinim në konkluzionin se tregu shqiptar nuk është atraktiv për këta lloj kirurgësh, pasi këtu motivet që i çojnë njerëzit në kryerjen e një operacioni plastik janë kryesisht të brendshme. Për më tepër, në vendin tonë, efekti i shoqërisë mund të ndikojë me kah të kundërt me atë në Amerikë. Nëse atje shumica janë indiferentë ndaj këtyre ndërhyrjeve, në Shqipëri paragjykimi dhe gjykimi mund të jetë i madh. Kjo gjë vihet re nga përgjigjet që i jepen pyetjes se çfarë justifikimi do t'i jepnit një personi që e dini se ka bërë një operacion plastik.

14. Collins, L. M. 2013. *Teens turn to plastic surgery; experts tackle the when and why*.

15. Dorn, C. A. 2000. *Cutting Remarks: On Ethics, Consumer Behavior and Cosmetic Plastic Surgery*. San Diego. State University - Imperial Valley.

16. Billick, St. B. & Ericksen, W. L. 2012. *Psychiatric Issues in Cosmetic Plastic Surgery*.

5. Motivimi ne vetvete dhe elemente të tjerë

5.1. Arsyeja e shprehur e motivimit

Arsyeja kryesore përse këta të rinj do të ndërmerrnin një ndërhyrje në të ardhmen është për t'u dukur më mirë. Kjo përgjigje ka një gamë të gjerë interpretimi dhe përfshirjeje, madje mund të përfshijë dhe disa nga alternativat e tjera të përgjigjes së pyetjes, alternativa si: imazhi ideal ose të dukurit i veçantë (pasi ne kemi një ide të caktuar mbi të bukurën). Gjithashtu, të dukurit mirë siguron afeksion dhe dashuri, pranueshmëri nga shoqëria, status social, kënaqësi, vetëbesim etj. Pra, të dukurit mirë plotëson disa nën-lloje nevojash, që dhe pse në dukje të ngjashme, për secilin nga individët mund të jenë të ndryshme. Por, ajo që është nxitja më e fortë, sipas mendimit tim, është vetja bazuar në specifikimet e dhëna në kategorinë e atyre që kanë ndikim më të madh në mbajtjen e një qëndrimi. Ajo që do të ndikonte më shumë në marrjen e një vendimi pas familjes, nuk do të ishte as partneri dhe as shoqëria, por diçka tjetër, që më së shumti është përcaktuar si vetvetja. Duke qenë vetvetja, ne plotësojmë nevojën për kënaqësi dhe për t'i dhuruar (vetes)¹⁷. Duke i dhuruar dhe e kënaqur veten, duke u dukur me mirë, ne rrisim vetëvlerësimin, gjë që është krejtësisht personale dhe subjektive. Vetëm ne e dimë se sa vetëvlerësim kemi. Dominimi i vetes mbi familjen për qëndrimin pro ndërhyrjeve është argumentuar dhe më sipër në seksionin 4.1.

5.2. Nevojat që plotëson “Operacioni Plastik”

Edhe pse këta individë janë të gatshëm të ndërmarrin në të ardhmen një ndërhyrje kozmetike, aktualisht nuk kemi të bëjmë me një pakënaqësi reale ndaj objektit tek i cili do të ndërhyhet. Kjo gjë na çon drejt nevojave për imazh social dhe për kënaqësi. Duke parë në media të ndryshme personazhe të famshëm apo të njohur që bëjnë ndërhyrje të ndryshme plastike, mund të krijohet ideja se ata që bëjnë të tilla ndërhyrje mbajnë një status të caktuar në shoqëri, që si rrjedhojë paralelizohet me famën dhe luksin. Ky veprim mund

17. Bakiu, V. 2007. *Sjellje Konsumatore*.

të mbështetet duke qenë se është një hap më pranë nevojës për kënaqësi, e arrirë përmes suksesit të këtij “statusi”.

Një fakt që e mbështet këtë teori është përqindja e të anketuarve që nuk janë të gatshëm të ndërmarrin në të ardhmen një ndërhyrje kozmetike. Vetëm 22% e tyre mendojnë se një i famshëm të frymëzon për të bërë ndërhyrje ndërsa për sa i përket të anketuarve që do të bënin një ndërhyrje, 50% e tyre mendojnë se një i famshëm të frymëzon deri në një farë mase. Gjithashtu, duke u bazuar dhe në argumentet e përmendur në seksionet e mëparshme, midis nevojave që ky shërbim plotëson janë dhe nevoja për kënaqësi (nëse do të lidhnim kënaqësinë me bukurinë) dhe nevoja për të dhuruar. Kjo e fundit në vendin tonë mund të shihet si një nevojë për t’i dhuruar vetes (seksioni 5.1), ndërsa në vendet e SHBA shërbime të tilla ofrohen ndaj të tjerëve si dhurata Krishtlindjesh dhe Diplomimesh. Duke bërë kontrastin midis dy vendeve mund të themi që kjo nevojë është ende në fazën e saj fillestare të perceptimit në vendin tonë¹⁸.

5.3. Kërkesa Potenciale në të ardhmen

Edhe pse rreth 30% e të anketuarve do të merrnin në konsideratë kryerjen e një operacioni plastik në të ardhmen, u vu re se vetëm 31% e tyre kishin një ide të qartë se çfarë lloj operacioni do të kryenin. Kjo ide konkretizohet më shumë në pyetjen ku ata identifikonin në mënyrë specifike operacionin që ata do të kryenin. Ky specifikim, me të drejtë, na çon në supozimin se këta nxënës kanë probabilitetin më të lartë për ta kthyer në kërkesë dëshirën e tyre aktuale. Për të arritur në këtë supozim jemi mbështetur në mendimin se intensiteti i dëshirës për të kryer një operacion do të jetë më i fuqishëm kur kjo dëshirë fokusohet në një aspekt specifik, siç është ndërhyrja në hundë, që nga ana tjetër ishte dhe operacioni më popullor që do të bënin anketuesit tanë. Megjithatë, në momentin që dëshira për të kryer një operacion mbetet e përgjithshme, intensiteti shpërndalet dhe e humb efektin e tij për t’u kthyer në kërkesë.

18. Collins, L. M. 2013. *Teens turn to plastic surgery; experts tackle the when and why*.

6. Strategjitë e sugjeruara si rezultat i përpunimit dhe analizës së të dhënave

1. Klinikat nëpërmjet kuptimit të procesit të kërkimit të adoleshentëve duhet të monitorojnë në mënyrë të kujdesshme veprimet e kërkimit të tyre për të identifikuar mënyra të reja të përcjelljes së informacionit të plotë e të saktë. Nga punimi u identifikuan mjaft mangësi në mënyrën e komunikimit dhe besueshmërisë së informacionit që përcillej. Klinikat duhet të fokusohen në promocionin e atyre burimeve që adoleshentët kërkojnë më tepër, duke përfshirë edhe personat që sigurojnë informacion për ta. Kompanitë duhet të “luftojnë” për të realizuar imazhin e dëshiruar. Ato duhet të tregohen vigjilente, sidomos ndaj informacionit që transmetohet nga burimet jo të dominuar nga marketingu. Në këtë kategori shërbimi u vu re se impakti i këtyre burimeve të informacionit ishte domethënës;

2. Njerëzit që e konsiderojnë kirurgjinë plastike si një mundësi, duan sa më shumë informacion rreth këtyre ndërhyrjeve. Një mënyrë e mirë për të tërhequr sa më shumë pacientë do të ishte duke i “edukuar” ata përmes shkrimeve të artikujve të ndryshëm çka mund të ndikojë në vendimmarrjen e tyre. Shkrimi i sa më shumë artikujve rreth kirurgjisë plastike, kontaktimi me redaktorë të revistave dhe gazetave lokale apo kombëtare, pse jo dhe botimi i ndonjë libri për kirurgjinë plastike do të ndihmonin në informimin dhe mbasë në reduktimin e pacientëve të ardhshëm;

3. Rrjetet sociale janë një mënyrë shumë e mirë informimi gjithashtu. Krijimi i rrjeteve sociale apo i blogjeve, për të shpërndarë të dhëna rreth gjithë shërbimeve të ofruara, komunikimi me konsumatorët e mundshëm dhe mundësia e diskutimeve, mund të çojnë në rritjen e numrit të personave të interesuar për këtë fushë;

4. Reklamimi nëpërmjet billborderave apo fletëpalosjeve pranë qendrave shëndetësore, pjesëmarrja nëpër aktivitete vullnetare dhe sponsorizimi i eventeve të ndryshme lidhur me mjedisin, do të ndihmonin në njohjen më të mirë të kompanisë por edhe në krijimin e një imazhi të mirë;

5. Përmendëm më sipër që adoleshentët ndikoheshin nga eksperiencia e të tjerëve për të ndërmarrë mundësinë e një kirurgjie plastike. Prandaj, në mënyrë që të kenë referime sa më të mira nga ana e ish-pacienteve,

personeli mjekësor duhet të përqendrohet në trajtimin e kënaqshëm të këtyre pacientëve për sa kohë ata gjenden pranë zyrës së tyre dhe duhet t'i përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve para dhe pas trajtimit. Rezultatet e suksesshme shpesh varen, pjesërisht, nga komunikimi efektiv midis pacientit dhe kirurgut. Prandaj është e rëndësishme që pacientet të ndihen sa më rehat;

6. Etika Profesionale duhet të jetë një nga elementët primar që duhet të merren në konsideratë në hartimin e strategjive të klinikave kirurgjikale. Ofrimi i një shërbimi në kushte të cilësuar jo etike, dëmton në mënyrë kategorike reputacionin e klinikës, e cila mund të procedohet më tej edhe në aspektin juridik. Fokus i strategjisë duhet të jetë ofrimi i shërbimit në përmbushje të të gjitha standardeve në të gjitha aspektet;


7. Strategjia duhet të ketë fokus klientin. Klinikat duhet të identifikojnë dhe kuptojnë motivet e adoleshentëve. Mbështetur në to, mund të hartohen strategji për të arritur tek ata duke ofruar një vlerë të shtuar të shërbimit. Klinikat duhet në mënyrë të vazhdueshme të studiojnë motivet duke qenë se ato jo domosdoshmërisht janë të qëndrueshme në kohë, pra, si rrjedhojë të realizojnë dhe të hartojnë strategji fleksibël në kohë.

REFERENCA


1. ASPS. 2013. *Plastic Surgery Statistics: Cosmetic Patients Ages 13-19*.
2. Bakiu, V. 2007. *Sjellje Konsumatore*.
3. Bakiu, V. 2010. *Sjellje Konsumatore*.
4. Billick, St. B. & Ericksen, W. L. 2012. *Psychiatric Issues in Cosmetic Plastic Surgery*.
5. Collins, L. M. 2013. *Teens turn to plastic surgery; experts tackle the when and why*.
6. Dorn, C. A. 2000. *Cutting Remarks: On Ethics, Consumer Behavior and Cosmetic Plastic Surgery*. San Diego. State University - Imperial Valley.
7. Feldman,P. 2013. *Five Types of People are Not Good Candidates for Plastic Surgery, Says Advanced Aesthetics*.
8. Kasimati, M. 2010. *Sjellje Organizative*.
9. Motivation Terminology. 2000.
10. Pintrich, P. R. 2000. *An Achievement Goal Theory Perspective on Issues in Motivation Terminology*.
11. Ryan, R. M. & Deci, E. L. 1985. *Intrinsic and Extrinsic Motivations*.
12. www.instat.gov. Bashkia e Tiranës. 2009. *Statistikat e Tiranës*, (Aksesuar: 15.01.15).
13. <http://www.calculator.net/sample-sizecalculator.html?type=1&cl=90&ci=8.5&ps=158920&x=58&y=8> (Aksesuar: 04.02.15).

SHTOJÇË

Sa i rëndësishëm është për ju opinioni i të tjerëve ndaj pamjes suaj të jashtme?




A mendoni se ka diçka që nuk shkon në pamjen tuaj?



A keni informacion për ndërhyrjet kozmetike kirurgjikale ose jo kirurgjikale?




A do të dëshironit që ndonjë aspekt i pamjes suaj të jashtme të ishte ndryshe?




Deri në ç'masë jeni dakord me thënien: "Një njeri i famshëm të frymëzon për të bërë ndërhyrje"?




A do të merrnit në konsideratë kryerjen e një ndërhyrje kozmetike në të ardhmen?




Cilat janë arsyt që mund t'ju shtynë të konsideroni kryerjen e një operacioni plastik në të ardhmen?



Kush do të ndikonte më shumë tek ju nëse do të merrnit ose jo hapin për të bërë një operacion?



Deri në ç'masë jeni dakord me thënien: "Ndërhyrjet kozmetike janë të dëmshme për shëndetin"?




SUMMARY

The scope of this article is to identify, understand and analyse motives that make teenagers consider having a plastic surgery in the future, with the aim to create and implement an effective marketing strategy with the customer in mind. The second part contains a literature review on motivation's theories. It also includes a literature review on the motivation of teenagers to consider plastic surgeries while taking into consideration the results of some concrete studies done by doctors and psychologists, professionals in the field.

In the third part will be presented the methodology used for this study, with the specific method and the analysis potentials that it offers.

The fourth and fifth part are the analysis of results. The fourth part includes identification and deep analysis of all factors that affect teenager's attitudes towards plastic surgeries. The author discusses conscious motives, and also a deep analysis of hidden motives. The fifth part includes a deeper and more concrete interpretation of the motivation on the matter. Finally the paper discusses on which part of the population will be a potential market for this kind of service.

The last part includes some suggested strategy that clinics that offer this kind of services might consider to use. Creating strategies based on the customer's motives will increase the potential of offering a superior level of service where the priority is the potential and current customer's satisfaction. In addition, a special attention was given to the creation of strategies in accordance to the elements of Professional Ethics.



- 1.** Në redaksinë e revistës shkencore “LOGOS” pranohen artikuj të cilët nuk janë publikuar më parë dhe nuk do të publikohen përpara se të dalin në këtë revistë.
- 2.** Artikulli duhet të përmbajë 4000-5000 fjalë.
- 3.** Abstrakti rreth 200 fjalë vendoset në fillim të artikullit.
- 4.** Artikujt duhet të paraqiten në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje të shkurtuar në gjuhën angleze, në hard copy dhe në formë elektronike, të punuara në Microsoft Word, me shkrim “Palatino Lynotype”, madhësi shkrimi “12”.
- 5.** Në fillim të faqes së parë të artikullit vendoset emri dhe mbiemri i autorit, titulli akademik, grada shkencore, funksioni dhe emri i institucionit ku punon.
- 6.** Citimet dhe shënimet vendosen në fund të faqes dhe numërohen në mënyrë kronologjike.
- 7.** Tabelat, grafikët dhe ilustrimet numërohen në mënyrë kronologjike dhe poshtë shënohet burimi nga janë marrë të dhënat.
- 8.** Literatura e konsultuar ose bibliografia vendoset në fund të tekstit, e renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve. Kur citohen disa vepra të të njëjtit autor, më përpara vendoset botimi më i hershëm.
- 9.** Çdo artikull i dërguar në adresën e redaksisë u jepet për recension dy studiuesve kompetentë në fushat përkatëse. Artikulli botohet nëse të dyja recensat janë pozitive. Nëse njëra është pozitive dhe tjetra negative, punimi i jepet një recensenti të tretë, vlerësimi i të cilit vendos për botimin ose jo të punimit.
- 10.** Varianti elektronik i çdo numri të revistës publikohet në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar “LOGOS”:
www.shlplogos.edu.al.

